

LE MONDE. *shqip* diplomatiq

100 LEKË, 1 EURO / MUJORE / 24 FAQE

Nr. 787 / Viti i 66 i botimit / Tetor 2019

Patatja e nxehtë e dialogut me Serbinë

Nga Hysni Bajraktari / Faqe 2

Vetëvendosja dhe LDK-ja pritet ta formojnë qeverinë e ardhshme në Kosovë, e cila do ta ketë një detyrë të rëndë para saj: ta rinisë dialogun...

Në "vendstrehimin" shqiptar të 3000 "persëve" të SHBA-së

"Muxhahidinët e Popullit", opozitarët iranianë të tokës shqiptare

NGA YLLI PATA



NOT made in Albania © Gentian Shkurti

Gati 26 shekuj nga beteja famëmadhe e Salaminës, ku komandanti i spartanëve helenë, Leonidha luftoi e fitoi mbi perandorinë gjigande Perse, në Ballkan po zhvillohet një tjetër betejë epike me subjekt persët modernë, përkatësisht Iranin. Natyrisht jo me heshta dhe ushtarë muskulozë, por me kompjutera... / Faqe 12-13

Rivaliteti

Mes SHBA-së dhe Kinës, një luftë më pak tregtare dhe më shumë gjeopolitike

Philip S. Golub / Faqe 8-9

Më 26 qershor 2016, Z. Donald Trump mbajti një fjalim të rëndësishëm në të cilin foli për programin ekonomik dhe tregtar ndërkombëtar që do të zbatonte nëse do të zgjidhej. Përmbajtja e përgjithshme e fjalimit të tij ishte një kritikë e ashpër ndaj politikanëve amerikanë, që akuzoheshin se i "kishin...

Ide

Përse disa dijetarë të Islamit zgjedhin rrugën e gabuar

Albert Doja / Faqe 4-5

Vështirë të mos e vësh re: në Francë, ashtu si edhe gjetiu, Islami dhe muslimanët, besimet dhe praktikata e tyre, janë bërë tema qëndrore të debateve, qoftë sa i takon shamisë që mbulon kokat e grave, qoftë për xhihadizmin dhe terrorizmin islamik. Madje, kjo është...

Kulturë

Kolë Luka, shkëlqimi i një dijetari që punoi në hije

Aurel Plasari / Faqe 24

Si emër i mbetur në hije, i njohur turbull për përkthimet në frëngjisht – gjithnjë pa autor – jo vetëm të të shumtës së artikujve shkencorë në revistën albanologjike...

REPRESION MBI OPOZITARËT DHE RIRESHTIM STRATEGJIK – OBJEKTIVAT E REXHEP TAIP ERDOGAN

Turqia, aleatja kapricioze, armikja e pamundur

Objektivi i privilegjuar i pushtetit turk, rrjetet gjeniste po përpiqen të riorganizohen në Evropë (lexoni artikullin nga Ariane Bonzon). Nga ana e saj, Ankaraja po përballlet me një krizë të hapur me Shtetet e Bashkuara, pasi fitoi raketa ruse dhe skicoi një afrim me Moskën. Megjithë tensionet, dalja e Turqisë nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) nuk ka gjasa.

NGA DIDIER BILLION *

12 korrikun e shkuar, Turqia mori një pjesë të pajisjeve të destinuara për sistemin e mbrojtjes antiraketë S-400, prodhim rus. Në vijim të kontratës së nënshkruar midis Ankarasë dhe Moskës në prill të vitit 2017, ky furnizim i pasuar me të tjerë në

gusht dhe shtator, provokoi tensione të mëdha diplomatike midis Turqisë dhe Amerikës. Për Uashingtonin, sistemi i raketave ruse S-400 ishte i papajtueshëm me pajisjet e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), ku bën pjesë Turqia, që prej


vitit 1952. Për t'i bërë presion Ankarasë, administrata e Donald Trump-it kërcënoi ushtrinë turke me ndalim të shitjeve të gjuajtësve F-35. Nuk do të duhej më shumë për të ngjallur frikë për daljen e Turqisë nga NATO-ja dhe prishjen e marrëdhënieve të saj me Shtetet e Bashkuara, tashmë, të tensionuara për shkak të strategjive kontradiktore në Siri.

Për të kapur dinamikat e diplomacisë turke, duhet fillimisht të merret parasysh një prej konstanteve të saj, shpesh e njohur si *sindroma e Sevrës*, nga emërimi i traktatit të nënshkruar më 10 gusht 1920 nën presionin e fituesve të konfliktit të parë botëror që po të shkatërronte Perandorinë Otomane. Nën këtë shprehje fshihet tërësia e anktheve ekzistenciale kombëtare. Dhe, në fakt, mes motiveve që ndërtojnë politikën e jashtme turke, vihet re një nacionalizëm shqetësues. Në planin regional, diplomacia

e Ankarasë dominohet nga çështja kurde dhe nga fiksimi për të ndaluar çdo lloj kristalizimi në formën e shtetit, çka aspirojnë nacionalistët kurde përtej diversitetit të tyre.

"ZERO PROBLEME ME FQINJËT"

Në fillim të viteve 2000 u vu re një përpjekje për kapërcimin e këtyre paradigmeve në ndikimin e z. Ahmet Davutoglu, në atë kohë ministër i punëve të jashtme dhe i njohur për doktrinën e tij "zero probleme me fqinjin". Nëse kjo nismë do të sillte një buzëqeshje, duke njohur marrëdhëniet e stuhishme që Turqia kishte pasur gjithmonë me të huajin afër saj, ajo do të dëshmonte një vullnet të vërtetë për t'u ndarë nga një parim themelues i politikës së jashtme të Ankarasë gjatë shumë dekadave: "Turku ka mik vetëm turkun". (Vijon në faqen 6)



Bomba njerëzore – shpërthim brenda dhe jashtë planetit

Historinë e dy shekujve të fundit mund ta përmbledhim në mënyra të ndryshme. Më e ashpra, natyrisht, është ajo që nuk është elokuede të thuhet: 1 miliardë tokësorë në 1880-n, 7.7 miliardë në 2019-n. Revolucioni industrial lindi nga një bashkësi njerëzish të tepërt, të plakur, me shanse të pabarabarta. Në qoftë se uria shtrëngon akoma barkun e shumë njerëzve, toka ende nuk ka njohur falimentimin ushqimor që shumë vetë patën predikuar. Presioni mbi burimet natyrore asnjëherë nuk ka qenë kaq i fortë, por ai ka si përgjegjës vendet e industrializuara që po ndiejnë tani se lindshmëria në vendet e tyre po barazohet me vdekshmërinë dhe kryen kështu tranzicionin demografik. Duke u mbështetur në statistikat e fundit të Kombeve të Bashkuara të nxjerra me ndihmën e tridhjetë e pesë hartave grafike, botimi i ri i *“Mënyra për të parë”* (1) e përshkruan këtë shpërthim demografik të tillë që e modifikon trajektoren e njerëzimit. Ajo përfill, gjithashtu, edhe atë që po ndodh aktualisht. Në maj 1968, entomologjisti Paul Ehrlich bëri bujë duke shkruar për apokalipsin ushqimor në *The Population Bomb*. Pikërisht, në këtë vit, përqindja e rritjes së popullsisë botërore arriti një majë përpara se të zbriste lehtësisht më pas. Sfidat e numrit është gjigandeske, në veçanti për ruajtjen e ekosistemeve dhe të mundësisë së banimit që ka Toka: megjithatë *“bomba P”* shkaktoi flakë të madhe.

Sot, më shumë njerëz vuajnë nga mbi-pesha sesa nga nënpesha. Përgjatë konferencave ndërkombëtare, çështja e lindshmërisë është imponuar si një prej kushteve madhore të zhvillimit. Por, nga vënia në jetë të matja e rezultateve, politikat mbi popullsinë kërkojnë kujdes dhe vendosmëri. Duke dashur të çmojmë efikasitetin e tyre, ky botim mëton të vëhet në drejtpeshim evoluimi i treguesve-kyç në vendet fqinj, por që divergojnë: Iran-Irak, SHBA-Kubë, Indi-Kinë, Urugvaj-Paraguaj. Francë-Gjermani, Kore e Veriut-Kore e Jugut, etj. Inercia e fenomeneve demografike i sfidon logjikën afatshkurtra, ndërkohë që edhe të fsheshtat e ndryshimeve klimaterike duhen llogaritur. Megjithatë, në të gjitha kontinentet, përveç një pjese të Afrikës, lindshmëria është ulur ndjeshëm. Në 93 vende, gjeneratat e fundit janë më të pakta në numër se ato që i kanë lindur. Europa qendrore dhe lindore ka humbur 24 milion banorë që prej rënies së Murit të Berlinit. Njerëzimi po qortohet për atë që quhet një “dimër demografik”. Përfitimet shpresëdhënëse për jetëgjatësinë – njëzetë e pesë vjet mesatarisht që prej 1950-s – i kanë kënaqur të gjithë, por në mënyrë tepër të pabarabartë dhe mund të pyesim nëse këto përfitime mund të ruhen në vitet e ardhshme. Në tekstet largpamëse të Alfred Sauvy, René Dumont, Edgard Pisani ose Lucien Sève, botuar në kolonat e gazetës sonë, shtohen edhe analizat e specialisteve më të mirë të sotshëm. Po ashtu edhe refleksionet dhe reportazhet mbi prirjet themelore të demografisë botërore-plakja, urbanizimi, pabarazitë, përzgjedhja e fëmijëve: veprat guximtare dhe turbulluese të Spencer Tunick.

(1) «La bombe humaine», *Manière de voir*, no 167, octobre-novembre 2019, en kiosques ou sur <https://boutique.monde-diplomatique.fr>

KOSOVA PAS ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE

Patatja e nxehtë e dialogut me Serbinë

Vetëvendosja dhe LDK-ja pritet ta formojnë qeverinë e ardhshme në Kosovë, e cila do ta ketë një detyrë të rëndë para saj: ta rinisë dialogun me Beogradin. Përderisa SHBA-të po bëjnë presion për arritjen e një marrëveshjeje të shpejtë, Bashkimi Evropian duket se është jashtë loje. Por, në këtë situatë, cila do të jetë hapësira vepruese e Albin Kurtit?

NGA HYSNI BAJRAKTARI

Ndonëse në Kosovë vijon numërimi i votave, kjo, në thelb, nuk do ta ndryshojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Takimet kanë filluar midis grupeve të punës të Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me qëllim që të krijohet qeveria e re. Humbësit e zgjedhjeve, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e Kadri Veselit dhe koalicioni AAK-PSD i Ramush Haradinajt kanë pranuar humbjen dhe kanë përjashtuar çdo mundësi që të bëhen pjesë e qeverisë së ardhshme. Shkurt, gjithçka duket se rrjedh normalisht drejt ndryshimit të qeverisjes në Kosovë.

Megjithatë, çështja e marrëdhënieve të ardhshme midis Kosovës dhe Serbisë është ajo që mund të jetë përcaktuese për themelimin e qeverisë së re. U deshën vetëm tri ditë pas zgjedhjeve, që i dërguari i veçantë i Presidentit amerikan Donald Trump për dialogun midis Serbisë dhe Kosovës, Richard Grenell, të zbrakojë në Prishtinë dhe në Beograd, për t'i takuar aktorët kryesorë, përfshirë Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, dy pretendentët kryesorë për detyrën e kryeministrit.

Qëllimi zyrtar i vizitës u saktësua nga ambasada amerikane: të punohet “ngushtë dhe shpejt” për një zgjidhje gjithëpërfshirëse për pikat e konfliktit në rajon. Sipas disa burimeve të mirinformuara, emisari amerikan ua ka përmendur bashkëbiseduesve serbë dhe kosovarë, muajin shkurt, si afatin e fundit për ta arritur një marrëveshje. Një qëndrim ky të cilin duket se nuk e ndan fituesi i zgjedhjeve, Albin Kurti, i cili nuk ngutet. «Përmbytja dhe procesi i marrëveshjes janë më të rëndësishme për qëndrueshmërinë e saj sesa afati kohor për të», nënvizoi ai pas takimit me Richard Grenell.

Po cila mund të jetë përmbajtja e marrëveshjes, përderisa dy hipoteza vazhdojnë të qarkullojnë: “korigjimi” i kufijve ose autonomia territoriale për serbët e Kosovës, si kundërpeshë për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia? Vallë, ndryshimi i mazhorancës në Prishtinë do të ndërtojë paradigma të reja për dialogun, apo do të mjaftohemi me heqjen e masës bllokuese të taksës 100% për produktet e importuara nga Serbia në Kosovë, të vendosur vitin e kaluar nga kryeministri Haradinaj?

“Kjo votë ishte votë e dënimit për keq-qeverisjen dhe korrupsionin, por për pjesën më të madhe, ajo ishte votë që goditi disa lojërë gjeopolitike të cilat rrethuan Dialogun e Brukselit me idetë e rrezikshme të ndryshimit të kufijve, në të cilat ishte përfshirë edhe presidenti i Kosovës, presidenti serb Vucic, kryeministri i Shqipërisë dhe një listë e gjatë e lobistëve”, mendon Edita Tahiri ish-zyrtarja e Kosovës për dialogun me Serbinë.



Monumenti i Bill Klintonit në Prishtinë

PËR ALBIN KURTIN, NJË “FAT” À LA TSIPRAS?

«Marrëveshja e shpejtë me Serbinë për të cilën ngulmon Washingtoni është një patatja e nxehtë për Albin Kurtin. Ramush Haradinaj dhe PDK-ja nuk janë tashmë de fakto në pushtet, por aktorët e tjerë janë ende. Ta fillosh mandatin e kryeministrit duke e firmosur një kompromis me Vuçiqin, nën hijen e Hashim Thaçit, rrezikon t’ia sjellë Albin Kurtit fatin e Alexis Tsipras. A do të dorëzohet? A do të përpiqet strategjikisht të përfshihet në proces për ta sabotuar atë, apo edhe do të synojë të fitojë kohë që të hyjmë në zgjedhjet serbe në pranverë, e sidomos në zgjedhjet presidenciale amerikane në vjeshtë të ardhshme? Mbase Albin Kurti mund të përzgjedh edhe të qëndrojë në opozitë me synimin që të rritet edhe më shumë me vonë...Mbetet për t’u parë se si do të sillt “- shpjegon një ish-bashkëpunëtor i tij në kushte anonimiteti.

Duke i cilësuar “raciste” idetë për ndarje etnike në mes Kosovës dhe Serbisë dhe duke u angazhuar për heqjen e taksës 100% për produktet serbe në këmbim të “parimit të reciprocitetit”, Albin Kurti mbetet këmbëngulës jo vetëm kundër një marrëveshjeje të shpejtë me Serbinë, por edhe refuzon ta përfshijë në qeverinë e tij Listën «Srpska» të teledirigjuar nga Beogradi, e cila do të jetë në fakt e vetmja përfaqësuese e komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës e, rrjedhimisht, e vetmja që do ta gëzojë të drejtën e miratimit të emërimit të ministrave të ardhshëm serbë, pjesëmarrja e të cilëve në qeveri është e paraparë në mënyrë të posaçme nga Kushtetuta.

«Pavarësisht se çfarë përfaqëson politikisht, pjesëmarrja e partisë më të madhe të komunitetit serb në qeveri është një detyrim kushtetues. Nëse shkohet me logjikën e përjashtimit të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, atëherë jo që është antikushtetuese, por ajo, domosdo, shpie edhe në realizime etnike territoriale», thotë Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

ZHDUKJA E “KARROTËS EVROPIANE”

Politika e mbylljes përballë Serbisë e Albin Kurtit, qoftë ajo rreth dialogut apo ajo e përjashtimit të Listës Srpska, duket se shkon në të kundërtën e linjës së mbrojtur nga diplomacia amerikane me shumë ndikim dhe qëllimi i së cilës është arritja e një marrëveshjeje të shpejtë midis Beogradit dhe Prishtinës. Për më tepër, qasja e mbrojtur nga Albin Kurti nuk duket e përputhshme me atë që, sipas të gjitha gjasave, do të jetë partnerja e koalicionit qeverisës, LDK-ja e Vjosa Osmanit. Madje ishte Vjosa Osmani dhe jo Albin Kurti, ajo që u ftua në Shtëpinë e Bardhë dhe në Departamentin e Shtetit pas zgjedhjeve. Një vizitë “shumë produktive rreth prioriteteve dhe sfidave që e presin Kosovën gjatë muajve e viteve në vijim”, nënvizoi bartësja e listës së LDK-së. Në të njëjtën kohë, kryeministri rus Dmitri Medvedev, që ishte për vizitë në Beograd, ripoihi se Rusia do të mbetet në mbështetje të “një zgjidhjeje paqësore midis Kosovës dhe Serbisë në përputhje me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara”. Dhe në fund, Bashkimi Evropian që sapo i tha “jo” hapjes së negociatave për anëtarësim të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duket se u vetëpërkujtua nga mundësia për të pasur një rëndësi më të madhe. Ky vendim rrezikon t’i fuqizojë euroskeptikët dhe pasiguritë gjeopolitike rajonale.

«Me humbjen e perspektivës evropiane për Ballkanin, BE-ja e ka humbur peshën si ndërmjetësuese e dialogut Kosovë-Serbi dhe vetë dialogu e ka humbur kuptimin», thotë analisti kosovar, Agon Maliqi. «Serbia pa perspektivë evropiane nuk ka kurrfarë presioni për të na njohur, ndërsa në një dialog të tillë Kosova nuk ka pse futet. Kësisoj është zbehur edhe fuqia përcaktuese e Gjermanisë në rajon. E vetmja forcë që mund të bëjë diçka janë SHBA-të, por levat e saj për ta bindur Serbinë për të na njohur janë të paqarta. Me shumë gjasë zgjidhjet nuk mund t’i presim nga jashtë, por duhet t’i gjejmë vetë si rajon. Jemi vetë!».

(Ky artikull është botuar në portalin frankofon për Ballkanin: “*Courrier des Balkans*” - <https://www.courrierdesbalkans.fr/>)

TË KUPTOSH MENDIMIN STRATEGJIK RUS

Bota e parë me sytë e Moskës

Nga të dyja anët e Atlantikut zëra të zbutur i kundërvihen Moskës duke argumentuar që Kremlinin të kuptojë të drejtën ndërkombëtare. Favorit për një botë shumëpolare, kjo e fundit pretendon se Uashingtoni duhet ta ndajë pushtetin dhe të respektojë parimin e sovranitetit të shteteve. Midis Europës, me të cilën ajo ndjehet afër kulturalisht dhe Pekinit që mbështet të njëjtat teza, Rusia kërkon rrugën e saj.

NGA RICHARD SAKWA *

Çfarë do Rusia? Sipas një numri të caktuar komentuesish perëndimorë, ajo qëndron e kapur fort pas një rendi ndërkombëtar të vjetëruar: sistemi i Jaltës i viteve të luftës së ftohtë, gjatë të cilave Kremlin kishte një sferë ndikimi në Europën Lindore. Aneksimi i Krimesë në vitin 2014 do të dëshmonte refuzimin e saj për ta parë Ukrainën që t'i shpëtonte nga duart. Raporti mbi strategjinë e sigurisë kombëtare (*National Security Strategy*) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, botuar më 18 dhjetor 2017 e cilëson Rusinë si “fuqi revizioniste”, duke lënë të kuptohet se ajo do të shkatërrojë sistemin ndërkombëtar ekzistues. Bëhet fjalë për një regjim autoritar që kërkon të heqë vëmendjen nga problemet e brendshme duke marrë vendime aventuriere jashtë tij. Më keq akoma, që tani e tutje, Moska kërkon që të eksportojë modelin e saj politik, duke krijuar një aleancë autokracish me Kinën.

Sfidat që i bën Moska Perëndimit forcojnë akoma më shumë kohezionin politik të vendit. Megjithatë, mund ta kemi gabim tekta mundohemi të shpjegojmë sjelljen e saj duke u nisur nga

kjo konsideratë e vetme. Çfarë do në të vërtetë Kremlinin, dhe çfarë roli luan afrimi me Kinën në përmbushjen e objektivave të tij?


Këmbëngulja thelbësore e pushtetit rus është që të bëhet bashkëmenaxhues i çështjeve ndërkombëtare dhe të njihet si i tillë. Një ambicje e frustruar hidhur. Në fund të luftës së ftohtë, Bashkimi Sovjetik dhe më vonë Rusia, provuan të transformonin atë, ndaj të cilës ndjenin kënaqësi kur e quanin “Perëndimi historik”, në një “Perëndim të madh”, duke futur këtu edhe Rusinë. Moska shpresonte që ky konfigurim, do ta çlironte Europën nga Perëndimi në kuadrin institucional dhe ideologjik atlantist të luftës së ftohtë; ky konfigurim do të lejonte zhvillimin e një kulture të dialogut politik dhe të ndërveprim-it përfutur në mënyrë reciproke. Por Perëndimi i lejoi vetëm një shtrirje të sistemit në fuqi. I çliruar nga kërcënimi ideologjik dhe ushtarak i Bashkimit Evropian, rendi liberal mori formën e një doktrine *Monroe* universale nën ndikimin e Shteteve të Bashkuara: sfera e ndikimit amerikan po zgjerohet nëpër botë, pa lënë vend për nëngrupime të pavarura të qendrës hegjemoniste.

Drejt një “Euroazie të Madhe”

Rusia iu kundërvu këtij universalizimi, që, sipas saj ishte i instrumentalizuar. Si ministër i punëve të jashtme (1996-1998) më pas kryeministër (1998-1999), Evgueni Primakov ishte drejtuesi i parë që i dha vendit të tij statutin e fuqisë së qëndrësës. Kur u bë më se e dukshme që Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) do të vazhdonte të mblidhte anëtarë të rinj dhe të përgatiste ndërhyrjen në Kosovë pa marrë parasysh interesat e Rusisë, ai nxori në qarkullim nocionin e multipolaritetit. Gjatë një vizite në Indi, në dhjetor të vitit 1998, ai zhvilloi idenë e një kundërpeshë ndaj unilateralizmit amerikan. Mbi këtë bazë, ai sygjeroi një aleancë midis fuqive jo atlantike, “një trekëndësh strategjik” Rusi-Indi-Kinë, që më vonë do të bëhej zemra e shoqatës së *Brics* (Brazil, Rusi, Indi, Kinë dhe Afrikë e Jugut). Politika e tij frymëzohej nga doktrina e “*bashkekzistencës paqësore*” të Nikita Khrushovit, ish sekretari i parë i komitetit qëndror të Partisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, sipas të cilës sistemet sociale dhe politike mund të jenë konkurente pa hyrë domosdoshmërisht në konflikt.

Kur erdhi në pushtet në vitin 2000, Z. Vladimir Putin u mundua

të kombinojë atlantizmin e fillimit të periudhës postkomuniste me strategjinë e Primakovit. Në vitin 2001 u krijua Organizata e kooperimit të Shangait (OKSH), që atëherë përbëhej nga Kina, Kazakistan, Kirgizistani, Rusia, Takhikistani, dhe Uzbekistani – India dhe Pakistani iu bashkuan në vitin 2017. Lindja e kësaj organizate shënon dhe një hap shtesë në krijimin e një sistemi aleancash jo perëndimore. Z. Putin kërkon paralelizm të vendosë lidhje më të ngushta me Bashkimin Evropian. Mendohej se Rusia do aderonte në NATO. Por, gjatë viteve, me ndërhyrjet amerikane në Irak, vendimin e Z. Xhorxh W. Bush në vitin 2002 për të anuluar traktatin ABM (Anti-Ballistic Missile) të vitit 1972 – që kufizonte përdorimin e këtyre armëve, - si dhe me “revolucionet e ngjyrave” të mbështetura nga fondacione të afërta me departamentin e shtetit, Z. Putin i humbi iluzionet e tij. Ai i dënoi Shtetet e Bashkuara duke folur pa doreza në konferencën mbi sigurinë mbajtur në Mynih, në shkurt të vitit 2007. Ai paralajmëroi rreziqet e një “bote unipolare (...) në të cilën ka vetëm një drejtues, një sovran”, dhe e mbaroi fjalimin e tij duke theksuar se Rusia, “me mijëra vitet e saj të historisë”, nuk ka nevojë që ta mësojnë si të sillet me çështjet ndërkombëtare.



Ambasada amerikane në Moskë

Atëherë, Kremlinin besonte se mund të punonte sërish me fuqitë atlantike për çështjet e interesave të përbashkëta konkrete dhe, në veçanti, për luftën kundër terrorizmit. E gjithë kjo u shkatërrua pas ndërhyrjes së NATO-s në Libi në vitin 2011. Dhe, në vitin 2014, reagimi i ashpër kundër asaj që në Moskë u konsiderua si një tentativë e panegociueshme e Bashkimit Evropian për të integruar Ukrainën në sferën e ndikimit atlantik, provokoi krizën më të rëndë pas luftës së ftohtë.

Sinonim i braktisjes së hegjemonisë amerikane, i gjithëpranishëm në fjalimet e drejtuesve rusë, multipolariteti ngelet një koncept i turbullt. Të jetë vallë një objektiv për t'u arritur si përbërës i një strategjie aktive – do me thënë t'i jepet rëndësi fuqive të rangut të dytë, si Rusia -, apo bëhet fjalë për një realitet të prekshëm si rezultat i një riekulibrimi në skenën botërore? Më 19 shtator të vitit 2013, gjatë një sesioni të *Club Valdai* (krijuar në vitin 2004 dhe që ka mbledhur rreth vetes vendimmarrës dhe ekspertë rusë dhe perëndimorë), Z. Putin dënoi “tentativat që kërkojnë, në njëfarë mënyre, të rregullojnë modelin stand-art të botës unipolare”, duke sugjeruar se ky i fundit i përkiste objektivitetit të kaluarës. “Një botë e tillë, shtonte ai, nuk ka nevojë për shtete sovra-ne, ka nevojë për vasalë. Historikisht, kjo të shtyn të hedhësh poshtë identitetin vetjak dhe diversitetin e botës që Zoti na ka dhënë.” Gjatë një tjetër takimi, më 27 tetor 2016, ai shprehu shpresën e tij se “bota po bëhet më multipolare”, duke parë aty kushtin e domosdoshëm që një ditë “rregulla të përbashkëta universalisht të pranuar (...) të garantojnë sovranitetin dhe interesat e popujve”, kryesisht përmes Kombeve të Bashkuara.

Kur bëhet fjalë për të përshkruar ambicjen e Rusisë, termi “neorevizionizëm” është i gjetur. I përshtatur, gjithashtu, edhe për Kinën, ai reflekton një pakënaqësi përse i përket mënyrës se si janë trajtuar sot çështjet ndërkombëtare.

Për këto vende, ka më pak rëndësi të përcaktojnë sferat e tyre të ndikimit sesa të riafirmojnë parimin – e formuluar në mënyrë tipike me termat e sovranitetit – sipas të cilit, Shtetet duhet të përpunojnë marrëdhëniet e tyre me fqinjët përkatës (çka nuk merr domosdoshmërisht formën tradicionale të përkatësisë në një bllok).

Një rikthim i thjeshtë në modelin *Westphalien* të shekullit të XIX-të, në të cilin Shtetet ndërveprojnë si disa topa bilardoje, duke bërë aleancë me disa për të barazpeshuar të tjerët? Moska dhe Pekini e konceptojnë

multipolaritetin në mënyrë më delikate. Edhe pse sovraniteti ngelet para syve të tyre vlera qëndrore, ai është zbutur nga një angazhim në favor të institucioneve shumëpalëshe, qoftë duke krijuar institucione të reja në nivel krahinor, qoftë duke mbrojtur ato që janë me prirje universale dhe që burojnë nga marrëveshjet e *Bretton Woods*-it të 1944-s, më saktësisht, organizata botërore e tregtisë (OBT). Bëhet fjalë për të çliruar të dytat nga vartësia prej sistemit atlantik të drejtuar nga Shtetet e Bashkuara, duke krijuar një sistem ndërkombëtar pluralist.

Rusia dhe Kina formojnë zemrën e një vije antihegjemoniste që po lind. Ndërkohë që Rusia përkulet nën sanksionet ekonomike dhe Kina i bën ballë presionit ushtarak amerikan në Paqësor, drejtuesit e dy vendeve janë takuar pesë herë në vitin 2017 dhe katër herë në vitin 2018. Në shkallëzime të ndryshme, të gjithë drejtuesit rusë kanë kërkuar një integrim ekonomik euroaziatik, por Z. Putin e futi këtë në një logjikë gjeopolitike më të thellë.

Me Bashkimin ekonomik euroaziatik (BEE), krijuar zyrtarisht më 1

Pekini, më i vetëdijshëm për fuqinë e tij

Objektivi thelbësor : të kujdesemi që Euroazia të mos shndërron në një zonë fracture në përbashkëtimin midis një sistemi atlantik të zgjeruar dhe fuqive në zhvillim të Azisë, në veçanti, Kinës. Në vitin 2018 Pekini rriti shpenzimet ushtarake për të 24-tin vit radhazi, çka është vetëm sa 40 % e shpenzimeve të Uashingtonit për ushtrinë (649 miliardë dollarë). Buxheti ushtarak i Rusisë ka filluar të ulët në vitin 2016, por, gjithsesi, ngelet i gjashti në botë. Euroazia është zënë në kurth midis një Perëndimi akoma shumë të fuqishëm dhe një Lindjeje të Madhe në lulëzim e sipër. Mes këtyre të dyjave, Rusia zë një pozicion ideal, por të rrezikshëm.

Ndryshime të mëdha mbeten midis qëndrimeve të Moskës dhe Pekinit. Rusia e njeh parësinë e Shteteve të Bashkuara në fushën ushtarake dhe ekonomike. Në Forumin ekonomik ndërkombëtar të Shën Petërburgut më 17 qershor 2016, Z. Putin do të deklaronte: «Amerika është një fuqi e madhe, dhe ndoshta deri tani e vetmja superfuqi. Ne e pranojmë këtë fakt».

Ndërsa Kina, në të kundërt, me shumë besim në fuqinë e saj ekonomike, nis të formulojë një projekt politik global. Pekini paraqet një gamë idesh si “komuniteti i

janar 2015, ai deklaroi qartazi vullnetin e tij për të ndërtuar rrjetet e veta të integritetit në zonë. Gjë që u konfirmua në maj të vitit 2015, kur nënshkroi me presidentin kinez Xi Jinping një marrëveshje harmonizimi (*sopryazhenie*) midis Bashkimit ekonomik euroaziatik dhe nismës së “trugëve të reja të mëndafshit” (*Belt and Road Initiative, BRI*). Rusia, gjithashtu, çon përpara projektin e “euroazisë së madhe” në zëvendësim të projektit të vdekur të “Europës së madhe” (nga Lisbona në Vladivostok) që e përkëdhelte udhëheqësi i fundit sovjetik, Z. Mihail Gorbaçov. Ky projekt do të përfshinte pjesën më të madhe të zonës në një grumbullim me gjeometri të ndryshueshme të rrjeteve të ndërlidhura, përfshi këtu entitete që ekzistojnë tashmë, si Shoqata e Kombeve të Azisë së Juglindjes (*Anase, ose Asean në gjuhën angleze*).

Kjo dispozitë përfaqëson atë që mund ta quajmë strategji e “*zerrës së tokës*” (*heartland*) (*terre du milieu*), një koncept klasik i gjeopolitikës - teori e trajtuar nga Halford John Mackinder (1861 – 1947) dhe e rishikuar nga politologu amerikan Zbigniew Brzezinski – që e shndërron Euroazinë në aksin gjeografik të botës dhe për rjedhojë në objekt të një lufte midis fuqive të mëdha. Më 9 korrik 2015, në hapjen e një takimi të përbashkët midis *Brics* dhe *OCS-së*, në prani të drejtuesve të tjerë të Bashkimit ekonomik të euroazisë në Oufa, në Rusi, Z. Putin do të deklaronte: “*Për ne, ky bllok kontinental euroaziatik nuk është një fushë shahu, apo një vend lojërash gjeopolitike; është vatra jonë. Ne të gjithë duam që ky vend të jetë i paqët, i begatë dhe të mos i dorëzohet ekstremizmit apo tentativave për të mbrojtur interesat e njëres palë në kurriz të palës tjetër*”

fatit”, bazuar në marrëdhëniet “*fitues-fitues*”. Skeptikët e ironizojnë këtë ide, por fakti që këto nocione mbështeten në investime të mëdha “*të rrugëve të reja të mëndafshit*” dhe në krijimin e një banke shumëpalëshe, na fton t'i japim njëfarë vëmendjeje.

Marrëveshja kino-ruse nuk përfshin domosdoshmërisht çështjen thelbësore të identitetit kulturor. Gjithë duke u larguar shumë e më shumë nga sistemi atlantik, dhe veçanërisht pas 78 ditësh nga bombardimi i NATO-s mbi Serbinë në vitin 1999, Rusia nuk ka hequr dorë kurrë nga identiteti i saj perëndimor. Z. Putin e pohoi sërish me nënkuptim këtë gjë. Madje, edhe kur kritikoi degradimin e Perëndimit, gjatë takimit të *Club de Valdai* në shtator të vitit 2013: “*Po shohim se si një numër vendesh euroatlantike po i mohojnë rrënjët e tyre, përfshirë vlerat kristiane që përbëjnë themelin e qytetërimit perëndimor.*”

Pekini ka dyshime, mbase me të drejtë, se Rusia do vazhdojë të ëndërronjë që të marrë drejtësinë e rikrijimit të Perëndimit nëse do të krijoheshin kushtet. Çfarë do të ngelte pastaj nga projekti i Euroazisë së madhe?

* Profesor në universitetin e Kentit (Mbretëria e Bashkuar); autor i *Russia's Futures*, Polity Press, Cambridge, viti 2019.

Përse disa dijetarë të Islamit zgjedhin rrugën e gabuar

Vështirë të mos e vësh re: në Francë, ashtu si edhe gjetiu, Islami dhe muslimanët, besimet dhe praktikatat e tyre, janë bërë tema qëndrore të debateve, qoftë sa i takon shamisë që mbulon kokat e grave, qoftë për xhihadizmin dhe terrorizmin islamik.

NGA AKADEMIK PROF. DR. ALBERT DOJA
PROFESOR I ANTROPOLOGJISË NE UNIVERSITETIN E LILLE FRANCË

Madje, kjo është kthyer në një subjekt me peshë në gjatë të “fasho-sferës” në faqet e internetit dhe të rrjeteve sociale të lidhura me ekstremizmin e djathtë ose me ata që mbrojnë ideologjitë e tyre.

Ndërsa partizanët e laicitetit në Francë që pretendojnë gjithashtu “të folur pa dorashka” për islamin, disa herë, vështrohen si të akuzuar për islamofobi.

Ata iu kundërpërgjigjen akuzuesve të tyre duke i quajtur “islamo-majtistë”, dhe ndërtojnë kështu një lidhje mes personaliteteve që janë reshtuar në të majtë ose të ekstremit të majtë, nga njëra anë, dhe mjedisve islamike ose islamistëve, nga ana tjetër.



Albert Doja

KUFIZIMET E DIJES

Mendimet filozofike mbi lidhjet mes fesë dhe politikës, frymëzuar prej nocionit të arsyes publike të John Rawls-it, janë brendashkruar në traditën liberale të moderimit ose të kufizimit fetar, sipas së cilës, qytetarët dhe ligjvënësist duhet të përmbahen dhe mos të marrin vendime vetëm duke u mbështetur në motive fetare.

Ndërkaq, rasti i islamit në Francë dhe në demokracitë e tjera liberale europiane, laike dhe moderne, dëftën, njëherësh, kufizimet e politikës dhe të dijes.

Në fakt, sot, mendimtarët europianë duket se janë të përfshirë nga një tension mes rëndësisë për të pranuar njohjen e individuale dhe problemeve që shtrihen nga ligjërimi identitar dhe thelbësisht religjioz që përdor hapësirën liberale laike për të shtyrë përpara disa nga programet ideologjike islamike.

ÇËSHTJA E ISLAMIT

Duket se në një masë të madhe një çështje themelore është neglizhuar në raportimet ose në debatet publike, me sa duket për arsye të një kuptimi të kufizuar për Islamin ose nga frika për t'u përballur me muslimanët.

Më konkretisht, më shumë këmbëngulet mbi efektet e përzierjes së besimtarëve muslimanë me terrorizmin islamik radikal. Kërcënimi nga terrorizmi thuhet se nuk vjen prej Islamit, por nga islamizmi, që është një ideologji politike e grupeve radikale që kanë huazuar nga Islami koncepte si *sharia* dhe *xhihadi* dhe i riinterpretojnë ato për të legjitimuar objektivat e tyre politike të veçanta.

Interesi i grupeve isalmiste si Al-Qaïda dhe Daesh supozohet se vjen nga aftësia e tyre tinëzare për

Krijimi i një kalifati si një entitet politik, bazuar mbi sheriatin është programi i qartë i terrorizmit islamik radikal, por, për eruditët muslimanë, në këtë rast, nuk është fjala për një detyrim fetar. Ata e refuzojnë termin islamizëm që është një shprehje postkoloniale me ngjyrimet politike më shumë sesa me mësim nga islami

të përdorur në mënyrë selektive mësimet e Islamit me qëllim që t'i riformatojnë ato si urdhërime fetare legjitime. Në veçanti, këto grupe kanë bërë për vete konceptin e xhihadit që të përdorin dhunën dhe të legjitimojnë luftën e shenjtë kundër jo muslimanëve.

Krijimi i një kalifati si një entitet politik, bazuar mbi sheriatin është programi i qartë i terrorizmit islamik radikal, por, për eruditët muslimanë,

në këtë rast, nuk është fjala për një detyrim fetar. Ata e refuzojnë termin islamizëm që është një shprehje postkoloniale me ngjyrimet politike më shumë sesa me mësim nga islami.

ZHVILLIMI ISLAMIK POSTKOLONIAL

Nga ana tjetër, eruditët muslimanë si Tariq Ramadan-i janë kthyer te objektivi kryesor që është islamizimi i rinisë në vendet perëndimore europiane, për të afirmuar besnikërinë e tyre ndaj një mendimi inetelektual jo kolonial.

Gjithnjë e më tepër, kjo sjell mbrojtjen dhe përpunimin e një teologjie islamike të rinovimit që përbën kështu manifestimin e mësimëve të përtërira të islamit, përkatësisht në kontekstin ideologjik të çlirimit postkolonial dhe antiperëndimor.

Ky islam, i quajtur «dekolonial» (këtë e tutje do përdorim termin jo kolonial. I. Y.) manifestohet sot në institucione dhe organizata të ndryshme nën etiketat “studime islamike kritike”, “ndërrhyrje islamike dekoloniale”, “studime për islamin bashkëkohor”, “kërkime dhe dokumente për islamofobinë” etj., të cilat organizojnë seminare dhe shkolla verore që tërheqin mendimtarë dhe besimtarë të të gjitha tipeve nga gjithë bota.

Analizat e këtij lloji nxjerrin në pah karakterin opozicional të islamit, si islamizëm ose teologjia islamike e çlirimit, paraqitur si një forcë e pandashme fetare dhe politike, formuar dhe përpunuar si nga përbërësja politike, kulturore, fetare, epistemologjike e Perëndimit ashtu dhe nga lufta kundër kolonializmit dhe neokolonializmit perëndimor.

Ndërkaq, interesi strategjik i terrorizmit islamik radikal, përfaqësuar më së miri prej organizatave të tilla si Al-Qaïda ose Daesh, mbështetet gjithashtu në përhapjen e bindjes se Islami dhe Perëndimi janë angazhuar në një luftë qytetërimore.



©Thierry Ehrmann/Flickr, CC BY-SA

Les penseurs de l'islam en Europe se fourvoient parfois dans leur analyse confortant certaines théories promues par des idéologues islamistes.

Sado e larmishme qoftë, kjo kthesë ka sjellë një lloj sinteze, tendosur prej kritikës mbi orientalizmin dhe antikononializmin e botës së tretë, mbështetur prej parimeve politikisht korrekte dhe të frymëzuara nga poststrukturalizmi postmodernist dhe postlaicist, si dhe nga i ashtuquajtur i feminizëm isalmik. Duket se mendimi dekolonial ka gjetur në Islam në qoftë se jo zgjidhjen, të paktën një nga më të mirët veprues revolucionarë.

Muslimanët priren kështu që t'i japin një bazë sociale asaj që deri më tash është vetëm një lëvizje intelektuale. Larg përfilljes së islamit si një fe e paqes, shumë interpretime teologjike shiite dhe sunite, para së gjithash, flasin për një islam progresist të përbërë nga tharmi fetar ku përzejehen trazira dhe revolucione çlirimtare

MEKANIZMA FETARE KOMPLEKSE : SHEMBULLI I BEKTASHIZMIT

Ajo që duket se u ka shpëtuar njëherazi si studimeve fetare ashtu dhe eruditëve muslimanë janë mekanizmat komplekse që i lejojnë teologjisë heterodokse të çlirimit dhe konservatorizmit ortodoks të shfaqen ngushtësisht të lidhura. Përkatësisht, në kontekstet muslimane, teologjia e çlirimit, shpesh transformohet në një instrument politik konservator falë ruajtjes dhe transmetimit të dijes shpirtërore.

Le të marrim shembullin e bektashizmit. Ky korrent sufi-shiit ka luajtur një rol përcaktues në politikën kombëtare dhe shoqërore çlirimtare, qoftë në Anadollin ottoman apo në Turqinë bashkëkohore apo më tej akoma në Shqipërinë e mesluftërave apo edhe në atë të periudhës postkomuniste.

Bektashizmi është formuar në shekujt XIII-XIV në Anadoll prej dervishëve endacakë ardhur nga Irani. Nga një lëvizje tribale minoritare

në fillim, ajo u formësua rreth mitit themelues të martirëve të shiizmit dhe të tjerave legjenda islamike mbi kultin e shenjtë mrekullibërës të cilët insistonin mbi aspiratën sufi të bashkimit mistik me Zotin.

Dija ezoterike, fituar prej progresit individual sjell një pamje të egalitarizmit përmes pjesëmarrjes në një komunitet shpirtëror që konfirmon nevojën për të kapërcyer realitetin ose për t'iu kundërvënë shoqërisë, duke u ngritur përkohësisht në një përvojë mbinatyrore jashtë-kohësore.

Ky tip i teologjisë çlirimtare ka bërë që bektashinjtë, shpesh, të përfaqojnë pakënaqësitë shoqërore dhe revoltat e armatosura kundër autoriteteve fetare dhe politike e, që këtej, vjen më pas edhe përsekutimi i përgjakshëm në historinë e tyre.

Ndërkaq, prej vullnetit politik të Sulltanit ottoman, në shekullin XVI ndodhi një ndryshim politik. Ai emëroi një shef të ri fetar të cilin e ngarkoi të riorganizojë lëvizjen bektashi deri në atë pikë që udhëheqësit shpirtërorë do të kishin në ngarkim trupën e jeniçerëve, shtylla ushtarake e pushtetit ottoman.

Në vigjilje të Reformës otomane të shekullit XIX, ata bien sërish në telashe dhe fillojnë të ndiqen e të persekutohen egërsisht, por ringrihen dhe i gjallërojnë prirjet e tyre heterodokse të çlirimit dhe të rezistencës derisa në atë pikë sa afrohen me pushtetin në Perandorinë otomane të rinovuar.

Më në fund urdhri bektashi u shfuqizua në shekullin XX nga Turqia republikane, por vazhdoi në formën e alevizmit, forma e fundit e shfaqur me të njëjtën heterodoksi të çlirimit dhe të lirisë.

Ndërkohë, bektashinjtë gjenden të shpërndarë rrugëve gjejnë strehë në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri. Prirja e tyre heterodokse e çlirimit dhe e rezistencës i afron natyrshëm me lëvizjen kombëtare shqiptare në fund të shekullit XIX, çka bëri që të rritet numri i tyre ndër shqiptarë

deri në atë pikë që u konsideruan si pjesë përbërëse e repertorit të instrumenteve politike të konvertimit fetar në rindërtimin identitar e politik të një Shqipërie me katër besime fetare.

Në këtë kontekst, hetereodoksia dhe panteizmi bektashi u përdorën qëllimisht nga Naim Frashëri për të nxitur një qëndrim përbashkues të identitetin kombëtar shqiptar jo domosdoshmerisht në një afëri të veçantë me bektashizmin. Më në fund bektashinjtë ia dolën që të marrin pjesë në majat më të larta të shtetit në Shqipërinë e pavarur. Pas persekutimit komunist, ata do të gjejnë në Shqipërinë postkomuniste një rinjohje të krahasuar me besimet e tjera dhe të pavaruar nga islami sunit.

Por në kundërshtim me çka disa specialistë si Nathalie Clayer lënë të besosh, bektashinjtë nuk janë një degë e islamit më « cool », as më të butë se lëvizjet e tjera fetare. Mistikët heterodokse dhe heretikët e të gjitha anëve, disa herë janë të rrezikshëm dhe disa herë të besueshëm në varësi të situatave politike.

KUJDES NGA « RINOVIMI » FETAR

Rinovimi fetar, përtej intensitetit dhe forcës së besimeve apo të karakterit radikal të opozitës me çdo lloj feje zyrtare, kristalizim gjithmonë një teologji që kërkon të çlirojë besimtarët nga pakënaqësitë politike, shoqërore, kulturore dhe globale. Ndrëkaq, sa herë që një lëvizje fetare riorganizohet në një urdhër të strukturuar, kjo sjell po ashtu edhe instalimin e një ortodoksie konservatore në praktikën fetare që shërben për të legjitimuar ndërtimin e një hierarkie politike në shoqëri.

Ky ishte rasti i përsëritur disa herë në historinë e turbullt të bektashizmit në Anadollin otoman dhe në Turqinë bashkëkohore apo edhe në Shqipërinë e pavarur dhe postkomuniste.

Duket se radikalizmi islamik i « rinovimit musliman » të Tarik Ramadanit nuk është veçse një provë tjetër, ashtu si lëvizjet xhihadiste, salafiste dhe vahabiste që tentojnë të instalojnë ortodoksinë perfekte të të vetëshpallurit “Shtet islamik”.

NJË DIJE E NJËNASHME

Një seri shkrimesh në gjuhët perëndimore për islamin, botuar prej muslimanësh ose simpatizantë të islamit, tregojnë që një qasje është e kuptueshme dhe legjitime për aq sa riprodhon një ligjërim apologetik ose për aq sa ka për qëllim të zbulojë thelbin e fshehur të islamit. Punimet e Tarik Ramadanit në Europën Perëndimore apo ato të Nathalie Clayer për Europën Juglindore janë një shembull i kësaj qasjeje.

Më shpesh, studimet e specializuara nuk kanë tjetër qëllim veç të transmetojnë një përshtypje të

përgjithshme që muslimanët mund të pranojnë, ose duke e ndarë Islamin nga islamizmi, ose duke paraqitur islamin si një fe progresiste të çlirimit demokratik. Këto analiza riprodhojnë –në mënyrë të vullnetshme ose jo – ligjërimet ideologjike mbi islamin pa e vënë në diskutim atë, duke shprehur në mënyrë akademike atë që fraksionet islamike e shpallin në mënyrë religioze.

Duke e shpallur muslimantë si viktima « *par excellence* », sistematikisht të shtypur prej regjimeve autoritare, disa riprodhojnë vulgatën muslimane, duke krijuar në të njëjtën kohë me protagonistët e saj promotorët e lëvizjeve kombëtare, aleatët e laicitetit, partizanët e barazisë mes sekseve ose nxitësit e parë të demokracisë.

Të tjerë justifikojnë madje edhe radikalizimin dhe fundamentalizimin fetar, siç bën Robert Kaplan përmes trashëgimive historike të vendeve euro-juglindore ose më tej akoma Olivier Roy me diskriminimet shoqërore në shoqëritë europereëndimore si Franca.

Këto analiza duket se rrjedhin nga një natyralizim kulturor i trashëgimive historike ose kushteve shoqërore, gjë që zvogëlon dimensionet thelbësisht politike të islamit.

PERPSEKTIVA E PËRMBYSUR

Padyshim ne duhet ta përmbysim perspektivën dhe të çlirohemi nga ky vizion apologetik i thelbit

fetar mbi të cilën shumë janë aq entuziastë për të mundur të shpëtojnë përse në një moment të dhënë, një kategori fetare bëhet instrument i dukshëm për mobilizimin shpirtëror, kulturor, shoqëror ose politik.

Në fakt, nëse duam të « dalim nga kaosi », siç dëshiron politologu Gilles Kepel, në fillim duhet të pushojmë së flirtuari me eruditët fetarë dhe të fillojmë të denoncojmë shefat isalmikë dhe apologetët muslimanë për atë çka ata bëjnë duke ushqyer, nxitur dhe justifikuar një politikë islamike mjaft të veçantë.

Ajo që njerëzit mbajnë për identitet fetar duhet trajtuar si një e dhënë ideologjike e ndërthurur përmes ligjërimet të tyre të veçantë.

Nëse rilexojmë antropologun Fredrik Barth, zgjedhja për t'u identifikuar me islamin apo me një tjetër religjion varet nga situatat shoqërore dhe politike në të cilat identifikimi bëhet i përshtatshëm në planin e organizimit shoqëror të diferencave kulturore.

Me qëllim që të ndërtojmë një analizë relativisht autonome të ligjërimëve islamike, është e nevojshme të studiojmë kontekstin që riprodhon të tilla ligjërimë dhe praktika ritualiste, që interpretimet e aktorëve kryesorë t'i kthejmë në të dhëna për t'u interpretuar dhe për t'i integruar në objektin e studimit tentativat dhe strategjitë e tyre për të ekuilibruar ose përmbytur marrëdhëniet me pushtetin.



Tombau de Gül Baba à Budapest en Hongrie, poète ottoman et conseiller politique (XVI^e siècle). Indafoto/Wikimedia, CC BY



President Donald J. Trump and Xi Jinping, Photo by Shealah Craighead

Politika

Uashingtoni kundër Pekinit

NGA SERGE HALIMI

Me gjasë, SHBA-të poverësojnë se ato nuk mund të përballojnë njëherësh edhe Kinën edhe Rusinë. Në dhjetëvjeçarët që vijnë, rivali i tyre kryesor gjeopolitik do të jetë Pekini. Mbi këtë temë, mes administratës republikane dhe demokratëve ka një mirëkuptim dhe vitin tjetër, zgjedhjet e ardhshme presidenciale do ta trajtojnë kwtw argument me shumë energji Kështu, Kina pason “Perandorinë e së keqes” sovjetike dhe “terrorizmin islamik” si kundërshtarët parësorë të Uashingtonit. Por, në ndryshim nga Bashkimi Sovjetik, Kina zotëron një ekonomi dinamike me të cilën SHBA-të regjistrojnë një deficit tregtar abisal. Dhe fuqia e saj është veçanërisht më tërheqëse se ajo e dhjetëra mijëra luftëtarëve integralistë që endeshin në shkretëtirat e lashta të Mesopotomisë dhe në malet e Afganistanit. Z. B.

Obama e kishte bërë diplomacinë amerikane, tashmw, “një strumbullar drejt Azisë” dhe Paqësorit, ashtu siç edhe pasardhësi i tij e formulon shpesh këtë strategji të re me më pak elegancë dhe zgjuarsi (lexo ne faqet 8-9). Me qenë se në mendjen e tij kooperimi është gjithmonë një grackë, një lojë me rezultat zero, lulëzimi ekonomik i rivalit aziatik kërcënon automatikisht zhvillimin e SHBA-ve. Dhe ndërsjellazi: “Jemi duke fituar kundër Kinës tha me triumf krekosës z. Trump gushtin e shkuar. Ata po njohën vitin më të keq që prej një gjysmë shekulli dhe kjo falë meje. Unë jam krenar për këtë”. “Jo krenar” kjo gjendje nuk i shkon...Ka më pak se një

vit që ai ka autorizuar dhomat e deputetëve që të transmetojnë direkt një mbledhje të kabinetit të tij. Dhe aty ndodhi gjithçka: një nga ministrat e tij u tregua i lumtur prej ngadalësimit të rritjes së Kinës; një tjetër i kishte lidhur eksportet kineze të fantanilit në SHBA me epideminë e opoideve; një i tretë i kishte lidhur vështirësitë e fermerëve amerikanë me masat shtrënguese tregtare të Kinës. Nuk mbetej tjetër tani veç që z. Trump ta shpjegonte kokëfortësinë nukleare të Koresë së Veriut me butësinë e Pekinit kundrejt aleatit të saj. Për Uashingtonin të shesësh pak më shumë misër ose pajisje elektronike në Kinë nuk do të mjaftojë më. Duhet që ky rival të izolohet, megjithëse prodhimi i brendshëm bruto i tij është shumëfishuar me nëntë në shtatëmbëdhjetë vjet. Duhet ta dobësosh, ta pengosh që të shtrijë influencën e tij dhe sidomos ta pengosh që të bëhet një i barabartë strategjik me SHBA-të. Prosperiteti i tij i flaktë

nuk e çoi atë në amerikanizëm, për të qenë i shkathët, ndaj dhe goditjet nuk iu kursyen. 4 tetor 2018, zëvendës-presidenti amerikan Mike Pence u zhyt në një fjalim me një violencë ekstreme “system orewellian”, “autoritete” që shkatërrojnë kryqë, djegin bibla dhe burgosin besimtarë, “presion mbi sipërmarrje, studio kinemaje, univeristete, think tank-e, shkencëtarë e gazetarë amerikanë”. Ai, madje, la të kuptohej edhe tentative për të ndikuar zgjedhjet presidenciale të vitit 2020”. Pas “Russiagate”, një “Kinagate” që këtë radhë do të ketë për objektiv humbjen e z. Trump? Shtetet e Bashkuara, pa dyshim, janë një vend shumë i brishtë ...

PËR UASHINGTONIN TË SHESËSH PAK MË SHUMË MISËR OSE PAJISJE ELEKTRONIKE NË KINË NUK DO TË MJAFTOJË MË. DUHET QË KY RIVAL TË IZOLOHET, MEGJITHËSE PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO I TIJ ËSHTË SHUMËFISHUAR ME NËNTË NË 17 VJET

REPRESION MBI OPOZITARËT DHE RIRESHTIM

Turqia, aleatja kapricioze,

NGA DIDIER BILLION *

(vijaon nga faqja 1)

Shumë shpejt, mjedisi gjeopolitik i turbullt i vendit, në veçanti tronditjet e luftës civile në Siri, i çuan dëm këto përpjekje dhe fundamentalistët morën hov.

E lidhur ngushtë me fuqitë perëndimore që në fund të luftës së dytë botërore, Turqia nuk ka qenë gjithmonë një aleate e lehtë. Kontradiktat më Shtetet e Bashkuara kanë qenë të herëpashershme. Pas pushtimit të veriut të Qipros nga ushtria turke, amerikanët vendosën një embargo mbi furnizimin e armëve, nga shkurti i vitit 1975 në shtator të vitit 1978. Po kështu, në vitin 2003, marrëdhëniet dypalëshe njohën pështjellime të rënda pas refuzimit të Parlamentit turk për të pranuar kërkesën e z. Xhorxh W. Bush për leje kalimi nëpërmjet Turqisë të armatimit 62 000 GI i gatshëm për të sulmuar Irakun e Sadam Hysein.

Megjithatë, përpjekja e Turqisë për t'i menduar edhe njëherë raportet e saj me botën që e rrethon, e gjithëpranishme që në vitin 1960, nuk është shoqëruar asnjëherë me tërheqje nga aleancat tradicionale. Tri ngjarje

* Zëvendës Drejtor i Institutit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe strategjike. (IRIS).

të kohëve të fundit e provojnë këtë gjë: kontrata për instalimin në tokën e saj të radarit të alarmit të shpejtë antiraketë të NATO-s, e përpiluar në samitin e Lisbonës në nëntor të vitit 2010 dhe e konfirmuar në shtator të vitit 2011; vendosja nga NATO, me kërkesë të Turqisë, të raketave Patriot (prodhim amerikan), në kufirin turkosirian në janar të vitit 2013; mbledhja e NATO-s në nivel ambasadorësh kërkuar nga Ankaraja – e cila u thirr menjëherë nga organizata transatlantike – disa minuta pasi avionët gjatës të saj rrëzuan një aeronef rus, më 24 nëntor 2015.

Edhe pse instrumentalizimi kombëtar ndaj mosmarrëveshjeve me Shtetet e Bashkuara i ndez ndonjëherë tensionet, Turqia nuk mendon aspak të prishë urat, por, e ndërgjegjshme për potencialin e vet, ajo mbron interesat e saj me forcë. Duhet të kujtojmë se ajo ka një ushtri që renditet e dyta në NATO, për nga numri i ushtarëve, vë në dispozicion të aleatëve të saj bazën në Incirlik, ku janë vendosur armë nukleare, kontrollon akoma ngushticat dhe përfaqëson ende të vetmin shtet me kulturë muslimane, anëtar i Aleancës së Atlantikut. Me një fjalë, ajo përbën gjithmonë një aks euroaziatik të pashmangshëm nga politika regionale amerikane.



Mbështetës të presidentit Erdogan

Nga këndvështrimi i perëndimorëve, roli qëndror që luan Ankaraja *de facto* duhet të ruhet patjetër. Besimi reciprok është thyer në mënyrë të pamohueshme nga vendimi i Turqisë për të marrë raketat, sistem S-400, por, pajtimi i

interesave mbetet i fortë. Për këtë arsye, Turqia do të ngelet në NATO, edhe pse ndodh që sille si provokatore, si gjenerali de Gaulle në kohën e tij.

A e vë në diskutim këtë analizë,

dosja e raketave ruse S-400? Është e vërtetë që këto armë nuk pajtohen me normat e organizatës atlantike, sipas Uashingtonit, sepse mund të futen në rrjetet me sistemet e armatimit perëndimor që zotëron Turqia, duke i çenuar ato. Megjithatë,

Europa, toka ku gjetën

NGA ARIANE BONZON *

Simate (bukë në formë unaze me susam), tranguj, ullinj të zinj dhe menemen (vezë të kavërditura me domate): mëngjesi është i kuzhinës turke por në ndodhemi në një nga ato shtëpitë borgjeze me dritare të dala, të periferisë në veri të Londrës. I ftuari ynë, pesëdhjetëvjeçari, Z. Mustafa Yesil, është bërë objekt i një kërkesë ekstradimi nga ana e Turqisë. Ai është njëri nga katër personalitetet në arrati për të cilët kryeministri turk Binali Yildirim, gjatë një vizite në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2017, i kërkoi Znj. Theresa May, në atë kohë kryeministre e Mbretërisë së Bashkuar që t'ia dorëzonte. Pushteti islamo-nacionalist i Ankarasë e lidh atë me "organizatën terroriste të partizanëve të Fethullah Gulen-it", ose e quajtur ndryshe FETO. Me këtë emër e ka pagëzuar ai lëvizjen që është ngritur rreth imamit të vetëmërguar në Pensilvani (Shtetet e Bashkuara), të cilin ai e akuzon se ka nxitur puçin ushtarak të dështuar më 15 korrik 2016. Por, Z. Yesil është nga ata të rrallët që janë në lidhje direkte me "Hoxhë efendinë", Mjeshtrin, një titull shumë i respektuar, dhënë Z. Fethullah Gulen, në emër të të cilit është autorizuar të flasë

Organizator dhe drejtues i pashoq, Z. Yesil ka pikërisht profilin-tipik të anëtarëve të aparatit gylenist që gjallëron Hizmetin (shërbim), emër që i kanë vënë lëvizjes së tyre. Kjo lëvizje sipas universitares kaliforniane Sofia Pandya, numëron 10 milionë partizanë në gjithë botën. Në fund të viteve 1970, Z. Yesil studioi teologji në universitetin e Marmaras në Stamboll, para se të fillonte të jepte mësimë feje. Në vitin 1983 ai zbuloi "me një emocion që nuk e kishte ndjerë kurrë më parë", predikimet e Fethullah Gulenit, që lidhen me traditën e një fetari kurd të fillim shekullit XX-të, Said Nursi (1878-1960), afër me sufizmin. Në ditët e sotme ai është një Abi (vëlla i madh), shef i Heyet-it (Këshilli); ai drejton degën europiane të komunitetit dhe kontrollon imamët e ndryshëm (kuadro kompetentë) me pozita në Kontinentin e Vjetër, në të cilin gylenistët kërkojnë tashmë strehim.

KUNDERSHTARI
KRYESOR I ANKARASË

Por gjëndja ndryshoi. Pasi ishte aleat me Z. Rexhep Taip Erdogan, i cili erdhi në pushtet pas zgjedhjeve legjislativ të vitit 2002 – kjo gjë e ndihmoi atë jo vetëm të pakësonte ndikimin e vendosjes republikane, elitiste,

nacionaliste, laike dhe qemaliste, por, gjithashtu, të shtynte ushtrinë jashtë kampit politik -, Hizmeti është tashmë armiku kryesor i pushtetit të Ankarasë. Z. Yesil luajti një rol kyç, midis viteve 2010-2015, në përballjet midis gylenistëve dhe partizanëve të Erdoganit në gjirin e aparatit shtetëror – konflikte fillimisht në larvë, por që nuk vonuan të shpërthejnë haptazi. Ai u largua nga vendi një vit para tentativës për grusht shteti në vitin 2016 – një puç i dështuar që çoi në shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, çrrënjosjen e rrjeteve gyleniste në gjirin e administratës, mbylljen e shumë shoqatave, konfiskimin e medias, vënien nën tutelë të shkollave, të universiteteve dhe të shumë ndërmarrjeve të lidhura me gylenistët. Nga burime zyrtare mësohet se në pranverën e vitit 2019, rreth 77 000 persona të akuzuar se i përkisnin FETO-s u arrestuan (nga të cilët 17 000 femra bashkë me 750 fëmijë), 240 000 persona duhej të dilnin para drejtësisë, 30 400 ishin shpallur tashmë fajtorë dhe 150 000 funksionarë u pezulluan ose u hoqën përfundimisht.

Qofshin të akuzuar për akte kriminale në Turqi: "vëllezër të mëdhenj": apo ndjekës të thjeshtë, një numër i madh gylenistësh zgjedhën të kërkonin azil politik në Bashkimin Europian – 55 000 gjithsej midis viteve 2016 dhe 2019, sipas Z. Yesil. Bashkë me Shtetet e Bashkuara, kontinenti i Vjetër duket sikur që tani e tutje është "zemra që rreh" e këtyre

rrjeteve, gjë që nuk ka qenë gjithmonë kështu. Sigurisht, ata janë atje që nga vitet 1980 dhe vetëfinancohen falë dhurimeve të shumë sipërmarrësve turq, simpatizantë të Fethullah Gulenit që jetojnë në Europë. Por, sidomos pas fitores elektorale të Partisë së drejtësisë dhe të zhvillimit, në vitin 2002, ata njohën një zhvillim të madh.

Një i besuar që kërkoi anonimatit na tregon me detaje mënyrën se si funksionojnë: "Në Europë dhe gjetkë, lëvizja gyleniste i bindej gjithmonë të njëjtës skemë. Një imam emërohej për të "drejtuar" lëvizjen në vend, një grup ishte ngarkuar të merrej me dialogun ndërfetar apo dhe me shoqërinë civile, një tjetër me strehimin, një tjetër me shkollat, dhe një i fundit me biznesmenët. Çdo krahinë e madhe kishte një imam. Në Francë, përshembull, ishte imami i Lionit, imami i 93 etj." Suksesi ishte i garantuar, sepse kjo formulë u jepte rezidentëve europianë muslimanë praktikantë, mundësinë të përqaftimit fenë e tyre, origjinën e tyre turke dhe qytetarinë e tyre në vendet perëndimore që nuk ishin gjithmonë dashamirëse karshi islamit dhe besimtarëve të tij. «Mesazhi i Gulenit na lejonte të krijonim një urë lidhëse midis fesë sonë muslimane dhe botës moderne, shpjegon një ndjekës që jeton në Londër. Ai propozonte një përfaqje alternative përballë islamit politik, që e braktiste në përfitim të islamit civil, i cili përmbante një përgjegjësi sociale, integrimin dhe dialogun me të tjerët".

Kjo prani gyleniste në Europë – Gjermani, Belgjikë, Hollandë, por edhe në Francë – u dha jetë rreth pesëdhjetë shkollave, qindra orëve mësimi në kurset e natës, një plejade të tërë shoqatash kulturore, profesionale, femërore, si dhe në çdo vend, një "Platforme për të promovuar dialogun ndërfetar", që ishte dhe logoja e lëvizjes. Kjo lëvizje ofron gjithashtu dhe bursa studimi, por jo pa kaluar më parë në sitë moralin, buxhetin dhe zakonet e familjes së kandidatit. Gazeta e saj, *Zaman*, që u vetëshpërbë disa javë pas tentativës për grusht shteti në vitin 2016, kishte dhjetë botime lokale në Europë (Gjermani, Austri, Bullgari, Belgjikë, Danimarkë, Spanjë, Francë, Maqedoni, Hollandë, Rumani, Mbretëri e Bashkuar, Zvicër), me një shpërndarje totale që ndonjëherë shkonte deri në 50 000 kopje (12 000 në Francë).

Paralelisht me këtë, është bërë një punë shumë e madhe me marrëdhëniet me publikun, duke shenjuar mjediset intelektuale, fetare dhe politike. Shoqata e industrialistëve të lëvizjes *Turkish Confederation of Businessmen and Industrialists (Tuskon)*, financon mbajtjen e konferencave në partneritet me *Think tanks* europianë më bazë në Bruksel. Universiteti i Louvain-it në Belgjikë, ka një katedër për studimet ndërkulturore Fetullah Gulen. Në Francë rrjetet organizonin çdo vit një darkë në hapësirat e Parlamentit. Nëse të zgjedhurit nuk shqetësohen aspak për të njohur

* Gazetare, autore e *Turqia, Ora e së vërtetës*, botimet Empreinte temps présent, Tharoux (Gard), 2019.

STRATEGJIK – OBJEKTIVAT E REXHEP TAIP ERDOGAN

armikja e pamundur

Turqia është e vetëdijshme se asnjë vend dhe as grup vendesh nuk janë në gjendje t'i garantojë siguri si ato që i jep NATO-ja. Kontratrat e shumta të armatimeve në projekt apo negociim e sipër me fuqitë perëndimore, dëshmojnë, nga njëra anë, shumëllojshmërinë e akteve të diplomacisë së saj për të forcuar aftësitë e veta mbrojtëse. Në fakt, sasia e raketave Patriot që janë aktive në bazën e Incirlikut nuk mjaftojnë për të mbuluar të gjithë kufirin e saj lindor dhe jugor.

TENSIONET E VAZHDUESHME ME RUSINË

Z. Donald Trump e ka minimizuar përgjegjësinë e turqve në blerjet e raketave ruse S-400. Sipas tij faji bie mbi z. Barack Obama, të cilin e akuzoi se pengoi Ankarën të blejë raketa Patriot. Kjo nuk e ndaloj, që menjëherë pas furnizimit të elementeve të parë S-400, të merrte masa shpagimi duke e përjashtuar Turqinë nga programi i avionëve të luftës F-35: përjashtim nga zinxhiri i prodhimit, dëbim i pilotëve turq gjatë stërvitjes, ndalim për vendim që të blejë pajisje. Në kundërshtim me këtë qëndrim, z. Jens Stoltenberg, sekretar i përgjithshëm i NATO-s, bëri një mbrojtje të vërtetë në favor të Ankarasë në hapje të *Aspen Security Forum*, organizuar në Kolorado më 17 korrik 2019: “Roli i

Turqisë në NATO shkon përtej F-35 apo dhe S-400”.

Çfarë mund të thuhet tani për marrëdhëniet midis Ankarasë dhe Moskës? Nëse sot duket se po ndjekin një rrjedhë të harmonizuar, ngjarjet e viteve të fundit treguan se ato qëndrojnë në ekuilibër të paqëndrueshëm. Në fakt, midis Ruisë dhe Turqisë nuk mund të jetë realisht e mundur, as aleanca strategjike dhe as shkëputja totale. Frika se ndonjëherë dëgjohet të flitet për ndonjë aleancë ruso-turke që do të vihej përballë perëndimit, mbështetet në një perceptim të gabuar të vendit dhe objektivave të të dy vendeve në skenën ndërkombëtare.

Sigurisht, shumë aspekte duken se i afrojnë: fakti që i klasifikojmë rregullisht në grupin “e vendeve me ekonomi në rritje”, prirja për regjim autoritar dhe të personalizuar të pushtetit, marrëdhënie kundërvënies me Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara, lidhja nostalgjike ndaj një të kaluarë të lavdishme dhe, së fundi, vullneti për t'u afirmuar në planin ndërkombëtar. Megjithatë janë dy aktorë që vijnë nga kategori tërësisht të ndryshme.

Ndërkohë që Rusia po rifiton vendin e saj në skenën botërore, Turqia nuk e ka gjetur asnjëherë këtë vend dhe vazhdon ta kërkojë. Kjo asimetri e vazhdueshme çon në tensione të përsëritura midis dy kombeve, që

interesat e tyre politike dhe ekonomike të përbashkëta, nuk arrijnë dot t'i zhdukin. Kthimi i Ruisë mes fuqive të mëdha, ka ndodhur këto vitet e fundit, në kurriz të ambicieve të Turqisë që kërkon të pozicionohet si lider i zonës. Përmes implikimit të saj në krizën siriane, Moska mban marrëdhënie me të gjithë aktorët e zonës dhe luan, më në fund, rolin qëndror që Ankaraja kishte marrë përsipër nën ndikimin e Z. Davutoglu. Për më tepër, impulsiviteti i Z. Rexhep Tayip Erdogan dhe paaftësia e tij për të përcaktuar një perspektivë të qartë, shpjegojnë, midis të tjerave, pse Turqia nuk shfaqet në një pozicion të fortë në negociatat për dosjen siriane, ndërkohë që nuk merret në konsideratë asnjë zgjidhje për konfliktin pa praninë e saj.

Në përgjithësi, vetë koncepti i aleancës apo i partneritetit që dikton disa detyra dhe detyrime politike reciproke, nuk të lejon të kapësh natyrën thellësisht pragmatike të marrëdhënies ruso-turke. Nuk duhet ngatërruar bashkëpunimi ideologjik, politik dhe ekonomik, me një afri strategjike në një logjikë aleatësh dhe as të harrohet rivlerësimi konstant i interesave të saj nga secili vend. Është e sigurt se Turqia nuk e shikon Rusinë si armike, apo si një kërcënim, ndryshe nga aleatët e saj perëndimorë.

Nuk ka aleancë strategjike, interesi dypalësh i dy aktorëve për

bashkëpunim e bën të pamundur skenarin e një shkëputjeje totale. Megjithatë tensione, madje, përplasje të drejtëpërdrejta mund të mendohen, Turqia mbetet një partner i domosdoshëm i Z. Vladimir Putin, nëse ai kërkon të arrijë objektivat në Siri dhe të konkretizojë ambiciet e tij ndërkombëtare. Kremlini duket se e ka kuptuar këtë gjë, duke i lënë Ankarës një lloj hapësire për të vepruar në Verilindje të Sirisë përballë kurdëve të organizuar në gjirin e Partisë së bashkimit demokratik (PYD), apo edhe në krahinën Idlib, aty ku Turqia ka ndikim mbi grupet rebele. Nga ana e tij, z. Erdogan e shikon bashkëpunimin me Rusinë si një mjet për të mbajtur nën kontroll çështjen kurde që ai e gjykon ekzistenciale për vendin e tij. Edhe pse nuk përjashtohen ndryshime taktikash, në sytë e Ankarasë, politika e Moskës në zonë është shumë më pak destabilizuese për interesat e saj sesa ajo e Uashingtonit.

Në terma afatshkurtër, marrëdhënia ruso-turke, në një pjesë të mirë të saj, do të përcaktohet nga kthesa që do të marrë konflikti sirian dhe negociatat për zgjidhjen e tij. Ajo duhet lexuar, përmes prizmit të raporteve të secilit nga këto dy vende me Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara.

Përfundimisht, zhvillimet e politikës së jashtme të Turqisë rrjedhin si nga kërkimi për një kohë të gjatë të

identitetit të saj, çka është e dukshme që prej pesë dekadash tashmë, ashtu dhe nga vullneti i kohëve të fundit për të kuptuar paradigmat e reja që ndërtojnë marrëdhëniet ndërkombëtare. Që sot e tutje, vlerat që vendet perëndimore i konsiderojnë akoma – pak a shumë jo qartë – si universale, nuk arrijnë më të pranohen as nga pikëpamja ushtarake, politike dhe kulturore. Përtej shumëllojshmërisë së tyre, fuqitë e ashtuqajtura të zhvilluara po afirmohen në skenën politike botërore, dhe po prishin ekuilibrat e vjetër. Turqia është një shembull i kësaj tronditjeje botërore dhe presidenti Erdogan shpreh, rregullisht, refuzimin e tij për një rend ndërkombëtar të përbërë nga pesë anëtarë të këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara.

“Këmbëngul duke e përsëritur: Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara duhet të riformohet në mënyrë që ta përfaqësojë më mirë botën në ditët e sotme. Këtë dua të them kur shpjegoj që bota është më e madhe se pesë”, deklaroi ai gjatë sesionit mbyllës të asmblesës së 62-të parlamentare të NATO-s, më 21 nëntor 2016 në Stamboll.

Aleatët tradicionalë të Turqisë duhet të mësojnë të veçojnë atë që varet nga qëndrimi sipas rrethanave – shpesh i motivuar nga arsytet e politikës së brendshme – nga ajo që, në mënyrë hipotetike, do mund të bëhej strukturë në vitet e ardhshme.

strehë gylenistët

natyrën e shoqatave franko-turke që i flonin në këto darka, përgjegjësit të departamentit të kulteve në ministrinë e brendshme, nuk i shpëtonte asgjë, për më tepër që gylenistët ngulmonin të vendosnin kontakte të mira me shërbimet sekrete kombëtare.

Në Parlamentin Europian, më mikpritësi është treguar grupi i të Gjellbërve. Një funksionar i lartë i BE-së, njohës i sekreteve të politikës turke, tregon se deputetët e gjelbër kishin “mbështetur një seri nismash që mbanin hapur firmën e gylenistëve”, si ajo e vitit 2012 kur u hap një ekspozitë fotografish në gjirin e Parlamentit të organizuar nga Zaman më rastin e 25 vjetorit të tij. Bashkëbiseduesi ynë nuk e fshih habinë e tij, madje zemërimin e tij: “Ta kthesha Zamanin në simbolin e lirisë së shtypit, ishte diçka absurde. Kur u informova, mësova se ishte pikërisht (Daniel) Cohn-Bendit, dora vetë që e mbështete këtë ngjarje!” në krah të kryeredaktorit të gazetës, Z. Ekrem Dumanli, ekstradimi i të cilit i qe kërkuar Shteteve të Bashkuara nga Ankaraja.

“NË ANTIPOD ME TË GJITHA DEMOKRACITË”

Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut, ka mbledhur, edhe ajo, shumë juristë të dërguar nga Ankaraja. Një funksionar i lartë turk, njohës i mirë i instancave të BE-së

tregon: “Ishin prokurorë të rinj. Ne, turqit, e dinim që ata ishin gylenistë. Për ta flitej hapur në zyrat e Këshillit të Europës. Të gjithë u thirrën në Turqi duke nisur nga viti 2013, kur shpërtheu lufta midis Erdogani-t dhe Gülen-it.”

Në Azi, në Afrikë, por edhe në kufijtë e Evropës, si në Kosovë apo dhe në Moldavi, u hoqën shumë kadro gylenistë nga komandot speciale të dërguara nga Ankaraja. Edhe brenda BE-së, këta përgjegjës kanë marrë kërcënime: fotografi të rrugës së tyre, të ndërtesës së tyre, të makinës së tyre u botuan në shtypin pro-qeveritar turk, dhe mesazhi duhej të ishte: “Nuk na shpëtoni dot!” Ndodh që, praktika e tyre e gjatë në institucionet europiane i ka bindur një numër të mirë syresh se do të ishin më të mbrojtur brenda BE-së, sesa gjetkë – sido që refuzimi nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i mijëra kërkesave adresuar asaj, menjëherë pas grushtit të shtetit të dështuar në vitin 2016, i zhgënjeu shumë. Për tu mbajtur, ata u kapën pas idesë së durimit (sabër) përballë sprovës (mysibet)

Për shumicën e gylenistëve që janë në arrati, Greqia përbën etapën e parë. Të gjithë ata që kanë fatin të vazhdojnë rrugën e tyre në Europë duhet të derdhin një shumë prej 1 000 eurosh për të ndihmuar ata që vinë pas. Emre, që tani jeton në

Greqi, ishte prokuror në Gjykatën e Lartë të Ankarasë në kohën kur gylenistët ishin në majë të fuqisë së tyre në zemër të aparatit të Shtetit. Nuk e kishte menduar kurrë se një ditë do t'i paguante 10 000 euro një varkëtar, para se ky i fundit ta braktiste, atë dhe dy familje siriane në një varkë plastike që rrezikonte të mbytej. «Deti Egje ishte shumë i trazuar, ne hiqnin ujën që mbushte varkën, ishte natë dhe një anije e madhe po vinte drejt nesh. “Lute-mi!” u thashë sirianëve, gjithmonë duke menduar për titujt e mëdhenj të gazetave turke që lajmëronin mbytjen tonë: “Një gjykatës u arratis nga demokracia dhe u ndërshkua...”»

E shtypur në Turqi, e dobësuar financiarisht, me anëtarët e saj të kërcënuar me jetë, lëvizja nuk e braktisi objektivin e saj politik parësor: rrëzimin e Erdoganit. Arma e saj: nuk ishte krijimi i një partie politike që do të luante rolin e institucioneve dhe të zgjedhjeve, por një fushatë komunikimi shumë agresive dhe destabilizuese për pushtetin.

«Ata janë në opozitë të hapur me Erdoganin, por gjithmonë shtetarë, gjithmonë antidemokratë në lidhje me çështjen kurde. I vetmi aspekt pozitiv është se nuk janë më armiq me të majtët”, gjykon gazetari Ragip Duran, edhe ai i arratisur në Greqi.

Në Suedi ku legjislacioni mbi shtypin është vecanërisht liberal, një

bërthamë gazetarësh u mblodhën rreth një pene gyleniste: Abdullah Bozkurt. Shumë të pranishëm në rrjetet sociale, vecanërisht në Twitter, ata vazhdojnë të vënë në shënjestër presidentin turk duke denoncuar persekutimet, që kanë pasur si objekt njerëzit e tyre, dhe nxjerrin dokumente të brendshme mjaft shqetësuese për pushtetin. Politologu turko-suedez Halil Karaveli nuk i kursen kritikën e tij: “Me tentativën e grushtit të Shtetit – dhe para kësaj, nëpërmjet manovrave të errëta për të marrë në dorë Shtetin turk dhe përfshirja e mundshme e tyre në vdekjen e gazetarit dhe shkrimtarit armen Hrant Dink – gylenistët treguan se janë në antipodë me çdo lloj demokracie. Ata janë, gjithashtu, përgjegjës po aq sa Erdogani për rrëzimin në autoritarizëm të Turqisë.

ORA E RINDËRTIMIT

Në Stokolm, një gazetar i ri i lëvizjes, Ahmet Donmez, kërkon të hedhë dritë mbi rolin e gylenistëve në tentativën për grusht ushtarak shteti. Bashkë me shumë ndjekës të tjerë të sigurtë në angazhimin e tyre, ai ka ndjesinë e hidhur se i kanë mashtruar – edhe pse ata nuk e pranojnë gjithmonë këtë gjë para të huajve. Këtu, por edhe atje në Europë janë mbajtur shumë mbledhje të brendshme, duke bërë bashkë përfaqësuesit e ndryshëm të hierarkisë – “të vjetrit”,

si Z. Yesil dhe brezi i ri. Sipas dëshmisë së dy pjesëmarrësve, një drejtues provokoi një thirrje për protestë duke hedhur idenë që të bëhej në Evropë ajo që ndodhi në Turqi, që do të thotë infiltrimi në institucionet shtetërore. I pyetur në lidhje me këtë protestë të brendshme, Z. Yesil e zvogëlon problemin:

“Lëvizja Güleniste në Europë i kryen aktivitetet e saj në mënyrë transparente dhe nuk ka pasur asnjë problem. Duhet pak kohë për të siguruar integritetin e anëtarëve të Hizmet-it që kanë mbërritur në kontinentin këto vitet e fundit, dhe që kanë paguar një taksë të rëndë në Turqi.”

Por, nga ana tjetër, të gjithë bien dakort për një gjë: pikërisht në Europë rrjetet gyleniste mund të shpresojnë të rindërtohen. Që tani e tutje shoqatat e tyre depozitojnë statute tërësisht zyrtare. Ora e autokritikës dhe rindërtimit ka rënë. “Thamë se përpjekja jonë ishte civile, por u fiksuam pas Shtetit. Thamë se ishim apolitikë, por ne mbështetëm një parti politike. Fillimisht duhet të fshijmë plehrat përpara portës tonë”, deklaroi njëri nga anëtarët e tyre. Sipas një tjetri, nga këta “disidentë”, tradicionalët, për momentin do të dalin mbi modernët. Debatet e brendshme, në të gjitha rastet nuk sollën asgjë. Parashikimet e tij? “Për aq kohë sa Fetullah Gülen është akom gjallë, nuk do të ndodhë asgjë. Çfarë do të ndodhë më pas? Lëvizja do të shpërthejë.”

Mes SHBA-së dhe Kinës një luftë

Pasi u shndërrua në ekonominë e tregut, Kina do të duhej të ishte vetëm një lidhje në zinxhirët e prodhimit të një ekonomie globale të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara dhe shumëkombëshet e tyre. Por shpejtësia e zhvillimit të saj shqetëson tani udhëheqësit amerikanë. Prandaj ata po punojnë për ta dërrmuar një konkurrese që ka dalë më shpejt sesa pritej dhe kërcënon pozicionin e tyre si një superfuqi hegjemonike.

NGA PHILIP S. GOLUB*

Më 26 qershor 2016, Z. Donald Trump mbajti një fjalim të rëndësishëm në të cilin foli për programin ekonomik dhe tregtar ndërkombëtar që do të zbatonte nëse do të zgjidhej. Përmbajtja e përgjithshme e fjalimit të tij ishte një kritikë e ashpër ndaj politikave amerikane, që akuzoheshin se i "kishin bërë një politikë agresive mondializimi (që) zhvendosi vendet tona të punës, pasurinë tonë dhe uzinat tona jashtë vendit", duke çindustrializuar dhe "shkatërruar" shtresën mesatare të popullsisë në Shtetet e Bashkuara. Duke denoncuar një "klasë drejtuese që po adhuron mondializmin në vend të amerikanizmit", ai e cilësoi Marrëveshjen e shkëmbimit të lirë amerikano-verior (Alena), Organizatën botërore të tregtisë (OBT), praktikën ekonomike kineze dhe Partneritetin transpaqësor (PTP), si shkaqet kryesore të perëndimit të sektorit industrial të vendit të tij. Përballë turmës, ai deklaronte se do t'i tërhiqte Shtetet e Bashkuara nga PTP-ja, do të rindegocionte me Alenën, do t'i vinte sanksione Kinës të cilën e akuzonte se "manipulonte" tregjet valutore, "do të hapte procese gjyqësore kundër praktikave tregtare "mashtroese", do të zbatonte taksat e doganës për importet që vinin nga Republika popullore (RPK) "dhe do të përdorte të gjitha pushtetet presidenciale të ligjshme për të rregulluar mosmarrëveshjet tregtare (dypalëshe)" me Pekinin.

Në atë periudhë shumë pak vëzhgues e morën seriozisht këtë sulm verbal kundër mondializimit dhe arkitekturës institucionale të tregtisë ndërkombëtare. Pastaj, zgjedhja e z. Trump duket e pamundur. Dhe, nëse rastësisht, do të vinte në pushtet Thesari amerikan dhe konstelacioni i aktorëve ekonomikë që kanë interesa

të rëndësishme në ruajtjen e "tregut të lirë" botëror do ta detyronin të arsyetonte siç duhej. Institucionet lider të ekonomisë dhe sigurisë në ngritura nga Shtetet e Bashkuara që në konferencën e Bretton Woods në vitin 1944, duke patur si objektiv ruajtjen për një kohë të gjatë të pozicionit të tyre qëndror, do të kishin peshë në marrjen e vendimeve. Zëri i segmenteve më të ndërkombëtarizuara të kapitalizmit amerikan do të dominonte. Këto modalitete organizative të bëjnë të mendosh se asnjë president, po aq idiosinkretik (Idiosinkretik: tendencë për të reaguar personalisht ndaj elementeve të jashtëm), sa presidenti Trump, nuk mund të largohej kaq qartazi nga politikat dhe kuadrot që, për një kohë të gjatë, kanë siguruar hegjemoninë e Shteteve të Bashkuara. Por, këto hipoteza mbivlerësonin peshën e kapitalit në përcaktimin e trajektoreve të botës dhe nënvlerësonin potencialin politik që lindën si pasojë e rritjes së fuqisë së Kinës, që Shtetet e Bashkuara synojnë sot ta bllokojnë, pa u lodhur. Nisur nga ideja se Kina "përfaqëson një kërcënim thelbësor afatgjatë", sipas Znj. Kiron Skinner, drejtoreshë e planifikimit politik në gjirin e departamentit të Shtetit, kjo përpjekje është duke tjetërsuar natyrën e raporteve ndërkombëtare dhe ndryshuar rrjedhën e mondializimit. Pas viti 1991, aksi qëndror i politikës ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara ishte propagandimi në botë i modelit amerikan të kapitalizmit të tregut. Nën emërtimin përgjithësues "konsensus i Uashingtonit", Thesari amerikan dhe Fondi Monetar ndërkombëtar vunë në zbatim një program liberalizimi, çrregullimi dhe privatizimi botëror që iu imponua në fund të viteve 80 dhe në vitet 90 "vendëve në zhvillim", të zhytura në borxhe, pra të dobëta, të Afrikës subsahariane dhe të Amerikës latine

Koha kur Pekini ishte një aleat

Pas krizës financiare aziatike të viteve 1997-1998, sistemet ekonomike të vendeve të reja të industrializuara të Azisë lindore dhe të atyre në zhvillim të rajonit, u vunë, gjithashtu, në pikëpyetje. Nën një presion shumë të fortë, ekstrem, politikat industriale shtetërore dhe mbrojtja e tregjeve të brendshme ua lanë vendin, në nivele të ndryshme, sprapsjes së Shtetit dhe hapjes drejt investimeve

ndërkombëtare. Fushata zyrtare, më shumë e bazuar mbi shtrëngimin sesa mbi bindjen, u promovua nga shoqëritë multinacionale dhe transnacionale që kërkonin të hynin në tregjet, më herët, të mbyllura. Për to, rënia e Bashkimit Sovjetik krijoi kushtet e një periudhe të dytë të artë të kapitalizmit ndërkombëtar, pas atij të fund shekullit të XIX-të, të ndërprerë nga dhuna e masave në shekullin që vijoi. Shtetet e Bashkuara ishin shndërruar në fuqinë e vetme të madhe, dhe në vitet 1990, objektivat e shtetit dhe të kapitaleve përkuan me nivele të jashtëzakonshme. Ky

President Donald J. Trump and Xi Jinping, President of the People's Republic of China / June 29, 2019 / Official White House Photo by Shealah Craighead



Iloj konfigurimi mund të krahasohej me simbiozën midis shtetit perandorak dhe kapitalit në pikën kulminante të internacionalizimit britanik, ndërkohë që objektivat e tyre respektive të rritjes së pushtetit dhe të pasurisë ishin të lidhura në funksion me njëra-tjetrën. Kjo përpunje intersash e drejtoi qeverinë britanike që të punonte për kapitalin (nëpërmjet forcës ose kërcënimit për ushtrimin e forcës, nëse do ishte e nevojshme, si në Amerikën Latine, në Kinë dhe në Egjipt). Ajo i detyroi investitorët privatë t'u përkuleshin lehtësisht kërkesave strategjike të Shtetit perandorak kur t'ua kërkonte situatë botërore – psh, në rastin e Rusisë, në investitorëve iu la të kuptohej se ekuilibri i forcave në Europë qëndronte mbi fitimin. Në mënyrë të ngjashme, shteti amerikan luajti një rol vendimtar pranë ndërmarrjeve multinacionale dhe bankave në krijimin dhe shpërndarjen e liberalizimit botëror në fund të shekullit XX-të. Siç e shkruan dhe Stephen Walt, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në Harvard, drejtuesit amerikanë "panë në fuqinë e pakundërshtueshme që kishin në dispozicion, mundësinë për të transformuar mjedisin ndërkombëtar me qëllim që të përmirësonin akoma pozicionin e Shteteve të Bashkuara dhe të mblidhnin më shumë avantazhe në të ardhmen", duke shtyrë "sa më shumë vende që të aderonin në vizionin e tyre të veçantë të një rendi kapitalist liberal".

Në atë kohë, elitat politike dhe ekonomike amerikane e konsideronin Kinën më shumë si një aleat sesa si një rivale, dhe padyshim jo si një kërcënim. Republika popullore ishte bashkuar me të njëjtën kauzë të përbashkët me Shtetet e Bashkuara, në fund të viteve 1960 dhe 1970, rreth projektit për të bllokuar Bashkimin Sovjetik. Marrëdhëniet diplomatike u vendosën më 1 janar 1979 dhe, në më pak se një muaj më vonë,

Ten Hsiao Pin ndërmori një turne prej nëntë ditësh në Shtetet e Bashkuara për të festuar këtë ngjarje. Me këtë rast, sipas gazetarit të *Guardian* Jonathan Steele, ai deklaroi se Kina dhe Shtetet e Bashkuara kishin si "detyrë të punonin tok (...) (dhe të bashkoheshin për t'iu kundërvënë ariut polar". Gjatë ceremonisë në Shtëpinë e Bardhë, flamuri i kuq kinez valëvitej krenar dhe ndërkohë që kumbonte përshëndetja tradicionale prej nëntëmbëdhjetë goditjesh të topit "një furgon i vogël që shpërndante Coca-Cola të kuqe të errët, kaloi jo shumë larg (...) një simbol ky, i mundësisë për miliona dollarë (...) që biznesmenët amerikanë, të paduruar, (shpresonin) të mblidhnin falë oreksit të ri të Kinës për tregtinë, teknologjinë dhe kreditë amerikane".

Në vitet 1980, Kina nisi një liberalizim të kufizuar të tregut të brendshëm dhe një hapje graduale ndaj investimeve ndërkombëtare. Në vitin 1986, ajo kërkoi të aderonte në Marrëveshjen e përgjithshme mbi tarifën doganore dhe tregtinë, pararendëse e OMC-së. Më pas, në fillim të viteve 1990, pas shpërbërjes së Bashkimit

Sovjetik dhe një pushimi prej tre vjetësh, të nesërmen e ndryshimeve të Tiananmen-it (1989), Ten manovroi me shpejtësinë më të lartë. Ai zgjeroi ristrukturimin e brendshëm dhe përshpejtoi ndërnacionalizimin dhe integrimin e vendit në ekonominë botërore. Lidhja gjeopolitike e integritit ekonomik ishte në pajtim me Shtetet e Bashkuara për të shmangur përballjet e afta për të kompromentuar tranzicionin. Kjo zgjedhje u verifikua në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara ku Kina bëri kujdes që të frenonte aksionin diplomatik të Shteteve të Bashkuara. Këta të fundit, nga ana e tyre, u munduan të fusnin Pekinin në disiplinën institucionale dhe tregtare të ekonomisë botërore perëndimore, rregullat e së cilës dhe kufizimet ishin fiksuar në Uashington (Shtetet e Bashkuara vendosën kushte strikte për pranimin e Kinës në OMC, gjë që u bë efektive vetëm më 11 dhjetor 2001). Nisur nga postulati se liritë ekonomike dhe politike ishin domosdoshmërisht të lidhura, duke vepruar nga një pozitë e fortë, elitat amerikane vlerësuan se mund të vinin në punë trajektoren kineze në këto dy plane.

Të çlirohesh nga të gjitha rregullat

Gjatë hapjes së saj, Kina u shndërrua në një destinacion gjithmonë e më shumë të rëndësishëm për investimet direkte jashtë vendit. Hyrjet neto arritën mesatarisht shifrën 2,2 miliardë dollar në vit (në dollar ndërkombëtarë) midis viteve 1984-1989 dhe shifrën 30, 8 miliardë dollarë në vit midis 1992-2000, ndërsa kjo shifër shkoi në 170 miliardë dollarë në vit gjatë periudhës 2000-2013. Ndërkohë që RPK kërkonte t'i përdorte për të përfutur teknologji dhe dije, pjesa më e madhe e investimeve, fillimisht, ishin të destinuar për të shkuar në sektorët që

kishin një vlerë të shtuar të vogël, si tekstilet, apo dhe në industrinë e transformimeve si grumbullimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike me përbërës të prodhuar jashtë Kinës, për ndërmarrje botërore që kishin të drejtat e pronësisë intelektuale mbi prodhimet. Vëzhgues kritikë si Yasheng Huang, profesor në menaxhimin ndërkombëtar në MIT Sloan School of Management, vunë re se kishte "pak prova që tregonin se hyrjet e IDE-së në Kinë, mishëronin shumë teknologji të materies, të forta, apo të teknologjisë së metodologjisë, të buta (hendeku teknologjik midis vendeve investuese

* Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Universiteti amerikan i Parisit. Autor i librit *East Asia's Reemergence*, Polity Press, Cambridge, 2016.

NGA RIVALITETI QË KA PREKUR MAJËN

më pak tregtare dhe më shumë gjeopolitike

dhe Kinës ishte perceptuar deri në 20 vjet”. Fitimet e Kinës në zinxhirët e vlerave, modeli teorik i zhvillimit të aktivitetit të ndërmarrjes, ishin të dobëta, ndërsa fitimet e shoqërive transnacionale ishin shumë të mëdha. Kina duket e ngecur në strukturat e varësisë. Situata u zhvillua në fund të viteve 2000, dhe sot është ndjeshmërisht mjaft ndryshe. Përshtatja teknologjike, nëpërmjet transfertave të detyrueshme për investoret e huaj dhe modernizimi industrial ndërsektorial i kryer nga Shteti, i kanë lejuar Kinës të bëjë përpara në mënyrë progresive në shumë fusha të industrisë, duke përfutur një pjesë në rritje të vlerës së shtuar. Këto përparime dhe pesha ekonomike dhe politike e vendit në Azinë lindore filluan t’i shkaktonin shqetësime serioze Uashingtonit dhe kryeqyteteve të tjera perëndimore. Në vitin 2011, z. Barak Obama shpalli “aksin” e politikës amerikane për Azinë. Më pas, në fjalimin për gjendjen e Unionit në vitin 2015, ai deklaroi: “Kina dëshiron të shkruajë rregullat për rajonin botëror që po njej rritjen më të shpejtë. Përse ta lëmë të bëjë këtë gjë? Duhej t’i shkruanim ne këto rregulla”. Për të frenuar rritjen e Kinës, administrata aktuale zgjodhi të shkojë më larg duke i hequr qafe të gjitha rregullat e saj. E mbështetur nga Kongresi dhe nga aparati i sigurisë kombëtare, ajo e paraqiti Kinën si një kërcënim të madh. Shtetet e Bashkuara shohin tek ajo një vend të madh që është pasuruar shumë në një kohë shumë të shkurtër – prodhimi i brendshëm bruto për banorë ka shkuar nga 194 dollarë në vitin 1980 në 9174 dollarë në 2015. Ata shohin një shtet të fortë që ka inkurajuar dhe udhëhequr zhvillimin e konglomerateve industriale kombëtare, veçanërisht në telekomunikacion, në transportet detare dhe trenat me shpejtësi të madhe dhe që ia kushton një pjesë të mirë të prodhimit të brendshëm bruto, kërkimeve shkencore dhe teknike: më shumë se 2% në vitin 2016 përkundëjt 0, 6% në vitin 1996, kur kuota amerikane është 2, 74% ndërsa e Francës 2,25%. Ata shohin një vend që po modernizon marinën, i angazhuar në një fazë zgjerimi ekonomik ndërkombëtar nga aspekti i “rregullave të reja të mëndafshit” (Belt and Road Initiative, BRI), ku forca detare pati mundësinë që në këtë periudhë të kryente blerjen, ndërtimin apo shfrytëzimin e 42 porteve në 34 vende. Ata e dinë se Kina ka

akoma një prapambetje të madhe cilësore në raport me Shtetet e Bashkuara në pjesën më të madhe të fushave teknike të ndjeshme, prandaj janë thellësisht të shqetësuar nga fakti se ashtu si Japonia në vitet 1970 dhe në fillim të viteve 1980, ajo po u afrohet me shpejtësi. Ashtu siç shkruan Financial Times, Uashingtoni “kërkon të kontrollojë fuqizimin e Kinës” para se përpjekjet e saj për modernizim të maturohen. John Mearsheimer, studiues realist në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe një ndjekës fanatik i frenimit, mbështet faktin se Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë gjithçka për të ndaluar riemergjencën kineze dhe që “ekonomia kineze të bjerë”, para se Kina të shndërrohet në një “Hong Kong gjigand”. Për këtë gjë ata pakësuan importimin e mallrave me origjinë kineze në tregjet amerikane (një luftë tregtare), përjashtuan ndërmarrjet kineze nga sektorët e teknologjisë së lartë ku kanë një përparim në cilësi, kundërshtuan kërkesat

territoriale të Pekinit në detin e Kinës jugore me motivin që prania e saj në ishuj do të ishte “një kërcënim për ekonominë botërore” – sipas Z. Rex Tillerson, sekretar i Shtetit amerikan nga shkurti 2017 deri në mars 2018, - vendosën kontrolle strikte për vizat e studentëve të huaj dhe kontrolle sigurie të të gjithë studentëve kinezë të diplomuar. Masat energjike juridike dhe institucionale të marra nga Uashingtoni kundër konglomeratit të telekomunikacioneve Huawei, furnizuesi më i madh botëror i pajisjeve për rrjetet informatike të lidhura nëpërmjet valëve, përbëjnë dhe hapat e parë vendimtarë në këtë metodë. Administrata rekomandon ndalimin në shkallë botërore të pjesëmarrjes së Huawei-t në ndërtimin e infrastrukturave 5G, me rezultate jo shumë strikte. Më 1 dhjetor 2019, Kanadaja arrestoi Znj. Meng Wanzhou me kërkesë të Shteteve të Bashkuara. Drejtoresha financiare e Huawei-t u akuzua për mashtrime bankare dhe konspiracion

me qëllim kryerjen e mashtrimeve pasi, me gjasë, ka shkelur sanksionet amerikane kundër Iranit, ka vjedhur sekrete tregtare, dhe kështu ajo ka nisur një betejë juridike kundër ekstradimit të saj. Siç shkruan me mjaft shqetësim Financial Times (20 maj 2019), “vendimi amerikan për të vënë më të mirën e telekomunikacionit kinez në listën e entiteteve me të cilat ndërmarrjet amerikane nuk mund të bëjnë tregti, pa pasur një licensë qeveritare, shënon një moment shkatërrues për industrinë teknologjike botërore. Kjo provokon fillimin e një lufte të ftohtë midis Shteteve të Bashkuara dhe Kines (...). Masat e fundit amerikane duket se janë marrë për të paralizuar apo shtypur një nga ndërmarrjet e para teknologjike kineze që po konkurojnë në shkallë botërore (...). Bëhet fjalë për një përpjekje për shkapëtuje të sektorëve teknologjikë amerikanë dhe kinezë, duke realizuar një ndarje të kësaj industrie botërore”.

Për më tepër akoma, rivendosja në Shtetet e Bashkuara do të ulte në mënyrë të konsiderueshme fashat e tyre të fitimit. Megjithatë, vullneti politik duket i prerë. I pyetur nga CNBC më 10 qershor 2019, z. Trump denoncoi Dhomën e tregtisë amerikane për mbështetjen e saj në mbarëvajtjen e marrëdhënies tregtare me Kinën dhe deklaroi se “do të vendoste taksat doganore prej 25% mbi të gjitha importet me origjinë nga Kina (kundër pothuajse gjysmës së importeve që dominohen aktualisht nga tarifrat e reja) nëse ky vend nuk do të respektonte kërkesat e Shteteve të Bashkuara. Sipas tij, kjo gjë do t’i detyrojë ndërmarrjet amerikane “të shvendosen gjatë” (...) Ato (do të shkojnë) në Vietnam ose në një nga vendet e tjera të shumta me mundësi, ose do fabrikonjë produktet e tyre në Shtetet e Bashkuara, që është dhe opsioni im i preferuar”. Në këtë pikë, presidenti gëzon mbështetjen e drejtuesve të partisë demokrate në Senat, shefi i të cilit Z. Chuck Schumer, kërkoi të mbahet një pozicion autoritar kundërt Kinës. Një tension i ri vendoset midis palëve më të ndërkombëtarizuara të kapitalit dhe Shtetit. Ndryshe nga Bashkimi Sovjetik, që gjendej jashtë ekonomisë kapitaliste botërore, Kina është shndërruar në një përbërëse thelbësore të saj. Kapitalizmi, i përcaktuar më së miri, nga Fernand Braudel si “kati i sipërm”, i aktiviteteve ekonomike, ku tregtia në distancë të largët nxjerr përfitimet më të mëdha, lulëzoi në hapësirën globale, dhe jo në tregjet e ndara sipas linjave kombëtare. Ky kat që Braudel e veçon nga tregjet lokale të “katit përthës”, kërkoi një ekonomi botërore të hapur ku kapitali të kalojë pa pengesa. Me disa përjashtime të rëndësishme, si psh sektori i mbrojtjes dhe industrisë së hidrokarbureve, i lidhur ngushtë me shtetin, elementët kyç të kapitalit kanë rëndësi dhe interesa në shkallë botërore. Situata aktuale konteston hipotezën liberale sipas së cilës shkala e ndërpavarësisë e arritur në fundin e shekullit të XX-të kishte futur një ndryshim të pakthyeshëm në marrëdhëniet sociale botërore. Ajo vë sërish në pikëpyetje perspektivat neomarksisite që konsideronin emergjencën e një “klase mbizotëruese transnacionale” e cila tejkalon përfundimisht politikën dhe Shtetin. Do të ishte naive të mendohet se Kina do të përkulej nën presion. Më 30 majin që shkoi, The Global Times, një e përditshme që reflektonte përgjithësisht linjën zyrtare, shkroi: Kina është gati për një betejë tregtare afatgjatë me Shtetet e Bashkuara. Në krahasim me vitin e kaluar, kur Shtetet e Bashkuara filluan luftën tregtare, opinion publik kinez është më i favorshëm që qeveria të marrë kundërmasa të ashpra. Gjithmonë e më shumë kinezët besojnë se qëllimi i vërtetë i disa elitave në Uashington është shkatërrimi i aftësive të zhvillimit të Kinës dhe se këta njerëz kanë marrë peng politikën e Shteteve të Bashkuara ndaj Pekinit. Nga njëra anë në tjetrën, kërkesa për pushtet duket sikur po e parakalon kërkesën për fitime. Ndërveprimet midis nacionalizmave amerikanë dhe kinezë mund t’i japin fund fare mirë mondializimit ashtu siç e njohim ne.

Ndërmarrjet “antipatriotike”

Kina është gati për një betejë tregtare afatgjatë me Shtetet e Bashkuara. Në krahasim me vitin e kaluar, kur Shtetet e Bashkuara filluan luftën tregtare, opinion publik kinez është më i favorshëm që qeveria të marrë kundërmasa të ashpra

-The Global Times

Shtetet e Bashkuara kërkojnë në fakt që të shkatërronjë zinxhirët e prodhimit dhe të vlerave transnacionale, që i sjellin leverdi gjithmonë e më shumë Kinës dhe kanë qenë një nga karakteristikat thelbësore të mondializimit të fundshekullit të XX-të. Lufta tregtare e nxitur nga Uashingtoni është drejtuar më shumë kundër shoqërive transnacionale që e kthen Kinën në një platformë grumbullimi dhe prodhimi, sesa kundër Pekinit. Autoritetet amerikane vlerësojnë se “një pjesë e madhe e zinxhirit të grumbullimit është zhvendosur drejt Kinës” dhe se multinacionalet që kanë investuar në Kinë, qoftë në mënyrë direkte, qoftë nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të nëntrajtimit në shumë nivele, janë pjesë e problemit. Ato i konsiderojnë aktivitetet kozmopolite të këtyre ndërmarrjeve si antipatriote – një argument që ka një gjenealogji të gjatë në mendimin nacionalist. Profesori i shkencave politike Samuel Huntington, i njohur për teorinë e tij të “përplasjes së qytetërimeve”, ka dhënë një formulim të shkurtër në vitin 1999 kur denoncoi “liberalët dhe universitarët” si dhe “elitë ekonomike” që ushqejnë “ndjenja antikombëtare” dhe mbështesin një “kozmpolitizëm (që gërryen) unitetin kombëtar” nga poshtë dhe nga lart. Ai e quante me urimet e tij “një nacionalizëm i fortë” bazuar në një trini kombëtare: Zoti, kombi dhe forcat e armatosura. Shpresa e administratës, por edhe e drejtuesve të lartë të Partisë demokrate dhe të aparatit të sigurisë, është që një konflikt tregtar i gjatë i lidhur me regjime të sigurisë shtërnguese, të tërheqë kosto abuzive për ndërmarrjet transnacionale, duke i shtyrë që të mos investojnë në Kinë dhe t’u japin fund transferimeve të teknologjisë si dhe formave të tjera të bashkëpunimit tregtar - si shitja e aparateve me prekje Huawei-t nga shoqëritë amerikane Intel dhe Micron. Kjo prek ndërmarrjet jo amerikane, meqë ligjet dhe rregulloret amerikane kanë një rëndësi botërore: ato aplikohen për të gjitha


prodhimet apo proceset ku futen përbërësit e prodhuar në Shtetet e Bashkuara ose që kanë të përfshira të drejtat e pronësisë intelektuale. Në të ardhmen, ato mund të zbatohen për të gjitha ndërmarrjet që përdorin dollarin në transaksionet e tyre, siç e tregon dhe rasti i bllokimit botëror aktual i Iranit nga Uashingtoni. Rezultatet nuk vonuan të dukeshin: Foxconn (Hon Hai Precision Industry), një ndërmarrje gjigande me origjinë tajlandeze që siguron grumbullimin në Kinë të produkteve Apple, si dhe emra të tjerë të mëdhenj të elektronikës, lajmëroi në prill të vitit 2019 plane për shumëllojshmërinë e kompanisë së saj në drejtim të Indisë dhe Vietnamit (dy vende rivale me Kinën), për tu mbrojtur kundër luhatjeve në të ardhmen në kompanitë e furnizimit aziatik. Që në shkurt, 66 shoqëri tajvaneze filluan të sillnin në vendin e tyre prodhimet nga Kina kontinentale në Tajvan, të mbështetura nga një program nxitës i qeverisë së Taipei-t. Më dhjetëra ndërmarrje amerikane dhe japoneze nuk po investonin më në Kinë duke shkuar drejt Meksikës, Indisë dhe Vietnamit. Sipas një studimi të fundit, mbi 200 shoqëritë kryesore amerikane aktive në Kinë, 120 po analizojnë apo do të analizojnë kompanitë e tyre të furnizimit gjatë muajve të ardhshëm. Procesi do të përshpejtohet nëse administrata intensifikon luftën tregtare. Sipas bankës Morgan Stanley, kostoja e iPhone XS do të rritet me 160 dollarë nëse Shtetet e Bashkuara do të zbatonin tarifrat doganore penguese mbi tërësinë e eksportimeve “kineze”. Neomerkantilizmat amerikanë, shpresojnë të çojnë një pjesë të zinxhirit të prodhimit në Shtetet e Bashkuara, gjë që administrata e kërkon me ngulim, por pa një rezultat të prekshëm deri tani. Ndërmarrjet transnacionale - veçanërisht, por jo vetëm, shoqëritë pa uzina, si Apple apo Nike – do të kishin nevojë për nxitje shumë të forta për ta bërë një gjë të tillë. Çmontimi i platformave të tyre kineze do të ishte një proces i kushtueshëm dhe i vështirë.



ANNA SEGHERS OSE ETIKA E HESHTJES

Gjermania Lindore pas mërgimit

Për artistët dhe intelektualët që pas vitit 1945 zgjodhën që të vijnë e të jetojnë në atë që do të bëhej Republika Demokratike e Gjermanisë (RDA), ishte imperative që të kontribuonin në ndërtimin e socializmit. Luajaliteti me bindjet e tyre do t'i shtyjë gjithnjë e më shumë që të pranojnë të heshtin, megjithë mospëlqimin me regjimin. Mes tyre, autorja e romanit tronditës "Tranzit", Anna Seghers është më emblematikja



Anna Seghers

NGA SONIA COMBE*

Fundi i Republikës demokratike gjermane (RDA), më 3 tetor 1990, i kurseu jetën Anna Seghers (1900-1983). Po të kishte jetuar disa vite më shumë, pa dyshim, që romancierja do firmoste thirrjen e 28 nëntorit 1989, të nisur nga shkrimtarja Christa Ëolf, në favor të qëndrimit të Gjermanisë Lindore si besnike të vlerave socialiste. Firmëtarët vinin përballë projektit të ribashkimit të kancelarit Helmut Kohl, atë të Republikës Demokratike të Gjermanisë "jo siç kishte qenë, por ashtu siç do të duhej të ishte". Një utopi? Ndoshta. Në vigjilje të tridhjetë vjetorit të rënies së murit të Berlinit, asnjë nuk guxon të pyesë për ligjshmërinë e ribashkimit të Gjermanisë. Ata që kishin justifikuar ekzistencën e Republikës Demokratike gjermane, e gjykan zhdukjen e saj si të merituar. Rendi i vendosur merr gjithnjë pamje racionale. Por është e vërtetë, gjithashtu, siç e përkujtoi qershorin e kaluar shkrimtari Christoph Hein gjatë festës së verës, organizuar në varrezat e *Chausseestrasse*, në Berlin, përpara varrit të Anna Seghers-it dhe jo larg atij të dramaturgut Bertolt Brecht, që "këtu është varrosur një brez i cili u sakrifkua për një të ardhme të cilën nuk e donte askush më". Një brez dyfish i mundur, sepse, tashmë, i lënë pothuajse në harresë – përveçse kur nuk gjendet në bankën e të akuzuarve.

Nga ky brez i kthyer nga arratia pas Luftës së Dytë Botërore, nga radhët e shkrimtarëve Brecht, Stephan Hermlin dhe Arnold Zëieg, historianit të ekonomisë Jurgen Kuczynski, përmendëm disa prej tyre, Anna Seghers është, padyshim, një nga figurat më përfaqësuese të këtij brezi. Përlësia e saj ndaj regjimit komunist, përforcuar nga besnikëria për t'u rikthyer në këtë pjesë të Gjermanisë, duket sikur e dënoi të mbante "etikën e heshtjes" për të cilën e qortuan pas rënies së Murit. Por, megjithatë, kur vëmë përballë njëra-tjetrës korrespondencën e saj me arkivat e Partisë ose më mirë akoma, me ato të Lidhjes së shkrimtarëve ku ishte president për një kohë të gjatë, – pa harruar natyrisht dosjet e Stasi-t që nuk reshiti së mbikqyruri romancierin më të njohur dhe më luajalë të Republikës Demokratike të Gjermanisë –, na vizatohet tjetër portret, shumë i ndryshëm nga ai që ajo shfaq publikisht deri sa vdiq në 1983.

Kur Anna Seghers braktisi Berlinin, në çastin e ardhjes në pushtet të nazistëve, ajo ishte një romanciere e konfirmuar, fituese e çmimit Kleist. E martuar me një komunist hungarez, mik me filozofin Georg Lukacs, ajo militoi në gjirin e partisë komuniste gjermane (KPD). Për më tepër, ajo ishte me origjinë çifute. Çifti dhe fëmijët e tyre u strehuan fillimisht në Paris. Me hyrjen e trupave gjermane në Francë, shkuan në Marsejë, nga ku do të largoheshin në vitin 1941 me ndihmën e gazetarit amerikan Varian Fry dhe të Komitetit të shpëtimit urgjent. (*Emergency Rescue Committee*). Gjatë këtij udhëtimi, Seghers do të shkruante dhe tregimin *Tranzit*, i cili u

SEGHERS, BRECHT, BLOCH, KUCZYNSKI APO EDHE ARNOLD ZWEIG, NUK JANË VETËM GARANCIA INTELLEKTUALE E REPUBLIKËS DEMOKRATIKE GJERMANE POR EDHE MENTORËT E NJË RINIE TË SHKATËRRUAR NGA ZBULIMI I MONSTRUOZITETIT TË REGJIMIT NË TË CILIN AJO U RRI, E NJË RINIE NË KËRKIM TË PERSONALITETEVE SI REFERENCË

ekranizua në vitin 2018 nga Christian Petzold me subject pritjen e një anijeje me antifashistë gjermanë në qytetin Phosée, Marseja. E skeduar si komuniste, ajo nuk e mori autorizimin për të qëndruar në Shtetet e Bashkuara dhe u vendos në Meksiko, ku botoi në vitin 1942, romanin që e bëri të njohur, *Kryqi i shtatë*, libri i parë mbi kampet naziste.

Numri i emigrantëve gjermanfolës, që nga viti 1933 s'ka mundur të jetë kurrë i saktë. Mendohet se numri i atyre që janë arratisur nga regjimi nazist të ketë qenë rreth 500 000, nga të cilët 130 000 arritën të shkonin në Shtetet e Bashkuara. Më pak se gjysma e tyre vendosën të ktheheshin pas mbarimit të luftës (nga ku vetëm 4% ishin çifutë), por, sërish, nuk ka statistika zyrtare në lidhje me këtë temë. Asnjë organizëm nuk u ngarkua të bënte këtë lloj regjistrimi, as në Gjermaninë perëndimore dhe as në Republikën Demokratike Gjermane.

TË GJESH NJË TË ARDHME

Një gjë është e sigurt: ndryshe nga emigracioni, kthimi drejt vendeve të origjinës nuk është një fenomen masiv. Jo vetëm ndërgjegjësimi mbi krimet naziste i dekurajon emigrantët, çifutë qofshin ose jo, që të mos kthehen, por kthimi i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve pushtuese. Madje, aleatët perëndimorë që ndajnë me sovjetikët kontrollin e Gjermanisë së mundur, mundohen t'i pengojnë, a fortiori kur bëhet fjalë për komunistët. Burokracia gjermane i ndihmoi në këtë detyrë. Vjen një çast kur gjermanët nuk i shohin me sy të mirë, "të kthyerit", a nga mëria, nga urrejtja ndaj antinazistëve, apo ngaqë ata u kujtojnë ndërgjegjen e trazuar. Në zonat nën autoritetin perëndimor, nuk ishte parashikuar asnjë lloj plan pritjeje.

Nga ana tjetër, zona e pushtuar nga sovjetikët mundohet t'i tërheqë. Deri në krijimin e Republikës Demokratike Gjermane më 3 tetor 1949, oficerë rusë zhvillojnë një politikë kulturore që do të sillte më pas frytet e saj. Kështu, pjesa e parë teatrale e luajtur në Berlin pas kapitullimit të Gjermanisë do të ishte *I urti Nathan*, i Gotthold Ephraim Lessing-ut, një nga librat e parë të

botuar mbi studimin e filologut Victor Klemperer për gjuhën naziste, ndërsa Ëolfgang Staudte do të realizonte filmin e madh të pas luftës *Vrasësit janë mes nesh*. Me këtë mund t'i siguroje kandidatët e mundshëm për kthim. Për më tepër, zona sovjetike u ofron të ardhmen që regjimi nazist ua kishte mohuar. Brecht-i propozon një teatër, filozofi Ernst Bloch një katedër në universitetin e Leipzig-ut, Alfred Kantorowicz një tjetër në Berlin. Jurgen Kuczynski, do të themelojë institutin e tij të historisë ekonomike.

Me të mbërritur në Berlin në vitin 1947, Anne Seghers rigjen sipas fjalëve të thëna prej saj "një popull zemër gur". Ajo flet për "çmendurinë e këtyre burrave dhe grave të cilëve bombardimet u shkatërruan gjithcka, mobilje dhe rroba, dhe që nuk kanë nxjerrë, aspak, asnjë mësim". Por, ata që zgjodhën të kthehen në këtë pjesë të Gjermanisë, u frymëzuan nga dëshira e zjarrtë për të rigjetur njëri-tjetrin, për t'u numëruar sërish, pas arratisjes dhe sprovave. Njëpërmjet krijimit të Republikës Demokratike të Gjermanisë, një lloj kundër-Gjermanie, ata jo vetëm që do ndërtojnë socializmin, por do të marrin dhe hak kundër atyre që i persekutuan. Më në fund ata hidhen me gjithë energjinë e tyre në ndërtimin e "shtetit të parë gjerman të punëtorëve dhe të fshatarëve", duke u përpjekur të mbyllin sytë para gjithçkaje që nuk u pëlqen, apo më keq akoma. Anna Seghers kontribuoi më shumë se të tjerët. Dëshmitare e kësaj periudhe, gazetaria amerikane Edith Anderson shkruan: "E nxjerrin në publik, e hedhin gjithandej, e shpien të vizitohet uzina dhe shkolla që mbajnë emrin e saj, e shkulin nga zyra për të organizuar konferenca në Gjermani dhe jashtë saj. Ajo nuk guxon të refuzojë".

Por Seghers, Brecht, Bloch, Kuczynski apo edhe Arnold Zweig i sapo kthyer nga Palestina, nuk janë vetëm garancia intelektuale e Republikës Demokratike Gjermane. Ata, gjithashtu, janë mentorët e një rinie të shkatërruar nga zbulimi i monstruoze të regjimit në të cilin ajo u rrit, e një rinie në kërkim të personaliteteve si referencë.

"Ky angazhim për Republikën Demokratike Gjermane, shkruante dramaturgu Heiner Müller, lidhej me Brecht-in; Brechtin legjitimonte faktin e ekzistencës për republikën demokratike gjermane: Prova e superioritetit të sistemit, ishte fakti se kishte një letërsi më të mirë: Brecht, Seghers, Choloikov, Maiakoski". Për Christa Ëolf, është pikërisht Anna Seghers që luan rolin e autoritetit moral.

Gjatë viteve të fundit të ekzistencës së regjimit, aureola e Anna Seghers-it do të venitej nga dëshmitarë Ealter Janka-s, viktimit e proces-spektaklit të fundit të organizuar nga regjimi gjermano-lindor. Në vitin 1956, të inkurajuar nga zbulimi i krimeve të Stalinit gjatë kongresit të XX-të të Partisë komuniste sovjetike, një grup marksistësh kritikë mbledhën në shtëpisë botuese Aufbau. Anna Seghers është e pranishme, ashtu si dhe ministri i kulturës, poeti Johannes R. Becher. Ndjekin nga afër turbullirat në Budapest dhe dyshojnë më të keqen për filozofin Lukacs, autor i shtëpisë botuese, që u vu në shërbim të protestuesve. Lukács në fakt, pranoi të bëhej ministër i kulturës në qeverinë e Imre Nagy-t. Seghers dhe Becher projektuan që të dërgonin në Budapest botuesin e tij, Janka, për ta sjellë më pas në Berlinin lindor. Në çastin e fundit, Ealter Ulbricht, sekretari i përgjithshëm i Partisë, doli kundër.

Janka u arrestua për konspiracion dhe u dënua me dhjetë vjet në një proces gjyqësor ku Seghers dhe Becher të thirrur si dëshmitarë, heshtën. Kur botoi librin me *Kujtimet* e tij, në të cilin denoncon mungesën e mbështjetjes nga ata, në vitin 1989, Seghers dhe Becher nuk ishin më gjallë. Letra të nxjerra nga arkivat do dëshmonin ndërhyrjet e Seghers në favor të Jankas pranë Ulbricht-it. Natyrisht, asgjë nuk filtroi në këtë drejtim, por Janka u lirua para mbarimit të dënimit. Nga ana e tij Becher u kishte nisur dhurata fëmijëve të Jankas, i cili u arrestua natën e Krishtlindjeve. Ai

u deh për vdekje natën e vigjiljes së procesit, më pas u sëmur dhe u shua një vit më vonë. Heshtja ka çmimin e saj.

Në gjirin e Lidhjes së shkrimtarëve, Anna Seghers shënon faktet me të cilat ajo nuk është dakort duke shumëfishuar shenjat "infrapolitike". (James C.Scott). Vërehet se ajo ikën, shpesh, nga seancat me një buzëqeshje në cepat e buzëve që nuk gënjen dot asnjë. Vetëm një fjalë e saj mund të ndryshojë atmosferën, por ndodh rrallë që ajo të ndërhyjë prerë. Heiner Müller kujton se pasi që kritikuar nga aparatçikët shërbëtorë, Seghers vetëm sa u ngrit, "u afrova te Inge (gruaja e tij) dhe te unë, na shtërngoi dorën të dyve dhe iku". Në maj të vitit 1963, gjatë konferencës mbi Kafkën në Liblice, ajo largohet qëllimisht haptazi nga bashkëpatriotët e saj dogmatikë që kishin ardhur për të kundërshtuar tentativën e shkrimtarëve çekë për të rifutur Kafkën në pasurinë letrare. Në shkurt të vitit 1966, pas plenumit të famshëm të 11-të të Partisë, ku letërsia gjermano-lindore u cilësua si "pornografi", nga ai që do të merrte frerët e vendit disa vite më vonë, Erich Honecker, Seghers u jep zemër shkrimtarëve të mbledhin veten, duke punuar. "Të punosh" është një term që Seghers e përdor shpesh dhe ajo vetë vihet në punë. Shkrimi është terapia e saj.

"LËRINI TË RIMARRË ÇMIMIN E SAJ"

Edhe pse në publik kishte marrë vetëm nderime dhe lëvdata, ajo vëzhgohej rrëptësisht nga Stasi (Ministria e Sigurisë së Shtetit). Të gjitha qëndrimet e saj regjistroheshin, edhe sikur të ishin fare pak larg nga fjalimet zyrtare. Më 2 tetor 1963 një informator raporton se ajo ka refuzuar të punojë mbi skenarin e frymëzuar të romanit të saj *Kryqi i shtatë*. Ai nënvizon se ajo e bënte me qëllim duke e quajtur skenaristin "Kaltenbrunner" (emri i një nazisti të rangut të lartëni ekzekutuar menjëherë pas procesit të Nuremberg-ut, ndërkohë që emri i tij i vërtetë është Kalfoten). Që me hapjen e dosjes së saj, u kujdesëm që të shënojmë se pas kthimit të saj nga arratia, Seghers ka përhapur disa "rezerva kundrejt udhëheqjes gjermane të Partisë, dhe arsyeja buron ngaqë është çifute dhe ka një lloj përcëimi ndaj gjermanëve". Mënjatë apo dhe në mbledhje, ajo tregohet shumë kritike në disa pika. E shohim duke bërë titur në ambasadën sovjetike: "çfarë po bëni me Solzhenicinin? Lëreni të marrë çmimin e tij!" (na kujtohet që autori i *Arkipelagu i Gulagut* nuk ishte autorizuar të shkonte në Stokholm për të marrë çmimin Nobel në vitin 1970). Më vonë, vërejmë se ajo denoncon mënyrën se si janë sjellë me këngëtarin e rebel Ëolf Bierman, i cili humbi qytetarinë në vitin 1976. Megjithatë, ajo nuk iu bashkua firmëtarëve që protestuan kundër këtij vendimi.

I kanë mbetur besnikë imazhit të Anna Seghers-it pjesa më e madhe e «të kthyerve» të lidhur nga një e shkuar e përbashkët, nga zgjedhja e tyre për Republikën Demokratike Gjermane dhe mohimi i Gjermanisë tjetër. Për të shpëtuar vizionin e tyre për botën në të ardhmen, ata pranuan mbikqyrjen policore si një të keqë të domosdoshme (pa dyshuar për përhapjen e saj), iu nënshtroan drejtuesve dogmatikë dhe menaxherëve të Partisë të pashpirt duke i thënë vetes se ishin kalimtarë, ndërsa Partia do të qëndronte gitimone, ashtu si dhe misioni i saj historik. Mjafton që të prisnin ditë më të mira. Ata formuan brezin e ardhshëm me një shpirt kritik, atë të Christa Ëolf, Volker Braun dhe Heiner Müller, por edhe i rrenjosën rregullin e heshtjes. Gjatë ngjarjeve të nëntorit të vitit 1989, "të kthyerit", që ishin akoma gjallë dhe trashëgimtarë e tyre – këta marksistë kritikë ende anëtarë partie apo afër saj, simpatizantë – nuk folën në publik veçse në çastin e fundit, gjatë manifestimeve të 4 nëntorit në Alexanderplatz, në Berlin, ose më mirë të themi pesë ditë para rënies së murit. Ata kishin humbur çdo ndikim në shoqëri dhe nuk mundën të ndërtonin dot një forcë politike të aftë të negocionte diçka tjetër përveç aneksimit pa kushte të Republikës Demokratike Gjermane.

* Historiane, autore e librave *Përlësia me çdo çmim. Të mashruarit e "socializmit real", Bregu i ujit*, Lormont, 2019.

NË KANADA, SHPALOSJA E VIRTYTIT SI POLITIKË E JASHTME

Justin Trudeau, një skifter veshur me kostum indian

Për mediat kryesore, karakteri i dyfishtë i kryeministrit kanadez, Justin Trudeau u shfaq kur u zbuluan fotografite që e tregojnë atë të ngjyrosur në fytyrë me bojë të zezë. Udhëheqësi liberal, a nuk e kishte prezantuar veten si mbrojtës të diversitetit? Është një fushë tjetër, shumë më pak e komentuar, në të cilën hendeku midis fjalimeve dhe veprimeve të tij është i dukshëm: politika e jashtme.

NGA RICHARD NIMIJEAN DHE DAVID CARMENT *

Për kanadezët e mësuar me kostumet e ngrysur të konservatorit Stephen Harper, fitorja e Z. Justin Trudeau, një djalë i ri “cool”, buzagas, gjatë zgjedhjeve federale në qershor të vitit 2015, solli një ndarje. Ndërkohë që kryeministri i mëparshëm refuzonte të ngrinte “çështjet e grave”, si pabarazia në nivel pagash dhe dhuna seksuale, Z. Trudeau premtoi se do t’i rriste djemtë e tij si feministë të ardhshëm të bindur.

Si kundërrymë ndaj cinizmit të konservatorëve kanadezë, i sapoardhuri reklamonte fatin e “së nesërme që vjen duke kënduar”, të një politike “pozitive”. Nën drejtimin e tij, vendi duhej të dilte nga hija e Shteteve të Bashkuara dhe të kthehej në skenën politike ndërkombëtare, siç kishte deklaruar ai mbremjen e fitores së tij.

Ky fjalim joshi jo vetëm kanadezët, por edhe shtypin e gjithë botës, që e prezantuan Z. Trudeau si kundërshtarin e duhur të Z. Donald Trump, si ilaçin kundër nacionalizmit dhe populizmit që po rriten në Europë, po ashtu dhe në Shtetet e Bashkuara. Z. Trudeau, fillimisht, u duk sikur u dha të drejtë. Me të ardhur në pushtet, ai shkoi në Londër, ku pranoi se diversiteti përbënte një “forcë” për Kanadanë. Më pas ai e shmangu këtë temë përpara anëtarëve të Forumit ekonomik botëror në Davos, në janar të vitit 2016, duke deklaruar se diversiteti ishte diçka e mirë për biznesin, para se të shtonte: “të paguash gratë sa burrat, kjo është gjë e mirë”. Gjatë Konferencës së Parisit për ndryshimet klimatike (20 nëntor



Justin Trudeau

-12 dhjetor 2015), ai paraqiti mendimin e tij në lidhje me ekologjinë, duke thyer me dhjetëra pengesa të paraardhësit të tij në lidhje me këtë temë. Kanadaja “është aty për të ofruar ndihmën e saj”, tha ai para të pranishmëve në sallë. Së fundi, Z. Trudeau tregoi qëndrimin e tij të ndryshëm në lidhje me çështjen e emigracionit. Ndërkohë që evropianët po hahen mes tyre për shpërndarjen e emigrantëve sirianë, Trudeau, në dhjetor 2015, shkoi në aeroportin e Torontos për të pritur azilkërkuessit. “Këtu jeni në shtëpinë tuaj”, i siguroi ai.

Katër vjet më vonë, ylli i kryeministrit u zbeh. Bilanci i tij, shumë larg nga premtimet e fushatës, nxiti një skepticizëm të fortë në gjirin e popullatës. Komentues të shumtë, që më parë qenë entuzistë, tani e tutje, nëvizojnë një vazhdimësi me Z. Harper, veçanërisht në fushën e politikës së jashtme.

Një “rikthim tek skifterët liberalë”

Pikërisht në këtë fushë, Z. Trudeau, para së gjithash, shfaqet si një besnik “i shpalosjes së virtutit”, një teknikë komunikimi që ndërhyrës gjerësisht në media, sidomos në rrjetet sociale, në disa tematika ngjarjesh që kanë një përhapje të gjerë, për të mbrojtur vlera pozitive, pa kryer veprime që ndjekin gjithnjë fjalët. Në të njëjtën radhë idesh, gjatë udhëtimit të tij shkatërrues në Indi, në shkurt të vitit 2018, kryeministri i ri e kishte vlerësuar të drejtë që të vishte një sari tradicionale, që mbahej nga një pjesë e komunitetit indian në Kanada. Tallës, komentuesit e interpretuan menjëherë këtë zgjedhje në veshje si një mesazh në vëmendje të bazës së tij elektorale, besnike e diversitetit kulturor.

Mikpritësit indianë e vlerësuan më pak, dhe ky udhëtim i rëndoi akoma më shumë marrëdhëniet tashmë të tensionuara me Indinë.

Përsa i përket feminizmit, shefi i qeverisë mburret se zhvillon një politikë ndihmash ndërkombëtare, të bazuara në fuqizimin e femrave nëpërmjet edukimit, dhënien e mikrokredive dhe ndihmën për ngritjen e ndërmarrjeve. Megjithatë, jo vetëm që Kanadaja ka investuar pak në këtë fushë, por, Z. Trudeau vlerësoi se objektivat e ndihmës për zhvillimet e caktuara që para pesëdhjetë vitesh nga Kombet e Bashkuara (0,7 të prodhimit vjetor të brendshëm bruto) ishin “shumë ambicioze”. Sipas fakteve, gjysma e shumave që ai zhbllkoi do të ndihmojnë fondet private të ngarkuara për ngritjen e kapitaleve në tregje. “Fjalët boshe të Kanadasë mbi zhvillimin ndërkombëtar (...), nuk shoqërohen me një angazhim të vërtetë financiar

të përcaktuar”, me këtë dolën në përfundim studiuesit Mattheë Gouett dhe Bridget Steele.

E njëjta situatë edhe në planin e të drejtave të njeriut. “Ne do t’i mbrojmë gjithmonë të drejtat e njerëzve, do t’i mbrojmë gjithmonë të drejtat e grave, dhe kjo nuk do të ndryshojë kurrë”, do të deklaronte ministrja kanadeze e punëve të jashtme, Znj. Chrystia Freeland, gjatë një bisede me gazetaret më 6 gusht 2018, një ditë pas një konflikti me Arabinë Saudite në lidhje me fatin e militantëve të të drejtave të njeriut në atë vend. Vetë ministrja e kishte pritur personalisht të renë saudite Rahaf Mohammed al-Qunun, që ishte arratisur nga monarkia, duke përforcuar llakun humanitar dhe feminist të qeverisë. Nuk mund të lëmë pa përmendur se disa muaj më parë, Kanadaja nuk kishte pranuar të anulonte një kontratë prej 15 miliardë dollarësh kanadezë (10,2 miliardë euro) të firmosur me Arabinë Saudite për dorëzimin e pajisjeve ushtarake – pajisje të përdorura në kuadër të luftës me Jemenin, që, nga ana tjetër, është vend përfitues i ndihmave humanitare kanadeze. “Kjo është një lloj sikur të ndihmohet dikë që të blejë paterica pasi e ke ndihmuar më parë për t’i thyer këmbët”, ironizon Z. Cesar Jaramillo, përgjegjës i Projektit Ploughshares, një organizatë ekumenike kanadeze e cila punon për paqen. “Në një demokraci”, secili duhet “të respektojë kontratat e firmosura nga qeveritë e mëparshme”, shpjegoi kryeministri për justifikim gjatë një konference në universitetin e Rexhinës, më 11 janar 2019.

Pavarësisht premtimeve të tij, Z. Trudeau ka vazhduar prirjen e paraardhësit të tij: radhitjen në politikën e jashtme të Uashingtonit. Gjatë samitit të G20-s, organizuar në Hamburg në korrik të vitit 2017, ai e zuri ngushtë kancelaren gjermane duke i kërkuar që deklarata mbi mjedisin të evitohet përmendjen e marrëveshjes së Parisit mbi klimën. Kjo manovër u interpretua si një tentativë për të joshur Z. Trump, në vigjilje të rinegociimit të Marrëveshjes për këmbimin e lirë amerikano-verior (ALENA). Por kjo nuk qe e mjaftueshme. Nëse teksti i ri (Marrëveshja Shtetet e Bashkuara – Meksikë – Kanada AEU/MC), nënshkruar në nëntor të vitit 2018, përmban disa hapa të vakëta progresiste – për shembull mbi lëvizjen e punëtorëve apo tregëtinë e ilaçeve, mbi të gjitha, ai i bën lëshime të rëndësishme Uashingtonit. Një nga klauzolat, për shembull, u jep Shteteve të Bashkuara të drejtën e vetos pa precedent në lidhje me negociatat e ardhshme tregtare midis Kanadasë dhe Kinës. Pa llogaritur këtu se Uashingtoni rezervon mundësinë që të aplikojë të drejtat e rëndësishme doganore mbi aluminin dhe çelikun në emër të sigurisë kombëtare.

Ndërkohë që shpresonte të dinamizonte tregëtinë me Pekinin për të lehtësuar varësinë e saj nga Uashingtonit, Otaëa u dha fund projekteve të saja, në vend që të përballonte aleatin e vet.

Kështu, në dhjetor të vitit 2018, qeveria kanadeze ndaloi drejtoreshën e financave të shoqërisë Huaëei në aeroportin e Vankuverit, me kërkesë të homologut të saj amerikan, që e akuzonte se kishte thyer sanksionet e vendosura nga Shtëpia e Bardhë ndaj Iranit. Një nga zërat e rallë

kanadezë, kundërshtar i kësaj dosje, Z. John McCallum, ish - ambasadori i Kanadasë në Kinë, iu desh të japë dorëheqjen, ngaqë sugjeroi gjatë një takimi me mediat kanadeze dhe ato kino-kanadeze, se Shtetet e Bashkuara përdornin juridiksionin jashtëterritorial si një armë. Nëse Otaëa përmend respektimin e një marrëveshjeje ekstradimi, nënshkruar me Uashingtonin, masat ndërshkuese kundër Huaëei-it mbeten, megjithatë, të njëjanshme, të marra jashtë çdo rezolute të Këshillit të Sigurisë në Kombet e Bashkuara dhe pa një marrëveshje formale midis Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre.

Kina u kundërpërgjigj me burgosjen e dy kanadezëve, duke shkakuar një krizë të rëndë diplomatike, dhe me rikoshetë, mënyrë indirekte, shkatërrimin e strategjisë kineze të Z. Trudeau. Sipas të përjavshmes “The Economist”, me analistët më tolerantë në lidhje me kryeministrin kanadez, Otaëa mjaftohet me përshtatjen e parimeve të vjetra të internacionalizmit liberal në realitetin e administratës së Trump-it.

Me shumë më pak mundësi vepërimit, kriza aktuale e sistemit ndërkombëtar dëmton ekonominë e mesme si ajo e Kanadasë. Dy superfuqitë, njëra e stabilizuar mirë (Shtetet e Bashkuara) dhe tjetra në industrializim e sipër (Kina), japin tonin, janë referenca, ndërsa vendet në rënie si Rusia dhe BE-ja, vuajnë që t’u dëgjohet zëri. Në këtë kontekst, organizatat shumëpalëshe që Otaëa ka vendosur në zemër të strategjisë së saj kanë prekur limitin. Organizata botërore e tregtisë (OBT) nuk funksionon mirë, G7 është e përçarë, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) po humbet unitetin e saj. Në këtë mënyrë po bëhet gjithmonë e më e vështirë të përballon sfida si terrorizmi, sulmet

ndaj sigurisë së sistemeve të informacionit, kibernetike, etno-nacionalizmi dhe pabarazitë socio-ekonomike.

Megjithatë, disa komentues tregohen më pak tolerantë. Sipas tyre, zgjedhjet e ekipit të Z. Trudeau sugjerojnë se, në vend që të pësojnë ndikimin e autoritetit të fuqishëm fqinj, ekipit i vlen me mire të përcaktojë vizionin e tij. Kurse gazetari që shkruan kryeartikullin e *Toronto Star*, Thomas Éal-kom, përmend “një kthim të skifterëve liberalë”, ish-diplomati Daryl Copeland, nënvizon me shqetësim: “Ministrja e punëve të jashtme Freeland (...), duket e mahitur dhe shpesh herë e verbër nga hard poëer-i.”

E zgjedhur nga *Think tanks-at amerikane*, mjaft armiqësore me Pekinin dhe Moskën, ministrja u kurorëzua si diplomatja e vitit nga *Foreign Policy Group*. Sipas këshillave të saj, qeveria Trudeau vendosi Venezuelën, Sirinë, Rusinë, Iranin dhe Korenë e Veriut në fillim të listës së saj të prioritetëve, duke imituar – dhe mbështetur – iniciativat e administratës Trump: samite, sanksione, presione politike dhe manovra ushtarake.

Znj. Freeland e përshkroi samitin e Grupit të Limas për Venezuelën, mbajtur më parë në Otava në shkurt të vitit 2019, si një shembull i mirë diplomacie dhe negociimi për kontinentin amerikan, ndërkohë që kjo organizatë karakterizohet nga një armiqësi ndaj regjimit venezueljan dhe një vendosmëri për të përmbysur presidentin Nicolas Maduro. Znj. Freeland nuk e gjykoj të nevojshme të fronte në këtë mbledhje Rusinë dhe Kinën, furnizuesit kryesorë të ndihmave në Karakas. Moska dhe Pekini nuk kanë marrë pjesë as në samitin për Korenë e Veriut që organizoi Kanadaja në vitin 2017, edhe pse të dyja vendet kanë kufi të përbashkët me Pyongyang.

Të ndryshosh vëmendjen e zgjedhësve

Qeveria e Z. Trudeau duket sikur është e mendimit se krizat që kërcënojnë planetin mund të zgjidhen pa Rusinë dhe Kinën. Megjithatë, a nuk do të kishte përfitimë Otaëa nëse do të futej në diskutime më të parën nëse do vërtetë t’i dëgjohet zëri për temën e Arktikut? Dhe objektivat e saj ekonomike – në veçanti aspirata për t’u çliruar nga një fqinj i bezdisshëm – a nuk përfrohen me ato të së dytës? Sa keq: dialogu nuk është në rendin e ditës. Kanadaja është treguar gjithmonë e mbyllur përballë Moskës përsa i përket krizës në Ukrainë. Përsa i përket marrëdhënive të saj me Pekinin, ato ngelen të minuara për shkak të burgosjes së dy qytetarëve të saj, ndërsa konflikti u thellua akoma më shumë nga Z. Trump dhe nga ish - ambasadori kinez në Otava, Z. Lu Shaye, që në janar të vitit 2019 do të denonconte “egoizmin perëndimor” dhe “racizmin” e bashkëbiseduesve të tij. Kësaj i shtohet dhe fillimi i një skandali politik që e zvogëloi të ashtuquajturin superioritet moral të Kanadasë përballë Kinës dhe reputacionin e saj si Shtet i së drejtës, sepse zyra e kryeministrit dyshohet se kishte kërkuar të ndërhynte në një procedurë gjyqësore për të ndihmuar gjigandin e Ndërtimeve

dhe Punëve Publike kanadeze SNC –Lavalin, akuzuar për korrupsion.

Kur u afruan zgjedhjet, qeveria Trudeau i dyfishoi përpjekjet për të shpalosur virtutet e saj dhe për të shmangur vëmendjen nga bilanci i saj diplomatik. Ndërsa liberalë dhe konservatorë janë shumë afër njëri-tjetrit në pretendimet e tyre për votë, shkrija e *New Democratic Party* (qendra e majtë), ofron matematikisht një avantazh për të parët në sistemin elektorale kanadez ku është shumë e lehtë të përcaktohet fituesi nisur nga votat. Të sigurtë në avantazhet e tyre në sondazhe, të Gjëlberit ishin për zgjedhje të lira. Zgjedhësit e qendrës së majtë dhe të rinjtë, që kishin mbështetur Z. Trudeau para katër vjetësh, do të ndëshkojnë liberalët për premtimet e tyre të pamajtura, sidomos në planin mjedisor? Apo do të shkojnë të votojnë për ta me gjysmëzëmre me të vetmin qëllim pengimin e konservatorëve? Vendimi i Partisë Liberale për të mos marrë pjesë në debatin televiziv mbi politikën e jashtme - i njëjti që kishte ndihmuar shumë në fitoren e vitit 2015 – tregon qartazi se ai i trembet përballjes me kontradiktat dhe humbjet e tij. Pasi përtej fjalimeve të bukura, Kanadaja nuk ka gjetur ende vendin e saj në skenën ndërkombëtare.

* Respektivisht profesor në Shkollën e studimeve autoktone dhe kanadeze dhe në *Norman Paterson School of International Affairs*, universiteti *Carleton*, Otaëa (Kanada). Që të dy kanë drejtuar së bashku *Canada, Nation Branding and Domestic Politics*, Routledge, Abigdon (Mbretëria e Bashkuar), 2019.

“Muxhahidinët e Popullit”, muslimanët

Aty ku jetojnë prej 4 vitesh opozitarët e regjimit të Iranit që i shpëtuan atentatit me bombë në 2018-ën, nga ku u dëbua ambasadori i Teheranit në Tiranë

NGA YLLI PATA

Gati 26 shekuj nga beteja famëmadhe e Salaminës, ku komandanti i spartanëve helenë, Leonidha luftoi e fitoi mbi perandorinë gjigande Perse, në Ballkan po zhvillohet një tjetër betejë epike me subjekt persët modernë, përkatësisht Iranin.

Natyrisht jo me heshta dhe ushtarë muskulozë, por me kompjutera dhe propagandë. Tre mijë burra e gra janë aktorët e kësaj lufte politike të cilën e kryejnë nga një distancë prej mbi 3100 kilometrash, me synimin për të larguar regjimin e mullahëve dhe për të sjellë një sistem laik dhe demokratik në vendin e madh dhe shumë të rëndësishëm të Lindjes së Mesme.

Muxhahidinët sot kanë një aleat shumë të fuqishëm dhe që as më pak e as më shumë është Shtëpa e Bardhë, e cili i konsideron ata si një instrument për të mposhtur regjimin e Teheranit, ndaj të cilit ka vënë sanksione të fuqishme ekonomike dhe kohët e fundit është folur gjithnjë e më shumë edhe për ndërhyrje ushtarake.

QYTETI I VOGËL I IRANIANËVE NË ZEMËR TË SHQIPËRISË

Në qytezën e vogël të Manzës, një ish-vendbanim minatorësh të qymyrit, në një sipërfaqe rreth 1 kilometër katrorë tokë të rrethuar me mur, është ndërtuar një qytet më vetë, me ndërtesa moderne dhe infrastrukturë e vepra arti.

Një hark triumfi, natyrisht miniaturë e veprës pariziane, hap siparin e “Ashraf 3”, qytezës ku jetojnë rreth 3 mijë iranianë, anëtarë të *Organizatës e Popullit Muxhahidin* të Iranit, apo grupi politik kryesor i opozitës së regjimit të Ajatollahëve. Shariar, një inxhinier bërthamor rreth të 50-ave, që thotë se ka studiuar në Universitetin e North Texasit, është nga qyteti i Esfahanit në Iran, prej ku është larguar që para 30 vjetësh. Gjysmën e familjes e ka në atdhe e gjysmën në SHBA dhe Europë. Duket se është pjesëtar i rëndësishëm i muxhahidinëve. Ai merret kryesisht me publicistikë dhe ndjekjen e mediave që shkruajnë për çështjen e Iranit.

Pranë kalon një grua rreth të 60-ave e veshur me rrobë uniforme që mbajnë femrat e organizatës që flet persisht me Shariar dhe shkron drejt një grupi grash që po merren me përgatitjen e drekës.

Bashkëbiseduesi ynë thotë se zonja është Zohreh Akhyani, kryebashkiakja e qytetit të iranianëve në zemër të Shqipërisë. Kur e pyesim nëse mund ta intervistojmë shmanget me elegancë, duke kërkuar falje për pamundësinë për t'u intervistuar.

Në të djathtë duket një kënd i madh lojrash ku një grup burrash të veshur me tuta sportive bëjnë stërvitje, të cilët, me mirësjellje, përshëndesin në gjuhën shqipe: “Mirëdita!”.

Kampi apo qyteza e muxhahidinëve iranianë në Shqipëri është imponente; një sipërfaqe e madhe toke, ku janë ndërtuar godina banimi, zyra të panumërta pune, një furrë buke e kuzhinë e madhe që gatuan vazhdimisht për 3 mijë banorët që bëjnë një jetë kolektive dhe të koordinuar me një precizion perfekt.

Banorët e qytezës jetojnë në fjetore të ndara veç për burrat e veç për gratë. Përveç fjetjes, e gjithë pjesa tjetër e punës dhe jetesës është e përbashkët.

Të ardhur në Shqipëri nga viti 2013 deri në 2014-n, opozitarët e regjimit iranian i përkasin grupeve etnike të ndryshme që ka Irani: shumica janë persë, por ka edhe azerë, lur, baloch, apo turkmenë.

Mustafai, një tjetër muxhahidin në moshë të mesme, flet me detaje për këtë qytezë të tyre në Manzë të Durrësit, pranë fshatit Bilalas, që është ndërtuar në kohë record - në 18 muaj. Toka i është blerë fshatarëve të zonës pjesë-pjesë dhe më pas është ndërtuar kompleksi gjigand. Në të ka



Hyrja qendrore e Kampit të Manzës



Një muxhahidin duke analizuar lajmet nga Irani



Bukëpjekësi

TRE MIJË MUXHAHIDINËT E SHQIPËRISË JANË PJESA BAZIKE E OPOZITËS IRANIANE, POR UDHËHEQJA E LARTË NDODHET ENDE NË PARIS, KU KA SELINË FRONTI I REZISTENCËS SË IRANIT. NJË NGA PËRFAQËSUESIT E LARTË TË OPMI-SË, DEKLARON PËR LE MONDE DIPLOMATIQUE, SE NDËRSA UDHËHEQJA NË PARIS MERRT ME LOBIMIN NDËRKOMBËTAR DHE PËRGATITJEN E TRANZICIONIT POSTREGJIM, POPULLI OPOZITAR I MANZËS MBAN LIDHJE DIREKTE ME TË GJITHA PIKAT APO DEGËT TASHMË TË NGRITURA NË ÇDO CEP TË IRANIT, PËR TË PËRGATITUR KUSHTET E NJË “KRYENGRITJEJE FINALE”

ndërtesa moderne, vepra zbkuruese, salla gjigande e eventeve dhe ajo që muxhahidinët e cilësojnë si “të shenjtë”: Muzeu i Përkujtimit të viktimeve të regjimit Iranian, që është një ekspozitë mbresëlënëse dhe eminente me foto, grafika, dhe artefakte të ndryshme. “Kemi sjellë historinë 150 vjeçare të popullit tonë dhe natyrisht në veçanti historinë e persekutimit dhe shtypjes së organizatës sonë nga ana e regjimit të mullahëve”, thotë Mustafai.

Ashraf 3, është emërtuar si vijim i dy komplekseve të mëparshme në

Irak nga fillimi i viteve 90 deri në vitin 2013. Por pas largimit të Sadam Huseinit dhe ardhjes në fuqi të qeverisë shiite pro-iraniane në Bagdad, Ashraf dhe Camp Liberty u bombarduan dy herë nga trupat iranianë ku gjetën vdekjen 51 anëtarë të rezistencës, përfshi edhe ish-lideri i PMOI.

Muxhahidinët prej dy vjetësh janë bërë banorë të Manzës dhe shpesh ftojnë fshatarë të zonës në kompleks, sidomos gjatë muajit të Ramazanit për iftar, apo edhe për festa të ndryshme ku drekojnë apo darkojnë së bashku. Kur kanë punë të ndryshme si

TË 3000 "PERSËVE" TË SHBA-SË

që udhëhiqen nga gratë



Ndërtimi i kësaj qyteze duket sheshit se ka kushtuar miliona euro, por shifrën e saktë nuk ta tregojnë askush. Shahini, një nga përfaqësuesit mediatikë të organizatës thotë se paratë janë dhënë nga diaspora iraniane nëpër botë, ku edhe ai është një prej tyre. I shkolluar në Stanford-Californi, Shahini shiti shtëpinë e tij në Beverly Hills, të blerë nga babai tregtar tapetesh në Teheran, për të financuar organizatën

lulishtari apo edhe problem teknike të ndryshme ata u japin mëditje profesionistëve apo edhe kompanive përreth.

Ndërtimi i kësaj qyteze duket sheshit se ka kushtuar miliona euro, por shifrën e saktë nuk ta tregojnë askush. Shahini, një nga përfaqësuesit mediatikë të organizatës thotë se paratë janë dhënë nga diaspora iraniane nëpër botë, ku edhe ai është një prej tyre. I shkolluar në Stanford-Californi, Shahini shiti shtëpinë e tij në Beverly Hills, të blerë nga babai tregtar tapetesh në Teheran, për të financuar organizatën.

ATENTATI I DËSHUAR ME BOMBË NË TIRANË

Të ardhur në fillim si çështje humanitare në Shqipëri, pra thjesht u strehuan nga Tirana zyrtare pasi askush nuk i pranonte, muxhahidinët u kthyen në një përplasje politike që shkoi deri atje, sa Shqipëria të kërcënohej edhe nga atentatet terroriste. Tirana zyrtare i mëshoi në fillim shumë fort çështjes humanitare, sa vetë Ditmir Bushati, ish-ministër i Jashtëm vizitoi Teheranin në një tur zyrtar për të bindur krerët e regjimit se Shqipëria nuk i do lejojë muxhahidinët të bëjnë politikë.

Por në mesin e vitit të shkuar, pra në 2018-n, shërbimi sekret shqiptar zbuloi një makinë bombë që ishte bërë gati të shpërthente në ish-vendqendrimin e vjetër të muxhahidinëve në Kashar. Si i dyshuar për çështjen u konsiderua një person që kishte ardhur në Shqipëri si reporter, e në fund nuk doli i tillë. Vetëm pak orë pasi shkreta e shërbimit sekret mbërriti në zyrën e tij, pak përpara Krishtlindjeve të vitit të kaluar, Edi Rama firmosi dëbimin nga Tirana të Gholamhossein Mohammadnia, Ambasadorit Fuqplotë të Republikës Islamike të Iranit në Shqipëri. Së bashku me ambasadorin Rama dëboi edhe një diplomat që ishte atashë për kulturën me dyshimin se drejtonte një rrjet agjenturor kundër muxhahidinëve.

LIDHJA ME TRUMP

Opozitarët iranianë të PMOI kanë pasur marrëdhënie direkte me amerikanët që pas ndërhyrjes në Irak në 2003-shin, por ky relacion u bë më i afërt kur muxhahidinët i dërguan si "peshqesh" Barack Obama-s të dhënat sekrete që tregonin se regjimi i Teheranit po bëhet gati për armën bërthamore, Më pas u bënë "armi" me ish-presidentin amerikan, kur Obama firmosi marrëveshjen me Hassan Rouhani-n, presidentin Iranian dhe i anuloi sanksionet ekonomike me kushtin e heqjes dorë të teknologjisë nukleare.

Sot muxhahidinët kanë hyrë brenda në Shtëpinë e Bardhë. Rudy Guliani, avokati personal i presidentit amerikan, është njeriu më i afërt i opozitës iraniane dhe e viziton Manzën 2 herë në vit. John Bolton, që deri pak kohësh ishte në paradhomën e Zyrës Ovale, si kreu i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, është, gjithashtu, një mik i afërt i muxhahidinëve. Pra,

përveç afërsisë së vjetër me shërbimet inteligjente të SHBA-së, opozitarët iranianë janë politikisht të ngjizur me Donald Trump, i cili kërkon të shpejtojë hapat për të rrëzuar mullahët nga Teherani.

Pikërisht nga kjo marrëdhënie e afërt përfiton edhe politika shqiptare për të pasur një lidhje direkte me Uashingtonin. Edi Rama prej tyre përfitoi një vizitë në Shtëpinë e Bardhë në 2016-n dhe të rikuperonte situatën me Donald Trump, pasi e sulmoi publikisht në CNN duke mbështetur fushatën e Hillary Clinton. Presidenti amerikan i shkroi Ramës personalisht sapo ky i fundit dëboi ambasadorin iranian.

SHPRESA PËR RIKTHIM

Në sallat e seksionit informatik të Ashraf 3, mbi 100 persona punojnë 24 orë në 7 ditë duke mbajtur lidhje me njerëzit në Iran, duke marrë dhe shpërndarë informacione nga brenda për të ndikuar e provokuar një valë tjetër protestash, siç ndodhi në 2018-n dhe në fillim të këtij viti. Shahin thotë që ata këtë herë janë më me shpresë së kurrë për t'u kthyer së shpejti në shtëpinë e tyre: "Regjimi është i rrënuar. Dikur eksportonte 2,5 milionë ton naftë në ditë, e sot vetëm 160 mijë. Regjimi nuk financon më strukturat repressive dhe populli nuk do të durojë gjatë. Manza është streha jonë e fundit para rikthimit në atdhe..., përfundon Shahin".

MUXHAHIDINËT, LËVIZJA POLITIKE MË E VJETËR

Të themeluar në vitin 1965, Organizata e Popullit Muxhahidin të Iranit, ishte një lëvizje e majtë që u krijua nga lëvizjet studentore kundër Shahut dhe që kundërshtoi shtetin fetar të Ayatollah Khomeinit. Disidentë që prej vitit 1981, muxhahidinët jetojnë në mërgim. Së bashku me disa grupime të tjera politike kanë krijuar Këshillin e Rezistencës së Iranit, që drejtohet nga një grua, Maryam Rajavi, por edhe numri dy i organizatës është sërish një grua: Mahnaz Salimian. Muxhahidinët kërkojnë rikthimin e një shteti laik në Iran, demokraci parlamentare dhe ekonomi të lirë.

Opozita iraniane mendon se regjimi i mullahëve ka ardhur pranë fundit, por askush nuk jep kohën kur ata e kanë planifikuar një përsëritje të protestave siç ndodhi dy vjet më parë. Në atë kohë Presidenti Iranian Rouhani akuzoi direkt muxhahidinët, madje i kërkoi Presidentit të Francës Emanuel Macron që të largojë opozitën nga territor francez.

Megjithatë, antenat muxhahidinët e Manzës, më shumë se në Iran i mbajnë në Uashington. Atje kanë shpresën më të madhe të shtypjes së çelësit që do të nisë numrimin mbrapsht për të ndryshuar regjimin në Teheran. Dikur luftëtarë edhe me armë, sot muxhahidinët aksionin e kryejnë përpara kompjuterit, aty ku shpresojnë të nxisin një trazirë të re, ashtu siç e bënë në 2018-n, aksion ku e shpallën veten si inspirues e organizatorë....

PARADA E NDERIT



Imazhi i Shqipërisë dhe nevoja

Problemi i imazhit të Shqipërisë është veçanërisht i mprehtë në Bashkimin European, por ai nuk ndeshet vetëm në të. Shqipëria ka probleme me imazhin e saj edhe në hapësirën më të ngushtë gjeopolitike e kulturore të rajonit ballkanik. Se sa u përgjigjet imazhi që ekziston për vendin tonë realitetëve shqiptarë është një temë më vete, në shtjellimin e së cilës mund të sillen argumente që variojnë nga ksenofobizmi ekstrem dhe nacionalizmi folklorik te realizmi i moderuar.

NGA PROF. DR. FATOS TARIFA

Pavarësisht problemeve të vjetra apo të reja që presin zgjidhje, si edhe pikëpyetjeve të reja që janë krijuar, Shqipëria nuk meriton të ketë këtë imazh negativ që ka sot. Shumë zhvillime pozitive kanë ndodhur në Shqipëri, të cilat “bota” nuk i njeh

sa duhet. Arsyeja është se vetë ne, shqiptarët, nuk bëjmë sa duhet për t’ua dëshmuar të tjerëve historinë tonë, jo thjesht historinë e së kaluarës, por historinë e ditëpërditshme që transformon realitetin shqiptar. Kjo është, në fakt, detyra e diplomacisë publike.

Diplomacia publike dhe vendet e vogla

Diplomacia publike ka kohë që është bërë një koncept i njohur dhe mjaft i përdorur në teorinë dhe në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Fuqitë e mëdha kanë një audiencë shumë të gjerë në çdo skaj të globit, mundësi financiare, mjete dhe mënyra të shumta për të përhapur e kultivuar ato imazhe me të cilat kërkojnë të identifikohen në sytë dhe në mentalitetin e publikut të huaj. Rrjedhimisht,

diplomacia e tyre shtetërore fokusohet kryesisht në promovimin e politikave të tyre dhe, kur është nevoja, në një diplomaci publike që synon një lloj “re-branding”. Në këto dy dekadat e fundit është rritur preokupimi i vendeve të vogla (si Suedia, Norvegjia, Greqia, Letonia, Lituania, Armenia, Serbia e deri Tajvani) për të zhvilluar diplomacinë publike në dobi të interesave të tyre kombëtare.

Nevoja për një diplomaci publike efektive në Shqipëri

Sa kuptohet dhe sa bëhet kjo diplomaci publike në Shqipëri? Sa ndihmon në këtë mes Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, si institucioni i specializuar, apo diplomacia zyrtare, si instrumenti kryesor i politikës së jashtme të vendit tonë? Cilët organizma ose institucione shtetërore bëjnë ose sponsorizojnë diplomacinë publike? Në ç’formë dhe me ç’mjete e realizojnë këtë? Sa të angazhuar janë në sferën e “shërbimit” diplomatik sektorë të ndryshëm të shoqërisë civile? Po media? Cilit publik të huaj i referohet dhe bën “subjekt” informimi diplomacia e tyre publike?

Thelbi dhe roli i diplomacisë publike, për të cilën ka nevojë Shqipëria, konsistojnë në atë që të informojë dhe të influencojë opinionin e huaj publik, veçanërisht atë europian, mbi ato transformime të mëdha që janë kryer në vendin tonë në këto

“Branding” Albania’s Identity

Shqipëria, një vend i vogël dhe më i varfër se të gjithë shtetet e tjerë të Europës ka mundësi të kufizuara për të eksportuar në tregun e kontinentit tonë apo në tregun global “të mira private”, me çka kuptojmë sende të përdorimit privat, gjë që, në vetvete, nuk shërben për të motivuar diplomacinë publike. Në shtete ekonomisht të zhvilluar—siç

janë Shtetet e Bashkuara, vendet kryesore të Bashkimit European, Japonia, Kanadaja, Kina etj.—interesat tregtare kanë shërbyer dhe shërbejnë për të energjizuar dhe përmirësuar “diplomacinë publike” të këtyre vendeve. Talenti amerikan për të shitur anembanë globit muzikën e Madonës e të Majkëll Xheksnit, filmat e Holliudit, Pepsi-Kolën dhe Koka-Kolën,

këpucët atletike të Majkëll Xhordanit apo hamburgerat e MakDonaldit ka pasur dhe ka në vetvete përbushjen e një elementi-sado anësor-të diplomacisë publike, pasi ai ka popullarizuar vlera të caktuara të kulturës popullore amerikane dhe ka promovuar në shumë vende e rajone të botës një imazh pozitiv për Amerikën. Të mos harrojmë se një pjesë të madhe të klasës së mesme në Europë dhe në pjesë të tjera të globit, në të vërtetë, iu pëlqen, si një lloj sporti, të mblidhen për kafë në Starbucks, veshur me blue jeans dhe T-shirts, shpikje këto të kulturës pop të amerikanëve.

E njëjta gjë mund të thuhet ndonëse në kuadër të një hapësire gjeografike më të kufizuar-për kulinarinë italiane, për verërat, muzikën, kinematografinë dhe turizmin e këtij vendi; për industrinë gjermane, veçanërisht atë të prodhimit të automobilitave; për artin, filozofinë, modën dhe rivierën franceze; për eksportet kryesore të Hollandës (naftën e Shellit, Heinekenin, tulipanët dhe produktet e Filipsit); për Volvon e Suedisë etj.

Por le të shohim shtetet anëtarë më të rinj të Bashkimit European. Zgjerimi i biznesit kapitalist dhe i aktivitetit tregtar të shumë prej këtyre vendeve në tregun e BE-së, në atë të Shteteve të Bashkuara, në Rusi, në Ballkan dhe deri në tregun latino-amerikan (verërat hungareze dhe slovene, këpucët çeke, prodhimet bujqësore të Polonisë, bregdeti kroat e të tjera), kanë qenë dhe po bëhen gjithnjë e më shumë “të mira private” në përdorim të një mase gjithnjë e më të gjerë njerëzish në shumë vende të zhvilluar të botës, duke ndihmuar në promovimin e një imazhi pozitiv për vendet prodhues të tyre. Në rrjetet televizive më të mëdha-si CNN, ABC, BBC, Reuters apo Al Jazeera—dhe në revista të tilla popullore si: *Travel Magazine*, *Global Traveler*, *Lonely Planet Traveler*, *National Geographic Traveler*, *Travel & Leisure* etj., sheh të promovohen kultura dhe arti hungarez, bregdeti kroat, folklori dhe plazhet e Bullgarisë, çka është, në vetvete, një funksion dhe rezultat i diplomacisë publike që bëjnë institucionet politike, organizatat kulturore dhe grupet e biznesit në këta vende për të krijuar një imazh sa më pozitiv në komunitetin europian dhe atë ndërkombëtar.

Është e vërtetë se muzika, arti, turizmi apo verërat janë kryesisht të mira “private” (apo “kolektive”), të cilat evokojnë kryesisht eksperiencat individuale të njerëzve dhe, deri diku, edhe eksperiencat e grupeve të caktuar. Konsumatorët privatë tërhiqen lehtësisht pas tyre duke parë, dëgjuar, ndier apo shijuar dhe, në këtë mënyrë, reagojnë pozitivisht ose negativisht ndaj tyre dhe në një mënyrë të caktuar edhe ndaj vendit që i prodhon ato. *Imazhi i një vendi, në fund të fundit, s’është veçse rezultat i eksperiencave individuale dhe kolektive të përsëritura të qytetarëve të huaj për aspekte të veçantë të organizimit shoqëror, për kulturën dhe mënyrën e jetesës së tij.*

Kontrasti mes imazhit të Shqipërisë dhe imazhit të shumë prej vendeve të tjerë të rajonit tonë në këtë aspekt është i thellë. Bregdeti bullgar as që i afrohet bregdetit të Shqipërisë për nga bukuria e tij, por europianët



Ajo që duhet bërë më shumë europiane në Tiranë është politika, ndërkohë që edhe në Bratislavë, edhe në Sofie, politika e këtyre vendeve është europianizuar në një shkallë më të lartë. Ose, të paktën, ky është imazhi i këtyre vendeve në Bruksel dhe në publikun e gjerë europian

preferojnë më mirë plazhet e pastra bullgare në Detin e Zi, sesa bregdetin shqiptar të Adriatikut ose të Jonit. Verërat slovene ose ato maqedonase nuk kanë të krahasuar me shumë nga verërat që prodhohen në Leskovik, në Përmet, ose në Librazhd, por ato i gjen edhe në supermarketet e Amerikës. Po kështu, edhe rakia apo djathërat bullgare nuk janë më të mira sesa rakia apo djathërat që prodhohen në Shqipëri, por të parat kanë gjetur treg shitjeje edhe në Shtetet e Bashkuara, ndërsa djathin dhe rakinë e vendit të tyre shqiptarët që banojnë në Amerikë vazhdojnë t’i marrin me vete në çantat dhe në valixhet e tyre.

Është detyrë e qeverisë shqiptare që ta ndryshojë këtë situatë, e cila nuk është në asnjë mënyrë fatale. Por ç’kanë bërë deri më sot dhe ç’mendojnë të bëjnë këtë e tutje Ministria e Financave dhe e Ekonomisë apo Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për të promovuar interesat ekonomike të vendit tonë dhe për t’u gjetur tregje shitjeje produkteve shqiptare, pra për të bërë atë “diplomaci publike” që i takon kësaj sferë të aktivitetit shoqëror-diplomacinë ekonomike? E njëjta pyetje ka vend të bëhet për agjencitë private të investimeve apo Dhomën e Tregtisë. Sepse sa kohë që qytetari i thjeshtë francez, holandez, gjerman, austriak apo spanjoll nuk do të shohë asgjë shqiptare në tregun e vendit të tij, por do të gjejë produkte

për një diplomaci publike efektive

“Made in Slovenia”, “Made in Poland”, ose “Made in Romania”, për aq kohë Shqipëria nuk do të jetë pjesë e hartës mendore të qytetarëve evropianë, të cilët, pavarësisht nga vendimet politike që merren në Bruksel, janë ata që, në fund të fundit, do të votojnë për alternativën evropiane të vendit tonë.

Por le t'u kthehemi për një çast atyre çka mund t'i quajmë “të mira publike”. Të tilla janë sistemi demokratik, toleranca fetare, paqja sociale, rendi, shteti i së drejtës, pozita e guas në shoqëri, pjesëmarrja e saj në politikë, respektimi i të drejtave të minoriteteve etj. Ndërsa në rastin e të mirave “private”, cilësia e tyre ka të bëjë me shijet, kërkesat dhe eksperiencën individuale të njerëzve (fjala vjen një CD me këngë apo një shishe verë italiane mund të konsumohen nga një individ i veçantë, pa qenë nevoja që ato të konsumohen edhe nga të tjerë), të mirat “publike”, nga ana e tyre, përjetohej në funksion-dhe në varësi-të shkallës së cilësisë së tyre, si të mira nga të cilat përfitojnë të gjithë qytetarët ose pjesa më e madhe e tyre. Kështu, për shembull, vlerat demokratike, si të mira publike, nuk mund të konsumohen nga çdo individ i veçantë nëse ato nuk janë pranuar dhe nuk respektohen kolektivisht nga e gjithë shoqëria. Kjo është ajo kategori vlerash që, në fund të fundit, përcakton imazhin e një vendi jashtë kufijve të tij si një shtet i lirë dhe demokratik, imazh mbi bazën e të cilit Perëndimi, ose Europa, na pranon ose jo të bëhemi anëtarë në familjen e saj.

Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të saj ekonomik Shqipëria, nuk ka mundur të krijojë një imazh pozitiv si partner ekonomik i vendeve evropiane. Po kështu, për shkak të institucioneve të saj të dobëta shtetërore, krizave të përsëritura politike dhe mungesës së stabilitetit në vend, imazhi i saj si një vend demokratik në Europë ka qenë dhe vazhdon të jetë përgjithësisht negativ, madje më negativ edhe se imazhi i Maqedonisë, fqinji ynë, i cili është formuar si një shtet i pavarur më pak se tri dekada më parë dhe ka një strukturë etnike heterogjene, për shkak të së cilës ky vend ka njohur disa kriza ndërretnike serioze.

Imazhi i një vendi është si nami i njeriut. Imazhi negativ, ashtu si edhe nami i keq, janë vështirë të ndryshohen. Imazhi i një vendi nuk është thjesht një perceptim subjektiv individual, ose një stereotip që krijohet për shkak të zakonit. Ashtu si nami i mirë apo i keq i një individi krijohet mbi bazën e cilësive dhe të mënyrës së sjelljes së tij, kur këto perceptohen si eksperiencia vetjake nga individët të tjerë, edhe imazhi i një vendi krijohet mbi bazën e të mirave “private” dhe “publike” që prodhon ai vend dhe të sjelljes së tij ndaj qytetarëve të vet dhe ndaj publikut të huaj. Imazhin negativ për Shqipërinë, Europa dhe qytetarët e saj nuk e kanë krijuar a priori, ngaqë “nuk na duan”, ose ngaqë na konsiderojnë më pak të zhvilluar. Ky imazh është krijuar nga vetë ne shqiptarët, jo si popull, pasi të huajt gjithnjë kanë çmuar dhe çmojnë shumë nga cilësitë dhe virtytet e popullit tonë, por nga arkitektura politike që kemi ngritur, nga mënyra se si klasa politike ka drejtuar deri më sot jetën e

shoqërisë sonë, dhe nga mënyra se si e kemi ngushtuar sferën publike, në të cilën shoqëria civile do të duhej të funksiononte si një institucion demokratik.

Mendoni për një çast ç'të mira “publike” kemi krijuar ne shqiptarët-të paktën që pas Luftës së Dytë Botërore e këtej-të cilat kanë qenë kuti me të cilin Europa ka matur shkallën e progresit tonë shoqëror dhe prizmi përmes të cilit ajo ka krijuar imazhin e saj për vendin tonë:

Një shtet autoritarist komunist dhe një vetizolim thuajse i plotë nga zhvillimet kryesore të kontinentit tonë për gati gjysmë shekulli;

Një kaos të vërtetë ekonomik e social në fillim të viteve 1990 dhe imazhet shokuese të eksodit të dhjetëra mijëra njerëzve në atë periudhë, të cilët në Europë u quajtën “boat people” (njerëz të anijeve); Një shtet autoritarist, liri të kufizuar për shtypin dhe shkelje të të drejtave të njeriut në mes të viteve 1990; Krim të organizuar në shkallë të gjerë; Një krizë të thellë ekonomike, sociale e politike pas shembjes së skemave piramidale të tipit “Ponzi”, në vitin 1997, dhe një tjetër krizë politike, e shoqëruar me një përpjekje për grusht shteti, më 1998; Institucione të dobët shtetërore dhe kriza të përsëritura qeveritare, të shkaktuara nga lufta “brenda llojit” dhe nga një korrupsion endemik; Shkallë të lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë dhe në administratën shtetërore, një elitë politike tepër të fragmentuar dhe pjesërisht të inkriminuar, për të cilën e ardhmja evropiane e Shqipërisë duket se ka pasur dhe ka më pak rëndësi sesa mirëqenia personale apo e ardhmja politike e tyre si individë.

Një situatë politike tërësisht e amullt e kaotike gjatë tërë këtij viti, me një opozitë që “lufton” jashtë parlamentit, etj. Ky ka qenë brumi që kemi gatuar vetë ne shqiptarët dhe me këtë brumë Europa nuk ka pranuar deri më sot të na hapë dyert e saj, por na ka thënë: *Prisni pas dere; ende nuk jeni gati!*

Gjatë dekadave të fundit, Hungaria, Sllovakia, Estonia, Lituania, Sllovenia provuan jo thjesht se janë gjeografikisht më pranë Europës (edhe pse vendet balltike janë më larg qendrës gjeografike të kontinentit



tonë sesa Shqipëria), por se ata janë politikisht dhe ekonomikisht-dhe, mbi të gjitha, të socializuar më mirë se ne-për t'u bërë qytetarë të komunitetit evropian. Kjo ka ndodhur vitet e fundit, të paktën në perceptimin e Brukselit dhe të publikut të gjerë evropian, edhe me disa nga vendet e rajonit tonë, si Bullgaria, Rumania, Kroacia apo Mali i Zi, imazhi i të cilave është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me imazhin e vendit tonë. Kjo ka ndodhur jo se rumunët, bullgarët apo malazezët janë më të kulturuar, më të aftë, ose më evropianë sesa ne, shqiptarët, porse ata kanë treguar se e kanë marrë seriozisht demokracinë dhe projektin evropian për vendet e tyre dhe kanë ditur të bëjnë një diplomaci zyrtare dhe një diplomaci publike shumë më të mirë, më efektive e më produktive sesa vendi ynë.

Nevoja për një “niche diplomacy”

Akemi krijuar ne shqiptarët të mira “private” dhe “publike” në këta 20 e ca vitet e fundit, për të cilat diplomacia zyrtare shqiptare, përmes kanaleve të saj të informacionit, medias dhe një diplomacie publike më të mirë mund të kishin informuar dhe mund të informojnë më mirë strukturat burokratike të BE-së dhe publikun e gjerë evropian mbi cilësitë e çmuara të popullit tonë, mbi vlerat e kulturës, të artit dhe të letërsisë shqiptare dhe mbi konstituimin shpirtëror evropian të kombit tonë? Sigurisht që po. Por, nëse diplomacia zyrtare e shtetit shqiptar ka qenë deri më sot shumë prapa realiteteve të brendshme më pozitive të vendit tonë, diplomacia publike, e organizuar në sistem dhe e sponsorizuar nga shteti, ka qenë deri më sot një fëmijë jetim.

Kjo nuk do të thotë se shqiptarët nuk kanë ditur të bëjnë dhe nuk bëjnë diplomaci publike. *Veprat e Ismail Kadaresë, të përkthyer gjerësisht në Europë dhe në botë, kanë qenë dhe mbeten një arsenal i jashtëzakonshëm i mundësive intelektuale të popullit tonë për të fituar admirimin e Europës.* Kur shërbeja si ambasador në Hollandë, Ismail Kadarenë e kërkoni kudo, madje edhe në komisionin e politikës së jashtme të parlamentit të atij vendi, që të fliste për Shqipërinë-por të fliste edhe për Europën. Kadareja ka qenë dhe mbetet një simbol i karakterit evropian, properëndimor të vendit tonë dhe, si i tillë, një vlerë e çmuar për krijimin e një imazhi pozitiv dhe properëndimor të popullit tonë. Të tillë janë edhe artistët tanë më të shquar: Ermonela Jaho, Inva Mula e shumë të tjerë.

Po kështu, ajo që ka bërë Edi Rama për Tiranën në dy mandatet e tij të parë si kryebashkiak i kryeqytetit dhe ajo ç'po bën sot Erion Veliaj për kryeqytetin tonë janë një diplomaci publike shumë e mirë në dobi të Shqipërisë. Duke e transformuar Tiranën nga një fshat i madh në një qytet metropolitan modern, madje në kryeqytetin më dinamik të Ballkanit, Rama dhe Veliaj kanë bërë shumë për ta ndryshuar pozitivisht imazhin mbi vendin tonë në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara. Transformimi urban rrënjësor që është kryer në Tiranë gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit është një tregues optimist mbi mundësinë e transformimeve të thella ekonomike, sociale e kulturore në shkallë vendi, nëse në krye të punëve vihen njerëz të aftë dhe me vizion evropian.

Tirana e vitit 1992, ajo e vitit 1998, ose Tirana e vitit 2000 nuk kishin vend në Europë, por Tirana e vitit 2019 është një qytet evropian, më shumë evropian sesa Shkupi-dhe po aq evropian sa Bratislava apo Sofia. Ajo që duhet bërë më shumë evropiane në Tiranë është politika, ndërkohë që edhe në Bratislavë, edhe në Sofie, politika e këtyre vendeve është evropianizuar në një shkallë më të lartë. Ose, të paktën, ky është imazhi i këtyre vendeve në Bruksel dhe në publikun e gjerë evropian.

Qytetet tanë të lashtë-Shkodra, Durrësi, Apollonia, Butrinti, Bërati, Gjirokastra etj.-me vlerat e tyre historike, arkeologjike, urbanistike e kulturore dhe me një kujdes më të madh nga institucionet shtetërore, duke investuar seriozisht për to, do të mahnisnin çdo vizitor të huaj dhe do të shndërroheshin në resurse të mëdha financiare për zhvillimin ekonomik e kulturor të tyre dhe të mbarë vendit.

Vlerat e përmendura më sipër mund të përbënin pikërisht atë “niche diplomacy” që i duhet vendit tonë për ta dalluar atë nga shumë vende të tjerë dhe për të krijuar një imazh gjithnjë e më pozitiv për të.

Por, imazheve pozitive për Shqipërinë që përçojnë në publikun e gjerë evropian letërsia e Kadaresë dhe e shkrimtarëve të tjerë më të mirë të vendit, Tirana e transformuar dhe vlerat më të mira kulturore të vendit tonë u kundërqëndrojnë në një mënyrë gati anuluese imazhi negativ që krijojmë vetë ne, shqiptarët, duke mohuar çdo arritje pozitive, çdo vlerë të mirë dhe individët që qëndrojnë prapa tyre. Dhe imazhi që krijojnë dhe ruajnë të huajt për ne, jo vetëm në Europë, por edhe fqinjët tanë, është ai i një vendi që “s’bëhet” dhe i një populli që “s’e gjen dot me veten e vet”, imazh ky, të cilin, shpesh herë, e ushqejmë vetë ne dhe mediat tona, dhe jemi po ne ata që ua servirim të huajve në një mënyrë që na tregon të pa qytetëruar dhe qesharakë në sytë e tyre.

Këta imazhe negative na kanë mbajtur dhe do të na mbajnë edhe më tej jashtë Europës. Sado përpara të shkojë reformimi i shoqërisë shqiptare dhe sado t’u afrohet ajo kriterëve të pranimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria nuk do të mund ta bëjë dot hapin final për t’u bërë pjesë e tij, nëse imazhi që u transmetojmë ne Brukselit dhe Uashingtonit është ai një vendi, i cili ende nuk është “gati”, i cili ende nuk është i sigurt në rrugën e vet, apo i cili ende e mban vështrimin prapa në kurthet dhe udhëkryqet e historisë së tij ballkanike (të dominuar gjatë gjysmës së mileniumit të dytë nga sundimi otoman dhe në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të nga sundimi komunist) dhe jo përpara, drejt së ardhmes së tij evropiane.

NGA VJEN KRIZA E SHËRBIMIT TË URGJENCËS

Ankthi i “spitalit të së ardhmes”

“Në erë.” Kështu e kanë cilësuar punëtorët në grevë të urgjencës planin e paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë më 9 shtator. Për shërbimet në prag të shpërthimit ajo propozon një zarf raketik, të mbështetur në sektorë të tjerë edhe ata në vështirësi. A duhet të flasim për “krizë” të spitalit ose “thyerje” – ose për një projekt afatgjatë që kërkon t’ia ofrojë këtë institucion ikonë të shërbimit publik privatëve?

NGA FRÉDÉRIC PIERRU*

Chamonix, 1 Tetor 2016, kohë shumë e bukur. Si çdo vit, ajka e vendimmarrësve politikë, administrativë dhe industrialistë të shëndetësisë takohen gjatë CHAM-it. CHAM, - Konventa për Analizën dhe Menaxhimin e Shëndetësisë, një takim ku, nën udhëheqjen e z. Guy Vallancien, ish këshilltar shëndetësor i Z. Nicolas Sarkozy dhe profesor i urologjisë në Institutin Montsouris, flitet për të ardhmen e sistemit shëndetësor. Me një fjalë, nëse ekziston një Medef (Lëvizja e kompanive të Francës) për shëndetin, ky event do të ishte universiteti i tij i vjeshtës.

Pajisja skenike e Qendrës së kongreseve të kujton atë të një palestreboksi. Në mes, skena drejtkëndore duket si një ring i ndriçuar nga spote të fuqishme. Përreth kolltuqe të rehatshme janë rregulluar për të pranishmit. Sidoqoftë, krahasimi ndalet këtu. Mjafton të dëgjosh për shembull, z. Luc Ferry, ish-ministër i Arsimit që u bë lajmëtar i transhumanizmit, të dialogosh me shkrimtarin Erik Orsenna si në një darkë mondane, duke përzjerë konsiderata stratosferike filozofike dhe shaka të rezervuara për *happy feë*, për të kuptuar se as luftë, madje as debat, nuk do të ketë fare. Në fakt, e gjithë kjo botë e vogël pajtohet pothuajse për gjithçka. Pyetjet e ralla i bën z. Loyal nga tryeza e rumbullakët-përrastohet çdo ndërhyrje e publikut. Zkonisht, ftohen folësit që të thellonjë pikat që qeveria ka ende nerva t’u rezistojë. Pjesa tjetër, thelbësorja, ndodh gjatë: rreth tavolinës së shtruar ose restoranteve *chic*, përreth. Kjo është ajo ku, në grupe të vogla, industrialistët e shëndetit, instancat organizative, mbrojnë pranë vendimmarrësve publikë përfundimet e tyre për të zgjidhur të përjetshmen “krizë të sistemit shëndetësor”.

Në shpatet e vendpushimit borgjez të skive, deficieti i sigurimit të shëndetit (borxhi prej shumë vitesh), nuk është pjesë e shqetësimeve. Rritja e shpenzimeve shëndetësore nuk është problem për aq kohë sa nuk bëhet fjalë për shpenzime publike - shpenzime të Sigurimeve Shoqërore. Këtu, shëndeti shihet si një treg premtues, madje si një pasuri e madhe industriale e Francës. Mjekësia franceze është një nga më të mirat në botë, dhe duhet të punojë, jo vetëm

për të ruajtur rangun e saj, por edhe për të fituar pjesë të tregut jashtë vendit. Technofilia bashkon këto elita që nuk dimë më nëse janë publike apo private, të djathtë apo të majtë. Pala e vetme e thirrur është ajo e Inovacionit, me I të madhe.

Midis dy seancave të servirjes të delikatesave të tavolinës, spërkat me shampanjë, ndihet shqetësimi për vonesën europiane të inteligjencës artificiale në krahasim me dy gjigandët që janë Kina dhe Shtetet e Bashkuara. Për fat të mirë, në këtë vit parazgjedhor, të gjitha shpresat lejohen: ish-Ministri i Ekonomisë që dha dorëheqjen dhe kandidat për zgjedhjet presidenciale, z. Emmanuel Macron, e mbylli eventin, si zakonisht. Fjalimi i tij si përfaqësues i “*star up nation*” i jep audiencës shumë kënaqësi. Falë telemjekësisë, të dhënave *Big Data*, inteligjencës artificiale, mjekësisë “3P” (*parashikuese, parandaluese, të personalizuar*), Franca do të zgjidhë tërësinë e problemeve kronike të sistemit të saj të kujdesit gjithë duke u bërë lider, udhëheqës botëror i ekonomisë së shëndetit. “*Dividentë të dyfishtë*”, do të thonin anëtarët e Inspektoratit të Përgjithshëm të Financave, nga ku vjen Z. Macron.

Optimizmi i tekno-adhuresve në majat alpine, e ka të zorshme, megjithatë, të derdhet në luginën e profesionistëve të fushës (natyrisht të paftuar në CHAM). Këta të fundit ballafaqohen çdo ditë me urdhra paradoksale që gjeneron kufizimi i papranueshëm i buxhetit, i mbështetur në domosdoshmërinë e cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor: të bëhet gjithnjë më mirë, më shpejt, me burime njerëzore dhe materiale që nuk rriten, por pakësohen në disa institucione.

Vitet 2000 shënojnë një kthesë neoliberalë në politikën spitalore, ndërsa mjekësia e qytetit, ajo gëzon empatinë e habitshme të qeverisë. Për autoritetet publike, nëse kursimet do të realizohen, i takon “*spitalocentrit*” francez të paguajë haraçin e tij. Prandaj, është shkopi i buxhetit për spitalin, karrota e stimujve financiarë dhe thirrja për riorganizime vullnetare për mjekësinë e qytetit. Spitaleve u bëhet thirrje që të “*përqëndrohen në biznesin e tyre thelbësor*” - shërbime shumë të specializuara, teknike dhe të kushtueshme, por edhe misioni të shërbimit publik - dhe për të dhuruar pjesën tjetër - rentabël - për aktorët e tjerë në ofertën e kujdesit shëndetësor, që janë, në pjesën dërrmuese, privatë (mjekë privatë, klinika private...).



Emri i kodit të këtij operacioni të gjerë: “*zhvendosje ambulatorie*”. Dy leva janë përdorur për të detyruar profesionistët dyshes të spitalit që të negociojnë: kufizimi i buxhetit, nga njëra anë, dhe konkurrenca e institucioneve përmes “*vendosjes së tarifkimit të veprimtarisë*”, i njohur më mirë nga akronimi *T2A*, nga ana tjetër. Në teori, këto dy instrumente nuk janë të pajtueshme. Në të vërtetë, sipas *T2A*, sigurimet Shoqërore nuk paguajnë më strukturat, por vëllimin dhe natyrën e veprimeve të kryera nga institucionet shëndetësore. “*Paraja e ndjek pacientin*”, siç thoshte slogani i Theçerit nga fundi i viteve 1980 dhe spitali kthehej në një ndërmarrje e ftuar të rrisë pjesën e saj të tregut lokal të kujdesit shëndetësor (apo edhe tregun ndërkombëtar për instancat prestigjioze të Asistencës publike -Spitalet e Parisit - AP-HP). Më shumë aktivitet do të thotë më shumë të ardhura, pra më shumë personel dhe më shumë investime.

Sidoqoftë, qëkurse po zhvillohet kjo konkurrencë, në një kornizë gjithnjë e më të kufizuar buxhetore, financimi bëhet shumë pervers. Para së gjithash, secili institucion ka interes të zmadhojë aktivitetin e tij, përfshirë mashtrimin: rrisnin numrin e ditëve të pushimit, “*optimizojnë*” kodimin e tij falë aftësive të ndërmarrjeve private që nuk janë subjekt i sekretit mjekësor - siç denoncoi, me koston e heqjes nga posti që mbannte, z. Jean-Jacques Tanquerel, drejtor i informacionit mjekësor në spitalin e Saint-Malo, etj. Me një fjalë, me sistemin *T2A*, aplikohet në plan biznes, jo në shërbimin publik.

Por për shkak të nevojës për të mbajtur buxhetin e përgjithshëm, autoritetet publike vendosin në mënyrë të njëanshme të ulin tarifatat kur rritet

aktiviteti i përgjithshëm. Kështu, sistemi *T2A* transformon personelin e spitalit në kavje, hamster: ata janë të dënuar të vrapojnë më shpejt dhe më shpejt, pa gëzuar përmirësimin e situatës financiare të spitaleve, përkundrazi. Në fakt, produktiviteti i personelit spitalor është rritur ndjeshëm (vëllimi i kujdesit të ofruar është rritur me 3% në vit deri në 2010, pastaj me 2% nga 2015). Në terren, kjo korrespondon me një intensifikim masiv të punës. Kjo nuk parandalon përkeqësimin e cilësisë së kujdesit: koha më e gjatë e pritjes, rritja e numrit të pacientëve që kthehen në spital pas mjekimit për herë të parë, rrjedhjet e pacientëve në sektorin 2 i cilësuar me “*tarifa liberale*” (shiko më poshtë) në klinika, etj. Për më tepër, edhe pse shkalla e vjetërimit dhe përdorimit të ndërtesave është e lartë, spitalet ose kanë ndaluar investimet ose i janë drejtuar zgjidhjeve katastrofike për financat e tyre afatgjata: kredi toksike (flasim për huamarrje të “*strukturuara*”, domethënë me perqindje të ndryshueshme, shumë tërheqëse në kohën kur u nënshkruan, më pas shpërthyen për shkak të ngritjes së frangës zvicerane në rritje), partneriteti publik-privat, kontrata të shtrenjta të qirasë/mirëmbajtja për pajisje të mëdha, siç është imazhëria (IMR, skanimi PET) ...

LIRIA E SHENJTË E INSTALIMIT

Një faktor tjetër shqetësues është se mjedisi i institucionit shëndetësor nuk është aspak i gatshëm për transferimin e aktiviteteve të përfshira në ndërrimin ambulator. Kundër rrymës, mjekësia e vjetër liberale, parimet e të cilës u caktuan në 1927 përballë projekteve të para të sigurimeve shoqërore,

është në një gjendje dështimi. Jo vetëm që numri i mjekëve të përgjithshëm po bie, por ata kanë tendencë të zvogëlojnë edhe kohën e tyre të punës. Nëse Franca zbuloi “*shkretëtirat mjekësore*” në shekullin XXI, pabarazitë e përqëndrimit të sistemit mjekësor kanë qënë gjithmonë të forta për shkak të sundimit të të shenjtës liri të vendosjes. Në vazhden e majit ‘68, këto pabarazi u maskuan nga trajnimi i një numri të madh mjekësh. Në vitet 1990, sindikatat e mjekëve liberalë, privatë, u alarmuan nga ky “*bollëk*” dhe kërkuar forcimin e *numerus clausus*, përcaktimin e kuotave. Meqenëse këto grupe të shumta dalin në pension, ata denoncojnë mungesën që ata vetë e kanë ndihmuar të krijohet, dorë më dorë, paralelisht me Ministrinë e Financave

Si rezultat, numri i ndërhyrjeve për banorë të kryera nga mjekët e përgjithshëm është ulur me 15% ndërmjet viteve 2000 dhe 2013. Kjo ulje bëhet gjithnjë e më e jashtëzakonshme ndërkohë që popullsia plakët, disa patologji të caktuara bëhen kronike, dhe për këtë arsye kërkesa e përgjithshme për kujdes shëndetësor ka tendencë të rritet. Kjo do të thotë që pabarazitë territoriale të qasjes në kujdesin shëndetësor, janë thelluar.

Me një ekuilibër të favorshëm të fuqisë, sindikatat kryesore të mjekësisë madje po pyesin nëse duhet të kryejnë të vetmin lëshim që u kanë bërë Sigurimeve shoqërore në 1971: heqjen dorë nga liria për të vendosur tarifatat e tyre me shpresën për të hyrë në një fushë me më shumë pacientë, për më tepër, të aftë për të paguar përmes rimbursimit nga sigurimet shoqërore 80% të kostos së kujdesit shëndetësor.

* Sociolog, studiues në Qendrën për Studime dhe Kërkime Administrative, Politike dhe Sociale (CERAPS) dhe në Qendrën Kombëtare të Kërkimit Shkencor (CNRS). Autor me Pierre-André Juven dhe Fanny Vincent të librit *Vjedhja e shekullit*, - Rreth reformave të Spitalit Publik, Arsyet për të vepruar, Paris, 2019.

Një segment ishte tashmë në depresion në 1979 me krijimin e sektorit 2 me tarifa liberale. Qëllimi tani është që të hidhet në erë sektori 1, i njohur si konvencional, në të cilën mjekët duhet të respektojnë normat që përfaqësuesit e tyre kanë negociuar me Sigurimet Shoqërore. Praktika e tejkalimit të tarifave është e banalizuar, dhe për pacientët, pengesave financiare u shtohen pengesat territoriale. Si rezultat, kur ka nevojë për trajtim, Franca e “jelekëve të verdhë” prioritet t’u drejtohet spitaleve, veçanërisht shërbimeve të tyre të urgjencës. Këtë përfundimi, tashmë të zymtë, duhet t’i shtohet kriza e thellë në psikiatrinë publike, e cila përballlet me një mungesë kronike të burimeve njerëzore dhe materiale, siç theksohet nga mobilizimet e fundit në institucione të caktuara (*Amiens, Saint-Etienne-du-Rouvray* ...). Ky dështim ushqen kalimin në urgjencat spitalore të disa prej pacientëve që vuajnë nga çrregullime mendore.

Pas vendosjes së rregullores spitalore, sektori mjeko-social i ndau kompetencat e tij midis Shtetit dhe këshillave të departamenteve, të paafta financiarisht për të përballuar ngritjen e varfërisë dhe pasigurisë. Ai është sfiduar, gjithashtu, nga një popullsi e moshuar, e varur, ku secili nga dy përbërësit - mjekësor dhe social - përpiqen t’ia hedhin përgjegjësitë njëri-tjetrit. Kriza që ka tronditur ambientet e kujdesit rezidencial për të moshuarit (*Ehpad*) vitet e fundit ka zbuluar gjendjen e tyre të rrënuar si dhe shpeshësinë e rasteve të keqtrajtimeve. Të paguar keq, të nën-mjekuar, këto struktura i dërguan në shërbimet e urgjencës personat e moshuar, shëndeti i të cilëve po përkeqësohet.

Në rastin e atyre që mbesin në shtëpi, janë familjarët e tyre, të pagëzuar “kujdestarë”, që vuajnë pamundësinë e spitaleve për të akomoduar pacientë të moshuar, me çmimin e vështirësive ekonomike dhe dhimbjeve morale të padurueshme. Mungesa e një shërbimi të mirëfillt të shëndetit publik në rritje, gati falimentimi i sistemit mjeko-social që shkon teposhtë: këto janë shkaqet e vërteta të “krizës së urgjencave”. Kësaj i shtohet fakti që urgjencat zënë një pozitë relativisht të vogël në spital. Për shkak se ato marrin përgjegjësinë e çështjeve të konsideruara “të papastra”, duke përzier çështjet mjekësore, psikologjike dhe sociale (të pastrehë, të moshuar, pacientë psikiatrikë në krizë, etj.). Profesionalistët e përgjithshëm që ushtrojnë profesionin atje, shpesh shikohen me përçmim nga shërbimet e specializuara, të cilët vijin për të përfutur, (me fjalë të tjera, për të gjetur “rastin e bukur”, që korrespondon në mënyrë të përkryer me nozologjinë mjekësore dhe që dihet se nuk do të zërë një shtrat për shumë kohë të gjatë).

Situata po ndryshon, por ngadalë. Tani e tutje, mjekët e universitetit spitalor mund të drejtojnë shërbimet e urgjencës; mjekësia e urgjencës u njoh si një specialitet me të drejta të plota, në fund të vitit 2015, dhe diploma përkatëse e specializimit që i korrespondon, u krijua në vitin 2017.

Përveç kësaj, një pjesë e komunitetit të praktikantëve të spitalit mbështeti grevistët - padyshim që pak vonë - si MM. Bruno Riou, Dekan i fakultetit të Mjekësisë Pierre-et-Marie Curie në Paris, André Grimaldi, Profesor i Diabetologjisë dhe Anne Gervais, Zëvendës Presidente e Komisionit të Themelimit Mjekësor AP-HPi. Klinikat, nga ana tjetër, specializohen në hapësira më fitimprurëse nga pikëpamja e T2A, do me thënë, kujdesi i programueshëm, teknik dhe i specializuar (kirurgji e legenit, plevisit kataraktit etj.). Kështu, tregu i kujdesit mjekësor i krijuar nga autoritetet publike i bindet këtij rregulli klasik: shoqërim i humbur dhe privatizim i fitimeve.

Kriza e urgjencave është, pra, një krizë sistematike, simptomë e sëmundjeve të organizatës sonë shëndetësore dhe gabimeve të së kaluarës: performanca më të pakta në menaxhimin e sëmundjeve kronike sesa në atë të sëmundjeve akute, reformë spitalore me shumë efekte perverse, jo reforma -kronike (ose “jo-vendime”, siç thonë politikanët) në fushën e mjekësisë urbane

Në këtë drejtim, presidenca Macron shënon një kthesë simbolike, pasi Ministria e Shëndetësisë, zonja Agnès Buzyn, vetë praktikuese në spital, e njohu publikisht paaftësinë e autoriteteve publike gjatë njëzet viteve të fundit. Ajo tha se i duhet dhënë fund ideologjisë të “spitalit ndërmarrje” dhe “sistemit T2A”, i shndërruar me kalimin e kohës në problemin e politikës spitalore, duhet të marrë fund. Vetë Presidenti i Republikës pranoi, në një intervistë televizive me dy gazetarë, se shkaqet e krizës spitalore duhen kërkuar jashtë spitalit: në të vërtetë, kjo do të kërkonte “një përgjigje [në termat] e riorganizimit të shërbimeve tona (...) dhe problemit që qëndron midis asaj që quhet mjekësi e qytetit dhe spitaleve, për të evituar që të gjithë të shkojnë në urgjencë”.

LINDJA E “HOTEL-SPITALEVE”

Këto fjalë tingëlluan si një mospërputhje, refuzim politik i politikëbërësve dhe ekspertëve që kishin përmendur vazhdimisht grumbujt e majmë të fitimeve të produktivitetit të fshehura nën shtresat e korporatizimit dhe të “rezistencës ndaj ndryshimit” - duke u hapur dyert e spitalit firmave konsultante, me *lean management* dhe metodave të tjera të *reengineering*. Kjo ishte rentabel për këto firma, por jofitimprurëse për aktorët e spitalit, të cilëve iu veshën përgjegjësinë për situatën e pamundur të krijuar nga autoritetet publike.

Të ngushëlluar në pozicionet e tyre nga ministria, ata të cilët që nga vitet 2000, kritikonin zgjedhjet e bëra nga qeveritë e njëpasnjëshme-zgjedhje të vazhdimësisë së jashtëzakonshme përtej alternativave-mundën të hiqnin etiketën si «majmistë», që kundërshtarët e tyre ua kishin ngjitur në shpinë. Sidoqoftë, midis retorikës dhe akteve, ekziston një boshllëk, madje një humnerë. Reforma e paraqitur nga zonja Buzyn përzien

Zgjedhja miope e ekonomive buxhetore nënkupton transferimin e kostove të reformimit të pashmangshëm të sistemit tonë mbi supet e kujdestarëve që nuk mund ta mbajnë dhe mbi cilësinë e kujdesit shëndetësor. Prandaj qeveria duhet të parashikojë, në muajt e ardhshëm, vatra zjarri që s’ mund t’i shuajë me kovat e saj të vogla - që përmbajnë një shumë, për vështirësitë në punë, prej 100 eurosh bruto për çdo kujdestar në urgjenca. Ky është instalimi i kushedisatë i një “misioni”

qëllime të bukura me efekte reklamash. Shumë objektiva, të përcaktuara dobët dhe pa hierarki për të mos zemëruar askënd, mënyra të paqarta të funksionimit, këmbëngulje për të riorganizuar mjekësinë e qytetit sipas logjikës si iniciativë ku të gjitha studimet (dhe faktet) e ndërmarra prej saj tregojnë se ajo nuk funksionon: kjo është një politikë simbolike në gjithë shkëlqimin e saj. Për shembull, ministria shpreson që “komunitetet e reja profesionale të territoreve shëndetësore” - grupe profesionistësh në një territor të caktuar, bazuar vetëm në vullnetarizim-do të përmirësojnë koordinimin. Sidoqoftë, duke pasur parasysh acarimin e krizës spitalore, ky riorganizim i spitalit kundër rrymës, ka të ngjarë të ngeç në rërën e konkurrencës profesionale (mjekët të përgjithshëm/specialistë) dhe ndër-profesionale (mjekë/paramjekësorë). Në mënyrë të ngjashme, eliminimi i *numerus klauzuz* supozohet se lejon zhdukjen e shkretëtirave mjekësore, por pa vënë në dyshim lirinë e vendosjes dhe, veçanërisht, pa ndonjë rishikim të ngritjes të aftësisë të Qendrave Spitalore Universitare (CHU). Në realitet, do mbijetojnë *numerus klauzuz* zyrtarë, i vendosur nga çdo universitet sipas aftësisë të tij të pritjes. Shkurt, ka mjaft shanse që kjo reformë, si ato që i paraprinë, të varrosset së shpejti në intimitet strikt.

Për të njohur përmbajtjen e vërtetë të politikës shëndetësore makroniane, nuk duhet hedhur shikimi nga Ministria e Solidaritetit dhe Shëndetësisë, por nga kështjella Bercy. Në të vërtetë, drejtorja e buxhetit ka nën tutelë drejtimin e Sigurimeve shoqërore, përgjegjëse për hartimin e projekt-ligjit për financimin e sigurimeve shoqërore (PLFSS) të votuar çdo vjehtë nga Parlamenti. Këtu figuron niveli vjetor i shpenzimeve, i quajtur Target kombëtar i shpenzimeve të sigurimit të shëndetit (Ondam), i interpretuar nga arbitrazhet politike. Teksti është i thatë, le t’i japim fjalën një zyrtari të lartë të respektuar, ish drejtorit të Sigurimeve Shoqërore, ish anëtarit të kabinetit Cahuzac dhe presidentit aktual të Këshillit orientues të pensioneve (COR): “Një Ondam prej 2.3% mbase është i nevojshëm për të aritur objektivat e financave publike,

por nuk ka gjasa që spitalet publike dhe cilësia e kujdesit të jenë në gjendje t’i rezistojnë dëmit”. Që një përkrahës i reformave të mëparshme e konsideron kufizimin e buxhetit të paqëndrueshëm, të papranueshëm, kjo, tashmë, është instruktive, pasi bie ndesh me komunikimin e qeverisë. Por, këto komente na konfirmojnë mbi të gjitha se politika shëndetësore është zhvilluar mirë në Bercy. Vullneti presidencial për t’u bërë nxënësi i mirë i ordoliberalizmit, i mbrojtur nga Komisioni European, çon në mënyrë të pashmangshme qeverinë Philippe të shohë me zili këta mamuthë të mbrojtjes sociale që janë pensionet dhe shëndetësia. Përsa u përket shpenzimeve të shtetit, ne, tashmë, na ka ngelur kocka.

Nëse detajet e “reformës së madhe” të pensioneve nuk janë zbuluar ende, ne, tashmë, e dimë qëllimin e saj: të zvogëlojë shpenzimet publike. Për sa i përket shëndetit, ndarja e punës politike është pak më ndryshe: ministrit i lejohet të hedhë karremat dhe, në fshehtësi, zvogëlohet oferta publike, në dobi të aktorëve privatë. Kështu “spitali i së ardhmes”, ëndërruar në shtatet e Alpeve përfundon zbritjen e tij: në hapjen e tregjeve për start-up dhe kompanive të tjera shëndetësore. Dy shembuj. Ka disa vite që afër spitaleve ngrihen “*hospitals*” që synojnë strehimin e pacientëve që kanë shansin të kryejnë një operacion ambulator: sapo zbarkojnë, ata operohen, dhe nisen menjëherë ose pothuajse menjëherë për në shtëpi apo në “*hospitals*”. Por netët rrallë paguhen nga Sigurimet shoqërore: fondi i shëndetit plotësues të pacientëve. E dimë se si ata janë vektorë të pabarazisë - ose janë vetë pacientët që paguajnë. Shembulli i dytë: shoqëria Medtronic u siguron spitaleve salla operimi të teknologjisë shumë të lartë, me çelës në dorë, por, si kthim, këta të fundit duhet të angazhohen që të kryejnë një numër veprimesh dhe të derdhin një “të ardhur” për ndërmarrjen private-bota e start-up nuk është ende aq filantropike. Kjo krijon një nxitje perverse për të operuar edhe kur nuk është e nevojshme. Për Medtronic, tani është koha të flitet për “*krijimin e vlerës*” në shëndet. Kompania, gjithashtu, mori pjesë

në themelimin e qendrës *think tank* “*Cercle Valeur Santé*”, “*Qendra, Vlera Shëndeti*” e cila nisi të redaktonte një “*Manifest për një sistem shëndetësor të bazuar në vlera*” - një “*vlerë*” që supozojmë se nuk do të rishpërndahet në mënyrë të barabartë midis Sigurimeve Shoqërore dhe kompanive private. Sepse, kur një teknologji ose një ilaç krijon shumë “*vlerë*”, kompania që i shet ato, u kërkon Sigurimeve Shoqërore çmime të larta që nuk kanë lidhje me kostot reale të prodhimit.

NËN PRIZMIN E SHEMBULLIT AMERIKAN

Më në fund, deficieti, “*vrima e shoqërisë së sigurimeve*” është gërmuar saktësisht nga Inovacioni i festuar në Chamonix, ndërsa mjetet e studimit publik vazhdimisht po ulen, duke theksuar varësinë e sistemit të kujdesit shëndetësor publik ndaj kapitalizmit shëndetësor. Ilaçi i famshëm i hepatitit C, sofosbuvir, fillimisht kushtonte 41,000 euro për një kurë prej dymbëdhjetë javësh. Pavarësisht marrëveshjes midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe laboratorit amerikan që e prodhon atë, çmimi i tij është akoma 28 700 euro. Shifra të ngjashme janë në dispozicion për ilaçet e reja të kancerit, për përfutime të paqarta. “*Krijimi i vlerës në shëndet*” ka të ngjarë të hedhë në erë bankën publike, kompaninë e sigurimeve. Diagnostikimi i zhvlerësimit të organizatës sonë shëndetësore, i trashëguar nga një kohë kur kishim shijen e mirë për të vdekur në moshën 50 vjeç, tani është përhapur gjerësisht. Sfidat e sëmundjeve kronike dhe ndërlikimi në rritje i çështjeve mjekësore, sociale dhe kulturore na detyrojnë të rishikojmë themelet tona. Për t’u përgjigjur kësaj, elitat ofrojnë më shumë teknologji dhe më shumë shëndetësi private. Sipas tyre, çdo krizë, ekonomike apo shëndetësore, mund ta gjejë zgjidhjen e saj në teknike. Ka shumë arsye legjitime për të dyshuar. Nga njëra anë, sa më shumë që një sistem shëndetësor privatizohet, aq më i kushtueshëm është, siç tregon, në mënyrë të habitshme, shembulli amerikan. Nga ana tjetër, dekada kërkimesh në sociologji dhe në historinë e shkencës dhe teknologjisë na kanë mësuar të mos i nënshtrohemi determinizmit teknologjik, një formë e dembelizmit intelektual. Në realitet, duhet rishikuar i gjithë sistemi, dhe vendi i aktorëve të ndryshëm.

Zgjedhja miope e ekonomive buxhetore nënkupton transferimin e kostove të reformimit të pashmangshëm të sistemit tonë mbi supet e kujdestarëve që nuk mund ta mbajnë dhe mbi cilësinë e kujdesit shëndetësor. Prandaj qeveria duhet të parashikojë, në muajt e ardhshëm, vatra zjarri që s’ mund t’i shuajë me kovat e saj të vogla - që përmbajnë një shumë, për vështirësitë në punë, prej 100 eurosh bruto për çdo kujdestar në urgjenca. Ky është instalimi i kushedisatë i një “misioni”.

Ose kush e di, nesër, mund të ndodhë një bashkim luftërash, të «jelekëve të verdhë» me bluzat e bardha?

Në prag të zgjedhjeve evropiane të majit 2019, nuk ishte e pazakontë të dëgjoje përmendjen e emrit të një partie politike në mbledhjet e «jelekëve të verdhë»: Unioni Popullor Republikan (UPR), i njohur për mbrojtjen e një daljeje brutale nga Bashkimi Evropian ose «Frexit». Me një bazë të përkushtuar dhe efektive militante, partia pretendon të kapërcejë ndarjen e majtë. Vërtet ?

NGA ALLAN POPELARD

29 mars 2019: shtatëqind militantë të Bashkimit popullor republikan kanë lënë takim në kryeqytetin britanik. Ky grupim i pagëzuar me emrin « Franca e lirë sërisht në Londër » duhet të festojë hyrjen në fuqi të Brexit-it dhe të veprojë si një demonstrim force para zgjedhjeve evropiane. Por atë ditë, për të tretën herë, Dhoma e ulët e parlamentit hodhi poshtë marrëveshjen e arritur midis zonjës Theresa May dhe drejtuesve evropianë.

Duke valëvitur flamujt tringjyrësh me një kryq të Lorraine-ës, francezët fillojnë të përzihen me ndjekësit e Brexit-it që nxjerrin zemërimin e tyre para parlamentit. Më pas, duartrokitje nga një turmë që nuk di, pothuajse, asgjë për këtë parti të vogël politike përtej La Manche-it, duke e ngatërruar me atë të zonjës Marine Le Pen, ata drejtohen në kortezh drejt *Church House Westminster* duke bërë thirrje: Frexit ! Frexit !

Atje, z. François Asselineau, presidenti dhe themeluesi i Bashkimit popullor republikan, nis fjalimin. Pranë ministrave të tij të dikurshëm konservatorë dhe socialistë të ftuar me këtë rast, ai entuziazmohet : «*është manifestim më i madh politik, me francezë të Francës, i mbledhur deri më tani në Britaninë e Madhe që prej vitit 1940 (...)* Francezët e lirë janë sërisht në Londër në praninë tuaj dhe shpresoj që (...) ky fjalim i 29 marsit 2019 do të kumtojë paks historinë e Bashkimit popullor republikan. (...) ekuivalent me fjalimin e 18 qershorit 1940 ». Duke akuzuar «Rajhun e IV» evropian se po sulmon demokracinë, ai vazhdon: «Ngaqë ne, francezët, kemi një Petain të ri në krye të Francës, nuk duhet të kënaqen britanikët se kanë një Chamberlain të ri në 10 Downing Street (...) Ne duam një Winston Churchill të ri, ashtu siç duam një De Gaulle të ri në krye të Francës».

NJË SHEF I VETMUAR DHE SUBLIM

23 korrik, Bashkimi Popullor Republikan do të përshëndeste fitoren e Z. Boris Johnson në krye të Partisë Konservatore dhe emërimin e tij në postin e kryeministrit si një «ngjarje historike» që do të mundësonte «mbylljen e më shumë se tre vite mashtrimesh», dhe hapjen e rrugës për në Brexit. Në më pak se dy muaj më vonë, ndërkohë që i njëjti Johnson u sulmua nga deputetët britanikë, BPR do të dënonte « një grusht shteti të parlamentarëve » kundër popullit.

I krijuar në vitin 2007, BPR do që të dalë nga BE, nga euro dhe nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Traktati e tij, përshtatur më 25 mars, ditën e pesëdhjetë vjetorit të marrëveshjes së Romës, bën thirrje për «vendosjen e pavarësisë së Francës (dhe) kthimin e lirisë popullit francez». Duke denoncuar tekstet evropiane që kufizojnë sovranitetin kombëtar dhe sovranitetin popullor, BPR refuzon strategjinë e mosbindjes, në emër të respektit të së drejtës ndërkombëtare, dhe propozon aktivizimin e nenit 50 që autorizon një shtet të braktisë në mënyrë të njëanshme BE-në. Për të realizuar këtë plan, partia fton «të gjithë francezët të mbledhen pavarësisht ndarjes

të djathtë-të majtë». Në fakt, është e kotë «të debatosh pafund, pothuajse të dërrmsh veten për fiskalitetin, luftën kundër delokalizimeve, financimin e pensioneve, imigracionin, mjedisin etj». Këto tema janë «dytësore» dhe «të varura», «pasi vendimet strategjike në këtë fushë (...) janë marrë nga drejtues të pazgjedhur nga Bankës qendrore Evropiane dhe Komisionerët evropianë, edhe ata të pazgjedhur». I etiketuar «i ndryshëm» nga ministria e brendshme, Bashkimi Popullor Republikan paraqitet si një parti tranzitore. Sapo të «çlirohet» Franca, siguron ai, «secila palë të kthehet në familjen e vetë politike» dhe ndarja e djathtë- e majtë «do të rivendoset sërisht si dikur në një kuadër të qartë dhe të përshtatshëm». Në kuptim të kundërt nga shërbetarët e padronëve që dridhen nga ideja se dëmtojnë modelin social francez, Bashkimi Popullor Republikan përvetësoi të gjithë trashëgiminë e Këshillit kombëtar të Rezistencës, (CNR), i rishfaqur në mes të viteve 1990 pas një eklipsi të gjatë në periudhën e luftës së ftohtë. Ai e mori edhe si model në Programin e tij të çlirimit kombëtar, përpunuar me qëllim përgatitjen e afateve elektorale të vitit 2017. Ky i fundit mbron një siguri sociale integrale dhe propozon restaurimin e qendrës së shtetit duke kombëtarizuar totalisht ose pjesërisht energjinë (EDF, Enedis, Engie) telekomunikacionet, (Orange)mediat (TF1, TDF), koncesionarët e autostradave dhe shoqërive të ujësjellsit. Përkundrazi, privatizimi i bankave nuk është vënë në pikëpyetje. Në gjirin e një partie të dhënë pas ekspertizës, miti i Rezistencës i jep një dimension epik një sjelljeje të zakonshme. Bashkimi popullor republikan është më i gatshëm të presë ngrohtë jakat e bardha, elitat, sesa militantët luftarakë: Ky bashkim vlerëson me dëshirë figurat, ritet dhe emblemat goliste, të braktisura gjerësisht nga e djathta në vitet 1990. Duke sjellë në vëmendje kujtimet me imazhe të kauzave fisnike, ai rekruton militantë dhe bën të ligjshëm autoritetin e një shefi të vetmuar dhe sublim. I pranuar në Shkollën kombëtare të administrimit në vitin 1985, z. Asselineau zgjodhi Inspektimin e përgjithshëm të financave. Ai u punësua në kabinetin e z. Gerard Longuet në vitin 1993, dhe në

qeverinë e z. Edouard Balladur mori postin e ministrit ultraliberal të industrisë dhe të tregtisë së jashtme. I ulur në zyrën e tij të zbuluar me një portret të Charles de Gaulle dhe me një tufë flamujsh - ata të Francës, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të Organizatës ndërkombëtare të Frankofonisë-ai justifikohet : « mora frymë lirisht për shkak të ndryshimit të mazhorancës... Duke pranuar i dhashë një kolorit politik rrugëtimit tim». Dy vjet më vonë, në qeverinë e formuar sërisht nga z. Alain Juppé ai bashkohet me zonjën Françoise de Panafieu në ministrinë e turizmit, më pas me z. Hervé de Charrette në ministrinë e jashtme. Pas shpërbërjes së Asamblesë kombëtare në vitin 1997, funksionari i lartë më sërisht funksionin e tij publik të origjinës.

KUNDËR "LAKSIZMIT SOCIALIST"

Z. Asselineau ka filluar të përqafojë kauzën sovraniste në vitin 1992, që është dhe viti i nënshkrimit të traktatit të Maastricht-it. Ai kishte votuar për listën e Simone Veil –it në zgjedhjet evropiane të 1979 – «isha mainstream», mbrohet sot ai – ka qenë «i ndryshëm ndaj fjalimit të Philippe Seguin » dhe zhvilloi «një fushatë delirante të mediave për të marrë një «po» (në referendumin e organizuar më 20 dhjetor 1992) ». Në vitin 1999 ai iu bashkua Grupimit për Francën të ministrit të brendshëm të dikurshëm, Charles Pasqua, duke u bërë kështu anëtar i zyrës kombëtare, drejtor i studimeve dhe zëdhënës. « Ishte hera e parë që angazhohesh në një parti politike », nënvizon ai.

Drejtor i kabinetit të Pasqua –s, në Këshillin e përgjithshëm të Hauts-de-Seine midis viteve 2000 -2004, z. Asselineau ishte në krye të listës për zgjedhjet lokale të vitit 2001 në ndarjen administrative XIX të kryeqytetit dhe bëhet anëtar i këshillit të Parisit. Në këto afishe ai dënon trafikun e drogës dhe qentë e rrezikshëm, prostitucionin dhe efektivet e policisë që po u bie vlera, duke u bërë thirrje që ta kthejnë faqen e «gjashtëvjet laksizëm socialist ». I emëruar

në vitin 2004 nga z. Nicolas Sarkozy në krye të delegacionit të përgjithshëm për sistemin e inteligjencës ekonomike në Bercy, ai u bashkua me Unionin, Bashkimin, për një lëvizje popullore për dy vjet rresht. Së fundi, pas një kalimi në Grupimin për pavarësinë dhe sovranitetin e Francës, krijuar në vitin 2003 nga eurodeputeti z. Paul-Marie Couteaux (që më vonë do të afrohet më ekstremin e djathtë), ai përfundoi duke krijuar Bashkimin popullor republikan në vitin 2007.

Nga RPF tek RIF, nga ndarja në ndarje, trajektorja e z. Asselineau lidhet me atë të së djathtës konservatore dhe sovranë. «Thosha shpesh se tek Bashkimi popullor republikan tre gjëra janë të së djathtës: emri, që të kujton RPR (grupimin për republikën), kostumi bashkë me kravata dhe rrugëtimit im që prej njëzet vjetësh. Për pjesën tjetër e kam pasur gjithmonë për zemër që të grupoj». Në fjalimin e ish-studentit te ENA (të shkollës kombëtare të administrimit), njohim refrenet euroskeptike të një Zhak Shiraku në fillimet e tij, i cili në vitin 1978 denonconte «partinë e huaj», «Europën jo evropiane që dominohej nga interesat gjermano-amerikane», «partizanët e dorëheqjes », dhe të « agonisë së atdheut ». Por, akoma më e sigurt tingëllon jehona e platformës juridike të Philippe Seguin.

Nga koha e Maastricht në vitin 1992 deri në kandidaturën e z. Jean-Pierre Chevènement për zgjedhjet presidenciale në vitin 2002, ideja e sovranitetit u rrënoj në peisazhin e politikës franceze në mënyrë që të dobësohej miti i një mondializimi të lumtur. Në galaksinë e grupimeve që ata reklamojnë, ajo e z. Asselineau veçohet nga të tjerat. Ndërkohë që grupimet Patriotët e Z. Florian Philippot apo - Debout la France - të Z. Nicolas Dupont-Aignan, rrallë humbasin ndonjë rast për të sulmuar emigrantë dhe muslimanët, Bashkimi Popullor Republikan është pak elokuent në lidhje me këtë gjë. U ngrit një komisioni dedikuar imigrimit, por duke krijuar disa rëmuja dhe me sa dimë ne, nuk i ka bërë kurrë publike punët e tij.

Prej kohësh një grupim, Bashkimi Popullor



VËZHGIM NË GJIRIN E BASHKIMIT POPULLOR REPUBLIKAN.

Francezët që luftojnë për «Frexit»

Mospërfillës ndaj çdo materializmi, z. Asselineau nuk përmend as rolin historik të borgjezisë. Me opinion e fiksuar tek pabesia, ai kujton se të jesh francez «do të thotë të dish se elitat mund ta tradhtojnë Francën»



Republikan do të numëronte sot, pas dymbëdhjetë vjetësh eksperiencë, 38 000 ndjekës. Progresi i vërtetë daton në vitin 2017, kur z. Asselineau u paraqit në zgjedhjet presidenciale për herë të parë, disa muaj pas referendimit mbi Brexit. Arriti të marrë 587 vota (përkundrejt 17 në vitin 2012) ku vetëm gjysma ishin nga departamentet e veri lindjes. «Në kërkim të diçkaje më të madhe se rehatia e saj personale», zonja. Manon Chevalier, inxhinierë në Montreal dhe e rreshtuar tek Bashkimi Popullor Republikan që në vitin 2014, mori një pushim saabatik të gjatë, për të mbledhur premtimet mbështetëse, duke qëndruar me shpenzimet e saj në Picardie. «Në vend nuk kishte pothuajse asnjë organizatë. Telefonova rreth tetëqind kryetarë bashkie dhe takova vetëm treqind. U thosha se për demokracinë duhet mbështetur Z. Asselineau. Por pjesa më e madhe nuk e njihnin». Kjo «grua e dashuruar ndaj gjithçkaje që ka sjellë Franca», e bindur se «dalja nga Unioni do t'i lejonte vendit t'i hapet botës frankofone», arriti të sigurote 35 mbështetës – «të zgjedhur nga komunat me më pak se 300 banorë, të paetikuar, që, shpesh, u kishte ardhur në majë të hundës nga parti të tradicionale».

SHIFRAT DHE FORMUALT LATINE

Mesatarisht të moshës 46 vjeçare, pjesa më e madhe e ndjekësve janë të seksit mashkull (85%). Pjesa më e madhe (85%) nuk kanë qenë kurrë të angazhuar më parë në ndonjë parti. Nëse gjatë anketës sonë, kemi takuar zgjedhës nga të gjitha partitë, si dhe shumë persona pa parti, të shumtë ishin ata që vinin nga radhët e së djathtës. Horizontet profesionalë të bashkëbiseduesve tanë ishin shumë të ndryshme: tregtarë, shfrytëzues të ndonjë terreni kampingu, ta papunë, kontrollorë menaxhimi në një grup industrial, gazetarë, studentë, elektrikistë, agjentë imobiliar, inxhinierë (shpesh), por asnjë funksionar.

Në përgjithësi, këta militantë kanë vendosur të aderojnë pasi kanë lexuar një botim në internet ose kanë parë video nga konferencat e Z. Asselineau. Mosbesues ndaj mediave tradicionale, ata preferojnë një plejadë alternative: kanale RT (*Russia Today* e *dikurshme*) apo TvLibertés, agjencia e shtypit multimedia Sputnik, shkrime personale si ato të Olivie Berruyer (Krizat) apo të Etienne Chouard (Plani C), apo akoma kanale YouTube që kanë krijuar pak a shumë një distancë nga partia (Trouble Fait, Penseur sauvage, Thinkerview).

Çdo vjeshtë që në vitin 2012, partia organizon një universitet. Personalitete si Annie Lacroix-Tiz, Emmanuel Todd, Jean Bricmont apo Coralie Delaume kanë pranuar të marrin pjesë, një apo shumë herë. I sigurt, me një faqe interneti shumë të ndjekur, Bashkimi popullor republikan ka edhe një kanal Youtube dinamik (114 900 të abonuar) dhe që prej pak kohësh një kanal televiziv : UPRTV. Sepse «partia që ngrihet pavarësisht heshtjes së mediave», siç e deklaroi dhe sillogani, thotë vuaj, si gjithë «kandidatët e vegjël», nga përbuzja e «gazetarëve të mëdhenj». «Krijiam UPRTV për zgjedhjet europiane, shpjegon Z. Fabien Semat, përgjegjës i rrjeteve sociale. Sot rreth 15 militantë kujdesen për këtë gjë. Më shumë se një gazetë apo një revistë e përjavshme, kanali shpërndan zhvendosjet e z. Asselineau, takime të realizuara nga z. Asselineau, fjalime të z. Asselineau dhe, shumë shpejt, një emision kulturor frymëzuar nga z. Asselineau. Duket sikur interneti e ka forcuar centralizimin. E pajisur me një zyrë kombëtare dhe me delegatë nga zonat dhe departamentet, Bashkimi Popullor Republikan është një parti e strukturuar. Përqindja e dobët elektorale (0,92% në zgjedhjet presidenciale të vitit 2017) e pengoi të rimbursonte veten për shpenzimet e fushatës,

dhe kështu ajo mund të mbështetet vetëm tek militantët, që paguajnë një taksë prej 30 eurosh. Ata më energjikët mes tyre janë dekoruar. Kështu zonja Chevalier ka marrë një medalje ari të madhe «që është realizuar në mënyrë specifike nga Monnaie de Paris», shpjegon z. Asselineau duke ia vendosur medaljen para një numri të madh militantësh. Koka e medaljes paraqet monedhën 1 frangë të zmadhuar – logoja e Bashkimit popullor republikan -, dhe ana tjetër fjalët «UPR-Manon Chevalier-zgjedhjet presidenciale 2017». Të njohur nga aktiviteti i tyre, militantët e mbledhur në Kongres votojnë statutin dhe zgjedhin përfaqësuesit – vetëm në shkallë kombëtare. Në të kundërt ata nuk marrin pjesë në përpunimin e orientimeve të mëdha strategjike dhe politike. Dokumenti themelues «nuk ka pësuar asnjë modifikim», që nga redaktimi i tij në vitin 2007, siç pretendon faqja e Internetit të Partisë. Përsa i përket programit, ai nuk është bërë kurrë objekt diskutimi dhe as vote.

I shoqëruar nga dy zëvendësuar të tij, z. Charles-Henri Gallois, i ngarkuar me çështjet ekonomike, dhe z. Vincent Brousseau, ekonomist i dikurshëm tek BCE-ja, përgjegjës për çështjet monetare -, z. Asselineau është çelësi i organizimit. Në radhët e partisë, vlerësohet ndjenja e tij pedagogjike, mënyra gjithmonë e përpiktë për të administruar provat, lehtësia për t'u marrë me datat, nenet e ligjeve, numrat dhe formulat latine, bile dhe ato kërkimet e vogla, disa të dala pak mode dhe jo spontane, por më të singerta në dukje, sesa formulat e përgatitura nga këshilltarët e komunikimit. Lëvdohet gjithashtu dhe rregullsia e këtij funksionari të lartë që nuk ka asnjë ambicie personale dhe as ligësi, i përkushtuar tërësisht ndaj virtytit dhe së vërtetës – ai, njeriu i Sarajit, Pallatit, që mund të kishte zgjedhur të punonte privatisht si shumë nga kolegët e tij. Shpesh e quajnë «Zoti Asselineau», madje edhe në mungesë të tij, dhe e dëgjojnë jo vetëm si profesor, por edhe si profet. Lagjet në veri të Marsejës 8 mars 2019. «Si e kishte emrin ai që e hiqte veten si Luigji i XVI?», - pyet Z. Jean Claude Dib, i ulur në sediljen e makinës që na çon në një takim me shefin e UPR-së dhe të «jelekverdhëve». «Balladur», - përgjigjet pa ngurim shoferi ynë, z. Marc Antoniotti. «Kjo është! - fillon sërish Z. Dib. Zoti Asselineau nuk është si Balladur-i. Ai i prek duart e të gjithë atyre që e takojnë... Dhe vetëm ai flet për Francën». Njëri 69 vjeç dhe tjetri 65 vjeç, të dy militantët, njëri ish - shofer dhe tjetri muzikant, që marrin të ardhura nga solidariteti aktiv (RSA), bëjnë pjesë mes mijëra anëtarëve që numëronte Bashkimi Popullor Republikan në zonën e Bouches du Rhone. Për një kohë të gjatë «apolitik», z. Antoniotti vendosi të angazhohej në çastin e krizës ukrainase, i joshur nga «fjalimi i argumentuar» i z. Asselineau që denonconte «ndërhyrjet e Shteteve të Bashkuara dhe luftërat jo të ligjshme të NATO-s». Që në atë kohë ai merret me një faqe interneti duke instaluar një bibliotekë të vogël on-line në të cilën gjenden ese si p.sh. *Të vrasësh një komb, Vrasja e Jugosllavisë*, autor Michael Parenti, apo *Propaganda. Si të manipulosh opinionin në demokraci*, të Edward Bernays.

Kur z. Asselineau u fut në sallën e madhe ku bëhen mbledhjet, 250 persona po e prisnin. Ashu si dhe Z. Dib dhe Z. Antoniotti, pjesa më e madhe janë aderues. Shumë prej tyre kanë veshur jelek të verdhë, dhe manifestojnë çdo të enjte. Animatore e vjetër në një zonë të madhe, zonja Genny Miranda ishte një anëtare shumë aktive e protestave në Port-de-Bouc dhe në Martignes, ku nën shoqërinë e rreth shtatëdhjetë personave të tjerë, ajo ndërtoi një kabinë dhe zaptoi një kryqëzim duke qëndruar atje ditë e natë. «Është e sigurt se Bashkimi Popullor republikan ka luajtur një rol brenda lëvizjes së «jelekverdhëve» -shpjegon ajo. Ai bëri që të rritej niveli i ndërgjegjësimit të francezëve për Europën». Nëse ajo vetë e cila kishte votuar gjithmonë për të djathtën, e mori kartën e saj në vitin 2007, kjo ndodhi sepse ajo e përjetoi si një «tradhti» faktin që z. Sarkozy nuk i konsideron votat e francezëve, që e kishin hedhur poshtë Traktatin konstitucional europian me 54, 68% të votave gjatë referendumi të 29 majit 2005. «Nuk kisha qenë kurrë pjesë e një partie politike, më parë, dhe as që kisha manifestuar deri në kohën e «jelekverdhëve». Prania e Bashkimit Popullor Republikan në kortezhe favorizoi në mënyrë të pakundërshtueshme shpërndarjen e ideve të tyre përtej shoqërive numerike ku ato ishin të pranishme. Të ndërgjegjshëm për këtë mundësi, UPRTV-ja ka programuar një emision të pagëzuar «jelekverdhët marrin fjalën».

Për një kohë të gjatë, UPR-ja qëndroi larg mobilizimeve sociale. Nëse iu bashkua paradigma që u thirrën në mbrojtje të SNCF (shoqëria kombëtare e hekurudhave), më 22 mars 2018, dhe të atyre që u zhvilluan më 1 maj 2018 dhe 2019, ngeli jashtë etapave të sindikatave dhe indiferente ndaj levizjes punëtore. Kështu, në konferencën e tij që zgjati tri orë e pesëmbëdhjetë minuta mbi historinë e Francës – padyshim më e shikuara nga militantët -, z. Asselineau nuk tha një fjalë mbi përvojën e frontit popullor. Në një konferencë tjetër, «Kush e qeveris Francën dhe Europën?» funksionari i lartë shpjegoi se revolta e majit të vitit 1968 kishte ndodhur pasi CIA dhe fondacionet Ford dhe Rockefeller do të kenë kërkuar të destabilizojnë presidencën e Republikës duke paguar studentët – duke eklipsuar rolin përcaktues të kërkesave punëtore në këtë lëvizje protestë, si dhe aspiratat e tyre të barabarta.

Mospërfillës ndaj çdo materializmi, z. Asselineau nuk përmend as rolin historik të borgjezisë. Me opinion e fiksuar tek pabesia, ai kujton se të jesh francez «do të thotë të dish se elitat mund ta tradhtojnë Francën». Termi «elitë» nuk i ngjitet kurrë një klase sociale. Mbrojtja e demokracisë qëndron formale, dhe struktura e pabarabartë e shoqërisë duket si një problem dytësor. Shumë i respektueshëm kundrejt perandorisë së drejtësisë, UPRT-ja e ktheu referendumin e nismës popullore në një mjet qëndror të programit të tij. Ai nuk i beson as domosdoshmërisë për të prishur lidhjen e kontratës së punësimit, dhe as asaj për t'u prerë kokat e pasanikëve më të mëdhenj të Francës, me qëllim forcimin e demokracisë.

Që «Revolucioni e bëri francezin mbret në qytet dhe e la skllav në ndërmarrje», kjo gjë nuk e emocionon aspak.

MALANKOLI E DJATHTË

Përgjegjësja e «punëve sociale» të Bashkimit popullor republikan, Znj. Christine Annot, që na pret në shtëpinë e saj, e pranon me dëshirë. Fillimisht aderuese e RPR-së dhe e RPF-së, më pas anëtare themeluese e lëvizjes Debout la France dhe e Bashkimit popullor republikan, për momentin nënkryetare e bashkisë së Lisieux, ajo është gati të kritikojë tiraninë e Bashkimit European. Shënimi i saj biografik në faqen e partisë e përshkruan me këto terma : «me origjinë serbe nga babai, dhe franceze nga e ëma, ajo e di se Franca ashtu si dhe Serbia, aleatja e saj në vitin 1914, është Francë vetëm nëse mbetet një fuqi e pavarur dhe sovranë». Nga ana tjetër, zonja Annot duket sikur injoron pothuajse gjithçka nga programi social i partisë së saj. Kështu, ajo nuk do të vonohet as me shfuqizimin e «ligjit të punës», dhe as me rivlerësimin e SMIC mujor në nivelin 1300 euro neto.

Duke e lëvdur De Gaulle-in si «një njeri të rendit dhe të revoltës», kjo lexuese e Figaro-s dhe le Monde diplomatique, e pranishte në rrethrotullimet e rrugëve bashkë me «jelekverdhët» shprehet se : «Progresi social ka ndaluar në vend. Bëj pjesë në këtë brez që ka njohur zhvillimin falë kapitalizmit. Sot ky zhvillim është bllokuar(...) nuk ka më luftë klasash, por një luftë midis ndjekësve të modelit botëror dhe atyre që mbrojnë një lloj ideje të kombit. Në një Francë të pavarur dhe sovranë, progresi social nuk mund të vazhdojë përveçse nga bashkëpunimi midis kapitalit dhe punës». Kur e pyesim zonjën Annot nëse duhet t'u japim të drejta të tjera punëtorëve, përgjigjja e saj nuk u dëgjua : «Të drejta të reja? Nuk më duket kështu. E dini, ka shumë të drejta. Duhet forcuar ekonomia e pjesëmarrjes dhe interesimi i punëtorëve.»

I drejtuar nga një zyrtar i lartë i administratës shtetërore, Bashkimi Popullor Republikan po pajtohet me sjelljen e madhe modernizuese. Në radhët e tij, miti i Trente Glorieuses (periudha 30-vjeçare nga viti 1945-1973 gjatë së cilës vendet perëndimore njohën një lulëzim të madh) nuk është bërë asnjëherë objekt i një analize kritike. Dhe as dogma e produktivizmit dhe kortezhi i saj i brutaliteteve sociale nuk janë dënuar, dhe as cezariزمi i Republikës së V-të, (i referohet pushtetit të Jul Çezarit, autoriteti absolut i një njeriu) s'është vënë në pikëpyetje. Edhe pse nuk u morën në konsideratë nga kapitalizmi i aksionerëve ashtu si dhe nga atlantizmi dhe europeizmi triumfues, trashëgimtarët e vetëshpallur të golizmit u bashkuan në kampin e të mundurve. Megjithatë, me të njëjtin ritëm që dridhet absolutizmi i tregut dhe aspirata për të rigjetur një madhësi kombëtare nxit sërish një lloj vrulli. Melankolia e së djathtës, ku shfaqja e Bashkimit popullor republikan është një nga shenjat, ruan një pushtet mobilizues.

Argjentina tregoi se

jeriu që premtoi të kthejë faqen e “populizmit” e ka zhytur Argjentinën në një krizë ekonomike. Falimentimi i z. Mauricio Macri duhet të lehtësojë kthimin e çështjeve të Peronistëve në zgjedhjet presidenciale të 27 tetorit 2019. Duke trashëguar një vend të shkatërruar udhëheqja e vetme e asaj kohe do të duhej ta bashkonte vendin e përçarë dhe në kryqëzim.

NGA JOSÉ NATANSON *

Mëngjesin e 18 majit 2019, celulari i z. Alberto Fernandez, papritur, nisi të bjerë me tërbim. Në më pak se dhjetë minuta, mesazheria e ehatsapp-it afishoi njëqind mesazhe që po prisnin për t'u lexuar. “Ding”-et e pafundme të këtij aplikacioni po përziheshin me “dong”-et e sms-ve, të cilat binin me një rregullsi metronomi. Atë ditë, sikur të ishin duke ekzekutuar një koreografi spontane, kandidatët e mundshëm peronistë për zgjedhjet presidenciale në tetor, shpallën tërheqjen e tyre njëri pas tjetrit, ndërkohë që qeveritarët të cilët deri në ato çaste kishin qëndruar, me kujdes, të heshtur, nisën të flasin. Drejtues të shumtë sindikatash, kryetarë ndërmarrjesh dhe intelektualë, pak a shumë të njohur, të gjithë bashkë vendosën

të mbështesnin të njëjtin kandidat: njeriun, celularin e të cilit e mbytnë me mesazhe.

Kjo erë tubimi erdhi pas një deklarate të papritur, disa minuta më parë, e cila sapo ndryshoi rrjedhën e zgjedhjeve. Fjalë që nuk u shqiptuan nga z. Alberto Fernandez, por nga zj. Kristina Fernandez, që nuk ka asnjë lidhje fisnore me të. Një personalitet politik, figura më popullore në vend, vejtusha e kryetarit të dikurshëm të shtetit, Nestor Kirchner (2003-2007), presidente nga 2007 në 2015 dhe në krye të polit më të fuqishëm të peronizmit, i habiti të gjithë me një video në Tëitter: “I kërkova Alberto Fernandez të kryesojë një listë të përbashkët, ai kandidat për president dhe unë zëvendës-presidente.”

Një listë “Jane Austel”

Deri në atë çast, fushata shihej si një duel midis zj. Fernandez dhe presidentit liberal Mauricio Makri, i zgjedhur në vitin 2015. Nëse drejtuesja peroniste mund të besonte në mbështetjen e një të tretës së elektoratit, nga ana tjetër,

i duhej marrëveshje me një të tretën tjetër që e refuzonte. Në zanafillë të kësaj “krisjeje” (grieta), siç e quajnë, është konflikti midis kryetares së shtetit dhe sektorit agrar, që ka nisur që në vitin 2008.

Pak pasi mori në duar frenat e vendit, në mars të vitit 2008, zonja Fernandez shpalli një rritje të taksës

mbi eksportin e drithërave, të quajtur “tatim në burim”.

Ashtu si edhe vendet e tjera të rajonit, Argjentina eksporton sidomos lëndë të parë, veçanërisht sojë, ku renditet si eksportuesi i dytë në botë. Ndërkohë që çmimet po tejkalonin 600 dollarë për ton (përkundëjt 300 dollarëve në shtator të vitit 2019), zonja Fernandez vlerësoi se ka ardhur momenti për të kapur një pjesë më të madhe nga këto “super të ardhura” që i gëzon patronati bujqësor. Bëhet fjalë për ta pajisur shtetin me mjete të reja për të zhvilluar politikën e tij sociale dhe për të mbështetur industrinë, e dobët, raketike.

E bindur për të sulmuar reliket e një enklave feudale të vjetëruar, presidentja nuk e parashikoi reagimin që do të provokonte – ky ishte një gabim. Sepse sektori agrar, “el campo”, ndryshoi: dinamik, i integruar shumë fort me mekanizmat e mondializimit, i përshkuar nga fluksi i kapitaleve ndërkombëtare, ai nuk përbëhet më nga familje të mëdha oligarke, por edhe nga një klasë e mesme rurale në lidhje direkte me sektorët e financës dhe të mediave private. Për tre muaj rresht, el campo zë rrugët dhe kërcënon se do t'i zhyset qytetet në krizë ushqimore. Ai arriti ta fitojë çështjen deri në Kongres.

Zonja Fernandez ia del të rregullojë mjaftueshëm popullaritetin e saj që të zgjidhej sërish në vitin 2011, por krisja vazhdon të jetë e madhe. Sepse reforma fiskale e parashikuar nuk është tjetër veçse një manifestim i ri i një konflikti historik më të thellë. Nga njëra anë, forcat e lidhura me peronizmin “e epokës së parë” (1945-1955), sot e kësaj dite përfaqësohen nga kirchnerizmi. Duke u mbështetur te periferitë e mëdha urbane, provincat e varfëra të Veriut dhe Patagonisë, punëtorët dhe të varfërit, por, gjithashtu, dhe te klasat e mesme progresiste dhe të rinjtë, jko



Cristina Kirchner, Mauricio Macri dhe Alberto Fernandez

rrymë mbron një model ekonomik që favorizon industrinë, zhvillimin e tregut të brendshëm, rritjen e pagave, ngritjen e një shteti të fortë. Nga ana tjetër, liberalizmi klasik i mishëruar, tashmë, nga presidenti Mauricio Makri, është mishërimi i fundit i anti-peronizmit. Baza e tij sociale gjendet në sektorin agrar eksportues dhe në lagjet e pasura të qyteteve të mëdha. Projekti i tij është: më pak taksa, më pak shtet, më pak rregulla dhe më shumë treg. Me pak fjalë, Ronald Reagan që do kërcente tango.

Secili prej këtyre dy poleve kristalizon rreth një të tretën e votave. Në mes një qendër “pluskuese”, pa besnikëri politike, vendos rezultatin e votimeve. Në vazhdim të konfliktit të saj me el campo, zonja Fernandez adoptoi një strategji që synonte të “siguronte mbështetjen e këtij poli të tretë, një “minoritet i gjallë” na shpjegon gazetari Martin Rodriguez. Edhe Makri të njëjtën gjë ka bërë. Por vota e 1/3-ës e popullsisë të ndihmon vetëm të fitosh zgjedhjet dhe të qeverisësh, jo të ndërmarrësh ndryshime të mëdha dhe afatgjata”.

Nga ka dalë dhe opsioni i imagjinuar nga drejtuesja peroniste për zgjedhjet e 2019. Z. Alberto Fernandez shfaqet si një i moderuar që bën lëshime dhe njihet si njeri i hapur – sepse, pasi kishte mbajtur postin e shefit të kabinetit të Nestor Kirchner-it, më pas të Znj. Fernandez, u distanca nga kjo e fundit pas konfliktit social më 2008. Duke u bashkuar sot me të, zonja Fernandez shpreur të kapërcejë bërthamën kirchneriste dhe t'u bashkohet fraksioneve konservatore të peronizmit, që e urrejnë.

Operacioni duket i frytshëm: me më shumë se 50% të votave (kundër 32% për Z. Makri), lista e ashtuquajtur “Jane Austen”, që i bashkangjiti arsyen (Alberto) ndjenjave (Cristina), u imponua gjatë fushatës parazgjedhore të 12 gushtit 2019. Një rezultat që, nëse u zemë besë leksioneve të së shkuarës, të bën të parashikosh një fitore dërrmuese më 27 tetor 2019.

Njeriu i bizneseve të fuqishme, i afërt me mjediset financiare ndërkombëtare, Z. Makri, në vitin

* Drejtor i botimit argjentinian i “Le Monde diplomatique”.

DREJT NDËRHYRJES

Të vësh dorë

Edhe në kampin e kundërshtarëve të presidentit brazilian, media e profilit të lartë që e shtrëngonte atë kundër homologut të tij francez, ngjall ndjenja të përbashkëta. Për të parandaluar Jair Bolsonaro-n që t'ia dorëzojë Amazonën Agrobiznesit, a duhet të vënë në dyshim parimi i sovranitetit territorial të shteteve, siç sugjeron zoti Emmanuel Macron?

NGA RENAUD LAMBERT

Të prezantohesh si kundërshtar i privilegjuar i homologëve të huaj të cilësuar si “liberalë”, ky është vërtet një ushtrim të cilin presidenti Emanuel Macron e kryen me dëshirë. Në fillim kundër kryeministri hungarez Viktor Orban, dhe më pas kundër udhëheqësit të Ligës italiane Matteo Salvini. Zjarret që shkatërrojnë pyjet e Amazonës që prej fillimit të vitit, i kanë dhënë atij një kundërshtar të ri me profil ideal: presidenti Brazilian i ekstremit të djathtë, Jair Bolsonaro,

mizogjin, homofob, dhe dyshues i ndryshimeve klimatike, klimato-skeptik. Ndërkohë që, në fund të gushtit, revista Science, do të vendoste një lidhje midis reve të tymit që nxinin qiellin brazilian deri në Saõ Paulo dhe politikës së shpyllëzimit që inkurajohet nga Brazili. Z. Macron sugjeroi që t'u jepej “një status ndërkombëtar pyjeve të Amazonës, në rast se drejtuesit e kësaj zone do të dëmtonin për planetin”.

Një pyll mijëra vjeçar, shpëtuar prej sharrave

vetëm nga mobilizimi i atyre që ai mbron. Në fjalimet eliziane, bota ngjason paksa me planetin Pandora që imagjinoi James Cameron për filmin e tij Avatar (2009), presidenti francez mishëron një version tokësor të qëndresës së Na'vis, kësaj popullate, me lëkurë blu që mrekulloi sallat e errëta. Fatkeqësisht, edhe pse i hartuar nga një Emanuel Macron me jelek të kaltër puthitur pas trupit, propozimi mezi “i entuziazmoi brazilianët”, përfshi këtu edhe ata që ishin kundër Z. Bolsonaro. Disa nuk i kanë haruar një mijë e një projektet që kanë kërcënuar tashmë të heqin sovranitetin e vendit të tyre, në këtë hapësirë të ripagëzuar Hylée nga natyralisti gjerman Alexander von Humboldt (1769-1859). Këtyre aksioneve u bën jehonë ambicia e Z. Macron në ditët e sotme.

Në shekullin e XIX, hidrografi dhe meteorologu Mattheë Fontaine Maury (1806-1873), drejtor i Observatorit detar të Uashingtonit, propozoi që të rregullojë çështjen raciale në Shtetet e Bashkuara duke kolonizuar Amazonën për të vendosur aty popullsinë amerikane me ngjyrë. Strategjia e tij konsistoi fillimisht në

kërkesën për “hapjen” e thjeshtë të lumit të Amazonës për lundrim.

“I gjithë shtypi u hodh në fushatë, - rrëfen historiani Luiz Alberto Moniz Bandeira. Mbrojtësit e skllavërisë, armëpunuesit, tregtarët dhe piratët u mobilizuan të gjithë për të mbrojtur atë që Maury e paraqiste si një politikë të tregtisë për interes të shkencës.” Megjithatë, në vitin 1849, përfaqësuesi i Brazilit në Uashington (ekuivalent i ambasadorit), vuri alarmin. Autorizimi për të lundruar në Amazonë “do t'i hapte dyert formimit të ndërmarrjeve tregëtare amerikane, imigrimit masiv dhe, për pasojë, një manovre të ngjashme me atë që i lejoi (Uashingtonit) të fuste duart në Teksas”. Një korrespondencë e Maury-t e vitit 1853, zbuluar nga shtypi brazilian, konfirmon se këto shqetësime nuk janë të pajustificuara. “Të mundohemi të bindim bashkëbiseduesit tanë në rrugë diplomatike, - shkruan ish oficeri, sepse, ndoshta, do të jetë e mundur të fitohet hapja e Amazonës në rrugë paqësore.” Para se të saktësojë metodën e tij: “Paqe nëse mundemi, forcë nëse duhet”, gjithsesi, projekti dështoi.

NDËRKOMBËTAR I TREGOJNË MUSKUJT NJËRI-TJETRI

e majta nuk ka vdekur

2015, propozoi “profesionalizmin” e tij sipas te cilit duhej ndërprerë çdo lidhjet me “populizmin kirchnerist”.

Harta e tij e rrugëtimit nuk kishte asgjë inovative: ekonomi pa rregulla, liri e lëvizjeve së kapitaleve dhe dobësimi i shtetit, gjithë duke parë ëmbël tregun. Një seri e tillë masash, tok me një riafrim gjeopolitik me fuqitë e mëdha perëndimore, duhet të garantonte, sipas tij, një “*shi investimesh*” dhe një hov të eksporteve. Katër vjet më vonë, investimet e huaja nuk mbërritën, exportet qëndruan në vend dhe Argjentina shënoi inflacionin më të lartë të Amerikës Latine pas Venezuelës – ajo duhej të arrihte 55% në 2019.

Gabimi i Z.Makri rrjedh nga një lexim i keq i kontekstit ndërkombër. Në çastin që mori funksionet, bota ishte futur në një fazë të ngadalësimit ekonomik, karakterizuar nga një kthim i proteksionizmit, në sfondin e luftës tregëtare midis Uashingtonit

dhe Pekinit. Kërkesa botërore për lëndë të parë po ulej. Plani i Z. Makri ishte konceptuar për një botë që nuk ekzistonte më.

Pa motorët ekonomikë tek të cilët ai kishte pasur besim, njeriu i biznesit u mbështet në borxhe për të vënë në zbatim programin e tij. Ndërkohë që rruga e tregjeve u mbyll, në maj të vitit 2018, ai u kthye drejt burimit të vetëm të financimeve të mundshme: Fondi monetar ndërkombëtar (FMN). Për argjentinasi, që e njihnin më mirë se çdokush koston e “ndihmës” që ky i fundit u ofron shteteve në vështrësi, fondi është ekuivalent i Belzebuthit -Djallit. Falë mbështetjes së presidentit amerikan Donald Trump, me të cilin Z. Makri ka një marrëdhënie miqësore prej kohësh, Buenos Aires-i ka marrë një program të ndihmës financiare prej 57 miliardë dollarësh (rreth 51 miliardë euro), shuma më e madhe e parave që mund të ketë dhënë ndonjëherë FMN-ja.

ndryshe nga episodet e mëparshme, masakra ekonomike nuk u shoqërua me shpërthim social. Nuk pati asnjë skenë vjedhjeje në supermarkete, asnjë pushtim ndërtesash publike, asnjë konfrontim me policinë. Afërsia e organizimit të lëvizjeve sociale dhe masave të ndihmës të me nevojtarëve të zbatuara nga Kirchner dhe gruaja e tij – që shumë shpesh mbështeteshin nga z. Makri – kontribuan në shmangien e kaosit ekonomik që të mos lindte rebelimi. Manifestimet u shumëfishuan, por u zhvilluan gjithmonë në një klimë relativisht të qetë. “*Qeveria e Makrit ishte zero, por janë në ikje e sipër. Duhet edhe pak durim*”, thotë Z. Pedro Tapia, i Konfederatës së punëtorëve të ekonomisë popullore, para pikturës murale që përsërit këto fjalë: “*Ata po ikin*”.

I vetëdijshëm se po vihej në krye të një vendi në shkatërrim e sipër, ku rindërtimi do të kërkonte vite të tëra, z. Fernandez nisi t’i moderojë shpresat e mbështetësve të tij.

Misioni i tij i parë do të jetë negociimi i borxhit të vendit pranë FMN-së, më pas pranë huadhënësve privatë, me qëllim që të fitojë një liri veprimi në manovrën ekonomike. Sipas marrëveshjes së firmosur nga z. Makri, Argjentina duhet t’i derdhë Fondit 24 miliardë dollarë (rreth 22 miliardë euro) në vitin 2020, më pas 31 miliardë dollarë (rreth 28 miliardë euro) vitin tjetër. Për momentin, fasha e borxhit ngrihet në 100% të produktit të brendshëm bruto, një peshë që nuk përputhet me programin e zhvillimit nga Z. Fernandez.

Por peronisti, në bisedimet e tij me FMN-në, mund të mbështetet në një precedent të tanishëm: në vitin 2005, qeveria e Nestor Kirchner-it-ku ai vete ishte shef i kabinetit-ka shtrënguar huadhënësit për një ulje prej 70% të vlerave të tyre

financiare, një ulje e paparë ndonjëherë në histori. Pushteti i ri do të ketë në dispozicion, për më tepër, një argument me peshë. Në fakt 51% e kapacitetit të huave të FMN-së është çuar në Argjentinë. A nuk thotë fjala e urtë se: kur i detyrohesh 100 000 dollarë bankës, këtu ka një problem; kur i detyrohesh 100 milionë, është banka që ka një problem.

Konteksti gjeopolitik do të jetë përcaktues, vecanërisht roli që do të vendosë të mbajë Uashingtoni, që ka të drejtën e vetos në gjirin e FMN-së. Z. Fernandez premtonte të mbajë një marrëdhënie “*të pjekur*” me Shtetet e Bashkuara: t’i japë fund me servilizëm mardhenies me z. Makri, por pa i shkëputur lidhjet. Ashtu si pjesa tjetër e nënkontinentit, Argjentina është një objekt konkurrence i egër midis gjigandëve amerikanë dhe kinëzë, gjë që përkthehet për të si një pavarësi e dyfishtë: për sa i përket të parit, për shkak të ndikimit që ai gëzon mbi organizmat e kredidhënies dhe fondet e investimit që mbajnë vlerat e borxheve argjentinase; për sa i përket të dytit, si klient kryesor i eksportuesve lokalë dhe i vetmi burim (ose pothuajse) i financimit të punëve të infrastrukturës.

Një diplomaci e shkathët mund ta transformonte këtë morskë në një dobi, duke ushtruar një fuqi të madhe kundër tjetrit për të fituar më të mirën e secilit. Do të ishte shumë e rëndësishme që Amerika latine të mos jetë më ajo e periudhës së mahnitshme kirchneriste (2003-2015). Në atë kohë, Amerika e Jugut qeverisej nga drejtues të majtë të prirur për bashkëpunim. Sot, ajo është e ndarë midis të majtëve dhe të djathtëve, këmbyes të lirë dhe protektionistë, të hallakatur midis strategjive të afrimit me fuqitë e mëdha dhe tentativave të forcimit të integritit rajonal. Me pak fjalë, do të ishte delikate të besojë në këtë kontinent të krisur.

“*Makri e fiku motorin e ekonomisë. Gjëja e parë që duhet bërë, është të ndezim motorët, -na shpjegon z. Matias Kulfas, funksionar i lartë i dikurshëm kirchnerist dhe një prej këshilltarëve kryesorë të z. Fernandez. Për t’ia dalë mbanë do të rrisim rrogën reale, pensionet, dhe shpenzimet publike. Por, me kujdes, me qëllim që inflacioni mos të fluturojë, dhe në kuadrin e një pakti social mes punëtorëve dhe sipërmarrësve.*” Në imagjinatën peroniste, sipërmarrësi është prej kohësh një aleat i punëtorëve përballë pronarëve të mëdhenj të tokave. Meqë industria është shumë pak kompetitive për të eksportuar, i duhet të zhvillohet falë një Shteti të fortë, rrogave të ngritura dhe një politike monetare në antipod nga ajo që kërkon kampi liberal.

Një fitore e gjerë në zgjedhjet presidenciale të tetorit, me një diferencë më të madhe se 20 pikë në përqindje, do t’i jepte z. Fernandez një bazë solide për t’u përballuar me FMN-në dhe huadhënësit e vendit. Ajo do t’i lejonte të udhëhiqte një alencë të gjerë peroniste. Sepse kjo lëvizje nuk është një parti klasike, me një ideologji të kthjellët, e institucioneve të formalizuara etj. Është një forcë heteroklite që mbledh udhëheqësit konservatorë të provincave të Veriut, qendrat e mëdha sindikale, të rinjtë progresistë të qyteteve... Në zemër të kësaj magme politike në rikompozim të vazhdueshëm, kirchnerizmi zë një vend vendimtar. Në mënyrë që sintonia midis z. dhe znj. Fernandez të jetë vendimtare për të garantuar suksesin e tyre. Duhet të transformohet kaleidoskopi peronist në një koalicion të qeverisë, i aftë të balancojë interesat që, shpesh, janë divergjente, konfliktuale, ndonjëherë kontradiktore. Nga ky sukses do të varet aftësia e z. Fernandez për të zbutur krizën në të cilën neoliberalizmi e zhyti vendin që prej gati katër vitesh.

“Akoma edhe pak durim”

Sic ndodh shpesh, kjo ‘bujari’ e stabilizoi ekonominë vetëm për disa muaj, para se kushtet që i ishin vënë të rëndonin krizën. Masat e ashpra të kërkuara nga Fondi e ngritën përqindjen e varfërisë në 34, 1% të popullsisë, kurse papunësia preku tashmë një në dhjetë persona. “*FMN-ja e transformoi ngërçin ekonomik në ngërç social, dhe më pas në ngërç politik*”, analizon Claudio Scaletta, ekonomist dhe autor i një libri që parashikoi kaosin aktual.

Për Z. Macri, fushatat zgjedhore të 11 gushtit qenë goditje përfundimtare. Pas katër vjetësh në pushtet, baza e tij sociale u pakësua në 1/3 e përrjetshme të anti peronizmit. Një ditë pas zgjedhjeve, dollari fluturoi

dhe ata që kishin depozituar para nxituan në banka për të tërhequr depozitat e tyre. Inflacioni njohu një ngritje të menjëhershme. Banka qëndrore tërhoqi nga rezervat e saj për të mbrojtur peso-n, por, deri në një miliardë dollarë në ditë, që avulluan shpejt... Fëmija i dashur i tregjeve që kishte premtuar të modernizonte ekonominë, e ndjeu veten të detyruar të deklaronte një gabim të pjesshëm dhe të përdorte një mjet që ai e cilësoi si “*populist*” para se të zgjidhej: kontrollin e këmbimeve të parave.

Si në vitin 1989, më pas në vitin 2001, kriza shpërtheu në vazhdim të një zhvlerësimi masiv dhe të çrregullt që uli rrogat dhe e zhyti ekonominë në recesion. Por,

PËR ARSYE KLIMATERIKE

mbi Amazonën

Pothuajse një shekull më vonë, në vitin 1948, Organizata e Kombeve të Bashkuara për arsimin shkencën dhe kulturën, (Unesco) themelon Institutin ndërkombëtar të Hylë-së amazoniane (IIHA). Fillimisht e perceptuar si një qendër ndërkombëtare kërkimi në shkencat natyrore, ky i fundit u zhvillua “*duke e shndërruar zhvillimin ekonomik të zonës së Amazonës në një aks madhor të veprimit të saj*”, - raporton studiuesi në Unesco Malcolm Hadley. Anëtarët brazilianë të strukturës u akuzuan se “*rrezikuan sigurinë kombëtare duke autorizuar krijimin e një instituti ndërkombëtar në “zonën e mbrojtjes natyrore” të Amazonës*”. Në radhën e parë të kritikave, presidenti i dikurshëm Artur Bernardes, i cili në tribunën e Dhomës së deputetëve më 24 janar 1950, foli për kërcënimin se mund ta shihnte pyllin të transformuar në “*një ndërtesë kombesh*”, që do të përfundonte “*në ndarjen e zonës në formë kolonish*”.

Instituti u rrënuar, por ide të tjera lindën. Një prej ideve më me fantazi doli nga Instituti Hudson, me qendër në Uashington. Në vitin 1967 futurologu Herman Kahn, drejtori i tij, sygjeroi

të bllokohej me diga lumi i Amazonës për të krijuar një “*liqen të madh kontinental*”, që do të lehtësonte qarkullimin midis vendeve kufitare dhe do të mundësonte prodhimin e sasive kolosale të energjisë. “*Absurde*” reagoi prerë geografi Herve Thery: “*Me një bllokim prej shumë kilometrash, ngritja e ujërave do të përmbyste një pjesë të mirë të popullsisë së Amazonës*”. Megjithatë, propozimi u mor shumë seriozisht nga ushtarakët, që ishin në pushtet që prej grushtit të shtetit në vitin 1964, dhe kjo i nxitte të formulonin doktrinën e tyre në lidhje me pyllin: “*Integrar para nao entreguar*” (të integrojmë territorin për të mos e dorëzuar).

Diktatura ndërtoi një seri kantieresh faraonike të paracaktuara që të pushtonin një hapësirë e cila konsiderohej si bosh. Më e spikatura mes tyre mori formën e një autostrade që duhet të shpaloste një shirit bitumi prej 4 000 km midis qytetit të Cabedelo-s në pjesën verilindore, dhe atij të Labrea-s, afër kufirit bolivian. Edhe pse nuk përfundoi asnjëherë, e gjitha vepra u përuar në vitin 1972, me premtimin se do të lehtësonte hyrjen tek tokat e më të varfërve, duke

shmangur një reformë agrare të refuzuar nga ushtarakët. “*Njerëz pa tokë, për një tokë pa njerëz*”, theksoi atëherë propaganda zyrtare.

Në mënyrë paradoksale, ky pohim i influencës braziliane në hapësirën e Amazonës, lehtëson hapjen ekonomike të vendit, për të cilën po punon dhe Brazilia. I konceptuar si një minierë e pashtershme pasurish, pylli i madh duhet të tërheqë institucione shumëkombëshe, furnizuese kapitalesh dhe teknologjish moderne që mungojnë në Brazil.

Të sigurohet sovraniteti kombëtar i vendit në mënyrë që të kënaqen urrekset e të huajve: projekti i ushtarakëve do ishte dukur kontradiktore, duke e bërë të brishtë përgjegjësinë e parë që ata kishin marrë – të garantonin sigurinë e vendit – me pretekstin të punonin për atë përgjegjësi që kishin kërkuar kur morën pushtetin – të favorizonin zhvillimin e vendit. Lufta e ftohtë i fshiu vështrësitë duke i ftuar të siguronin kufijtë gjeografikë me të tjera ideologji. “*Në atë kohë bota ishte e ndarë midis Perëndimit të krishterë dhe Lindjes komuniste, shpjegon kërkuesja Ana*

Cristina da Matta Furniel. Kjo do t’i lejonte forcave të armatosura të zgjidhnin dy probleme: atë të sigurisë (duke bërë aleancë me botën perëndimore) dhe atë të zhvillimit (përmes investimeve private që vinin nga Perëndimi).” Nënshkrimi i kontratave me shumëkombshet dhe ndjekja e guerillasve nëpër pyje, lidhjet me të njëjtën ambicje : mbrojtjen e sovranitetit brazilian.

Kthimi i demokracisë në vitin 1985 u krye në një kontekst ndërkombëtar ku ra në sy emergjenca e masave ndaj mjedisit dhe të drejtave të popullatës indigjene. Kushtetuta e re mbart vulën e kësaj demokracie ku neni 231 përcakton se “*u njihen vendasve (...) të drejtat e tyre të origjinës mbi tokat që ata zotërojnë tradicionalisht*”, dhe se “*i takon Unionit që t’i kufizojë dhe t’i mbrojë*”. Vrasja e sindikalistit Francisco Alves, në vitin 1988, i njohur me emrin Chico Mendes, i cili mbronte të drejtat e punëtorëve që mblidhnin latex në plantacionet me dru-rë hevea, nxitoi një fushatë ndërkombëtare të mbështetur nga personalitete të spektaklit, ku bënte pjesë dhe anëtari i dikurshëm i Beatles, Paul McCartney. (Vijon në faqen 22)

«Bisha me thundrën e plasaritur»

NGA PAUL PRESTON *

Francisko Franko nuk ka asnjë dëshirë të jetë bujar dhe e shikon ndëshkimin si një nismë afatgjatë. Pikërisht këtë gjë e shpreh në fjalimin e tij të 19 majit 1939, kur drejton në Madrid paradën spektakolare të fitores. «Të mos krijojmë iluzione të kota: shpirti çifut, që bëri të mundur aleancën midis kapitalistëve të mëdhenj dhe marksizmit dhe që qëndron pas çdo pakti me revolucionin anti-spanjoll, nuk mund të hidhet poshtë në një ditë, dhe ky shpirt gjendet akoma në shumë zemra.» Ai hedh poshtë çdo ide për pajtim me të mundurit: «*Është e nevojshme t'u jepet fund urrejtjeve dhe pasioneve të luftës sonë të tanishme, jo sipas mënyrës së liberalëve, me amnistitë e tyre monstruoze dhe vetëvrasëse që kanë bërë shumë me hipokrizinë sesa me faljen, por me shumë falje shlyerjes së dënimeve nëpërmjet punës, pendimit dhe sakrificës.*»

Imagjinata, sipas së cilës të mbrosh Republikën, konsiderohet një krim i rebelimit ushtarak, shërben si bazë për të gjitha gjykatat ushtarake. Përveç disa njerëzve të njohur, të akuzuarit nuk kanë të drejtë të mbrojnë veten e tyre. Ushtria zgjedh gjykatësin, prokurorin dhe «avokatin» e mbrojtjes, dhe ky i fundit është gjithmonë një oficer i një rangu më të ulët se gjykatësi dhe prokurori. Meqë trupi gjykoes i ushtrisë nuk ka personel të mjaftueshëm për të përballuar kërkesat e kësaj situate të re të krijuar, proceset gjyqësore, në përgjithësi, drejtohen nga oficerë pa asnjë formim juridik (...) Grupe të burgosurish, që nuk njihen mes tyre, dhe që akuzohen për krime krejtësisht

* Historian, autor i *Lufta e shfarosjes*. Spanjë 1936-1945 (Berlin 2016) nga është shkëputur edhe ky tekst.



Francisko Franko

të ndryshme, gjykohen njëherësh. Ata nuk kanë mundësi të shohin dosjet në ngarkim të tyre, me akuzat të lexuara me zë të lartë, pa asnjë provë.

Kur prokurori mbaron së paraqituri «dosjen», shumë rrallë ndodh që i akuzuari autorizohet të flasë me avokatin për të shqyrtuar mbrojtjen e tij. Nëse janë me fat, të akuzuarit kanë një orë kohë për të përgatitur argumentimin e tyre, por nuk kanë të drejtë të thërrasin dëshmitarë dhe as të paraqesin prova. Më shpesh, e kanë të pamundur të dëgjojnë palën akuzuese, ose sepse kanë vdekur, tashmë, ose sepse gjatë «proceseve përmbledhëse urgjente» dëshmitë nuk janë komunikuar ende. Nuk lejohet asnjëherë apelimi vendimi.

Kur Juan Caba Guizarro, anëtar i Konfederatës kombëtare të punës në Manzanaras, u gjykua në të njëjtën kohë me nëntëmbëdhjetë persona të tjerë, prokurori deklaroi: «*Pak rëndësi ka nëse jeni të pafajshëm ose jo, për atë çka ju akuzojmë, as nuk dua t'ia di fare dhe nuk do të informohem për arsyetimet, alibitë apo rrethanat lehtësuese që ju mund të paraqisni. Ashtu si dhe në gjykatat e mëparshme*

ushtarake, më duhet t'i bazoj akuzat e mia në dosjet e përgatitura nga hetuesit sipas denoncimeve të bëra. Për të akuzuarit unë përfaqësoj drejtësinë. Nuk i dënoj unë, por qyteti i tyre, armiqët e tyre, fqinjët e tyre. Unë vetëm sa u huazoj zërin tim akuzave që janë formuluar nga të tjerët në heshtje. Sjellja ime është mizore dhe e pamëshirshme dhe mund të besohet se puna ime konsiston vetëm në përgatitjen e togave të ekzekutimit me qëllim që puna e tyre për spastrim social të mund të vazhdojë. Por, jo, ne që jemi të gjithë këtu dhe që kemi fituar luftën do të përfshihemi të gjithë dhe shpresa jonë është që të eliminojmë çdo lloj opozite derisa të vendosim rendin tonë. Duke marrë në konsideratë faktin se ka krime për vrasje në të gjitha akuzat, arrita në përfundimin se duhet të kërkoj dënimin me vdekje; kërkoj togën e ekzekutimit për tetëmbëdhjetë të parët në listë dhe për dy të tjerët kërkoj dënim me varje. Asgjë më tepër». Avokati i mbrojtjes përfaqëson të njëzet të akuzuarit përnjëherë, pa pasur kohë dhe as mundësi të përgatisë as më të voglin argumentim. Ai ngrihet në këmbë dhe thotë: «*Pasi dëgjova akuzat e rënda kundër t'ij pandehurve që kam këtu*

për të mbrojtur, nuk mund të bëj asgjë tjetër veçse të kërkoj mëshirë. Asgjë më tepër».

Enrique Suñer Ordóñez u emërua president i Gjykatës Kombëtare për politikën. Gjatë luftës, ndërkohë që ishte zëvendës-president i komitetit të arsimit dhe të kulturës në qeverinë e parë të Frankos, Suner, deri atëherë profesor i mjekësisë pediatrike në universitetin e Madridit, ka mbikëqyrur spastrimin e mësuesve. Në një libër të botuar në vitin 1938, ai flet për gjakun e derdhur gjatë luftës. Ai vë përballë njëri-tjetrit, gjakun e «*bishave të neveritshme, me instinkte më të këqija se kafshët e egra*», me gjakun që rrjedh «*në kraharorët fisnikë spanjollë, të ushtarëve dhe të milicëve, të rinisë bujare, plot shpirt sakrifice dhe me një heroizëm kaq të madh saqë plagët e saj e ngrënë në një status gjysmë-zot të mitologjisë greke*».

Më pas ai ngre pyetjen: «*Nuk duhet të ndërshkohen autorët e këtyre vdekjeve të tmerrshme? Shpirti ynë revoltohet ndaj pasigurisë se mos individët e pamëshirshëm që shkaktojnë tragjedinë tonë, nuk ndërshkohen. Është tërësisht e pamundur që Perëndia dhe njeriu të lenë pa ndëshkuar kaq shumë vrasje, përdhunime, mizori, vjedhje si dhe shkatërrimin e kaq shumë thesareve artistike dhe mjeteve të prodhimit. Është e nevojshme të betohemi përpara të dashurve tanë të zhdukur se dënimet e merituar do të ekzekutohen me dhunë e shenjtë*».

Suñer i konsideron politikanët republikanë si «*njërëz të tmerrshëm, me të vërtetë diabolikë. Sadistë dhe të çmendur, të bashkuar me hajdutë profesionistë, mashtrues, kusarë të armatosur dhe vrasës që kanë zënë poste ministrash,*

zëvendës-sekretarësh dhe funksionarësh të lartë, dhe gjithfarë postesh të tjera të rëndësishme (...). Derra të egër dhe kafshë dythundrakë që ecin përmes parlamentit, në kërkim të viktimit për sakrificim me qëllim që t'u ngulin dhëmbët apo t'i shtypin me çizmet e tyre (...). Pas tyre fshihen frank-masonët, socialistët, komunistët, Azanistët, anarkistët, të gjithë drejtuesit çifutë të marksizmit të zi që ka Rusinë për nënë dhe shkatërrimin e qytetërimit evropian si parullë... Spanja ka qenë dhe vazhdon të jetë teatri i një beteje epike midis titanëve dhe monstrave të apokalipsit. Programi i zhvilluar në Protokollin e të Urtëve të Sionit, po bëhet realitet» (...)

Në vitin 1943, më shumë se dhjetë mijë fëmijë u vendosën në jetimore të kishave. Justifikimi i kësaj politike jepet nga shefi i shërbimeve psikiatrike të ushtrisë rebele, komandanti Antonio Vallejo Nagara. I fiksuar keq pas pastërtisë raciale, Vallejo shkroi në vitin 1934 një libër ku mbron treshjen e psikopatëve. Anëtar i trupës mjekësore të ushtrisë, ai shërbeu në Marok dhe kaloi mjaft kohë në Gjermani gjatë Luftës së Parë Botërore për të vizituar kampet e të burgosurve. Ai takoi, gjithashtu, psikiatër gjerman Ernst Kretschmer, Julius Scheälbe dhe Hans Ealter Gruhle, puna e të cilëve thesareve artistike tek ai. Gjatë luftës civile, ai u emërua shef i shërbimeve psikiatrike të ushtrisë rebele. Në gusht të vitit 1938, i kërkoj Frankos leje për të krijuar Laboratorin e kërkimeve psikologjike. Dy javë më vonë arriti të marrë autorizimin. Qëllimi i tij ishte të diagnostikonte idetë e majta. Për kënaqësinë më të madhe të komandës së lartë ushtarake, punët e tij sjellin argumente «shkencore» që justifikojnë idenë se kundërshtarët janë qenie inferiore, dhe kështu ai u emërua colonel

Të vësh dorë mbi Amazonën

(Vijon nga faqja 21)

Në të njëjtën kohë, kur studime të ndryshme përcaktuan se gjatë viteve 1970, dhjetë milionë hektarë pyje të Amazonës u shndërruan në kullota, vërshuan dhe reagimet e ndërkombehtarëve. «*Ndryshe nga ç'mendojnë brazilianët, Amazona nuk u përket atyre, por na përket neve*» - deklaroi senatori dhe zëvendës-presidenti i ardhshëm Albert Gore në vitin 1989. Ndërsa presidenti Fransua Miteran shtoi: «*Brazili duhet të pranojë një sovranitet relativ mbi Amazonën*».

Ndër vite, qeveritë demokratike tentojnë ta çarmatosin idenë që, ende, e interpretojnë si një formë lakmie e huaj, duke integruar çështjet mjedisore dhe atë të indigjenëve në fletushkat e udhëtimit. Kryeministri Brazilian i përkushtuar tërësisht ndaj çështjeve të mjedisit, u zgjodh në vitin 1992. Disa muaj para Samitit të Tokës në Rio, që u mbajt në të njëjtin vit, presidenti Fernando Collor de Mello shpalli krijimin e një territori Yanomami prej 9, 4 milionë hektarësh.

Me këtë politikë të zhvillimit të Brazilit si «afatgjatë» dhe me respektin ndaj popullatës autoktone, është e kotë të imagjinohet se mund të shkelet me këmbë sovraniteti i saj, shpjegon shkurt Brazilia.

Të kthyer në barakat e tyre, forcat e armatosura vazhdonin të ishin të shqetësuar. Para syve të tyre, rezervat indiane përbënin fillimin

e një «ballkanizimi» të Amazonës që do të formonte ishuj të vegjël indigjenësh «lehtësisht të manipulueshëm nga vendet e pasura». Përsa i përket kërkesës ekologjike, ajo do të lehtësonte emergjencën e «normave ndërkombehtarë larg parimit të vjetër të barazisë së të drejtave midis shteteve, të mosndërrhyrjes dhe vetëvendosjes së popujve». Armiku i djeshëm ka shkëmbyer dritën e kuqe me atë të gjelbër, armët me organizatat joqeveritare: por, megjithatë, kërcënimin, ende nuk do të zhduket. Më 10 dhjetor 1991, ish - ministri i ushtrisë, Leonidas Pires Gonçalves, shpjegoi për të përditshmen *Folha de Sao Paulo*-s se sekretari i Shtetit për ekologjinë i ngjall «*të njëjtën urrejtje që kishte provuar dikur për drejtuesin komunist Luis Carlos Prestes*».

Duke emëruar në postin e ministrit të ekologjisë Z. Ricardo Salles, drejtori i dikurshëm i Shoqërisë fshatare braziliane (një bastion i agrobiznesit), Z. Bolsonaro, bashkohet me vizionin e miqve të tij ushtarakë. Duke harruar fjalimet e paraardhësve të tij mbi zhvillimin afatgjatë dhe premtimin për të mbrojtur mjedisin: *për sytë e tij*, Amazona është një burim pasurie për ta mbrojtur në mënyrë që të nxirren përfitime. Një qëndrim i tillë lehtëson kthimin e refrenit të globalistëve... dhe dyshime. Sepse Brazili nuk i

ka shpëtuar fakti që gjithë këto fuqi të mëdha që ngrejne idenë e mbrojtjes së natyrës si një prioritet për vendet e Jugut, ia kursejnë vetes, më shpesh, barrën për të bërë të njëjtën gjë. Pa llogaritur këtu që në vitin 2007, «komuniteti ndërkombehtar» e kishte injoruar propozimin e Quito-s për të mbrojtur Parkun kombëtar Yasuni të Amazonës në këmbim të derdhjes së gjysmës së shumës që do nxirrej nga shfrytëzimi i tij. Urrejta që miliona brazilianë ndiejnë për Z. Bolsonaro i shpie që t'i kuptojnë fjalimet e presidentit të tyre si një çmenduri paranojake.

Duke argumentuar se Amazona është «një problem botëror» dhe duke ndaluar këdo që të pretendojë se «*kjo gjë i përket vetëm atij*» (Twitter, 26 gusht 2019), Z. Macron projekttoi idenë që të paraqeste në Konferencën e Santiagos të vitit 2019 mbi ndryshimet klimatike (COP 25) «*një strategji afatgjatë*» që thekson se do të sigurojë «*mirëqënien e popullatës*» së Amazonës dhe do të garantojë «*një zhvillim afatgjatë dhe ekologjik*» në gjithë zonën. Kështu, do të shohim të rishfaqet ideja e një të drejte për ndërhyrje klimatike, si kalk i ndërhyrjes njerëzore, që justifikoi sulmet ushtarake perëndimore në Somali në 1992, në Haiti në 1994 dhe në ish-Jugosllavi në vitin 1999 ...

«*Këshilli i lartë i Kombeve të bashkuara mund (...) të kishte vlerësuar se, duke kontribuar për ndryshimet klimatike, shkatërrimi i pyllit të Amazonës përbën një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombehtarë, kjo i lejon atij*

të japë përgjigje shtërguese», hamendëson drejtori i Institutit të kërkimeve strategjike të Shkollës ushtarake (Irsem), Z. Jean-Baptiste Jeangene Vilmer, në kolonat e Le Monde, më 27 gusht 2019. Nëse hipoteza e përdorimit të një force – ndërhyrje ushtarake për të vendosur një perimetër mbrojtjeje dhe për të ndaluar shpyllëzimin, p.sh - duket marrëzi dhe e rrezikshme, sepse padyshim rezultoni aspak produktive, ne nuk mund të përjashtojmë se në një situatë të ngjashme, pas dhjetë apo njëzet vjetësh, nëse ky objektiv do shihet si jetësor, do ngrihet kjo pyetje : a do të mjaftojë sulmi kundër nacionalizmit reaksionar të forcave të armatosura për t'iu përgjigjur kërcënimeve shqetësuese ?

Në nëntor të vitit 2000, gjatë një debati në një universitet amerikan, Z. Cristovam Buarque, një prej udhëheqësve të Partisë së Punëtorëve (PP e majtë), u pyet nga një student mbi idenë e ndërkombehtarizimit të Amazonës. Përgjigja e tij u bë e famshme në Brazil:

«*Nëse Shtetet e Bashkuara duan të ndërkombehtarizojnë Amazonën që të mos rrezikojnë braktisjen e saj duke e lënë nën përgjegjësinë vetëm të brazilianëve, atëherë le të ndërkombehtarizojmë gjithashtu edhe arsenalin nuklear amerikan. Jo për gjë, por Shtetet e Bashkuara e kanë treguar tashmë se janë të aftë që ta përdorin arsenalin duke provokuar një shkatërrim shumë herë më të madh se zjarret (...) që po vështojmë në Brazil*».

«JOKER», FILMI QË PO TRONDIT KINEMATË

Antiheroi i përjashtuar nga shoqëria

Filmi projekton katër plagët që po shoqërojnë epokën e globalizmit dhe shoqëritë perëndimore, si bota e financës, mediat vulgare, pushteti agresiv etj. Jokeri ose antiheroi i mishëruar në figurën e një të dizekuilibruari që duket sikur simbolizon pjesën e përjashtuar nga shoqëria, të fyer dhe të nëpërkëmbur, që shpesh është pjellë dhe viktimë e dhunës, hakmerret duke institucionalizuar si mjete të hakmarrjes dhunën dhe vdekjen.

NGA ILIR YZEIRI

Nuk e di përse mes meje dhe kinemasë ka vetëm një lidhje – shëtitja te Pedonalja dhe vështrimi i posterave që vendosen aty. Pak më tej, vendi ngjet me një park të bukur mbushur me bare. Ndërkaq, për filmin « Joker » po lexoja dhe po dëgjoja shumë. Ishte përhapur menjëherë lajmi se loja e Joaquin Foenix është e mrekullueshme, ndërsa miti i Jokerit, këtij antiheroi që i kundërvihet Batmanit, më tërhiqte, po ashtu. Për të gjitha këto dhe për shumë arsye të tjera, vendosa të shkoj në kinema.

Ishte e shtunë, ora 19. Tetori është një muaj i bukur, por sivjet, për shkak të diellit dhe freksisë në mbrëmje është edhe më i bukur. Shumë të rinj që presin të hyjnë në kinema, vetëm pak, dy-tri çifte që i kanë kaluar 50-tat ngajnë si të ardhur nga një vend tjetër. Por kinemaja është mbushur dhe ndjesia është e bukur. Më kujtohen kohët kur kinematë ishin plot dhe ndër kënaqësitë më të mëdha që provonim. U duk sikur televizioni apo interneti do ta mundnin kinemanë apo librin dhe printin. Ende jo, përkundrazi, ka filluar një rigjallërim i tyre. Edhe në Shqipëri, po ashtu. Madje janë me shumicë të rinjtë që vijnë në kinema dhe kjo i bën ata njësoj si bashkëmoshatarët e tyre në Europë që zgjedhin në fillim kënaqësitë që shijohen në ambiente kolektive dhe jo vetminë nganjëherë vrasëse të rrjeteve sociale.

ILUZIONI

Por filmi ka filluar. Nis loja e bukur e Joaquin Foenix. Në ekranin e madh projektohet portreti i një kllouni me buzët e shqyera dhe të lyera me të bardhë, hundën e kuqe dhe një tabelë në dorë. Ai hidhet e kërcen në rrugë, qesh e zbatim kalimtarët. Befas, disa të rinj i rrëmbejnë pankartën që mbante në dorë. Ai i ndjek, ata vrapojnë, pastaj, në një lagje të mjerë, te disa kazanë plehrash ata i kanë zënë pritë. E rrëzojnë dhe e mbytin me shqelma e grushta. I thyjnë edhe tabelën në kokë. Ngrihet i përgjakur dhe ikën në shtëpi. Kështu nis historia e këtij kllouni që jeton në Gotham City. Kthehet i dërrmuar dhe aty e pret e ëma e cila, edhe ajo, ashtu si ai, është e përpirë nga një sëmundje tjetër nervore: kjo ka humbur kontrollin mbi të shkuarën e saj dhe, për ta fshehur tragjedinë që ka kaluar i biri edhe për faj të saj, ka ndërtuar një histori iluzive sipas së cilës djali i saj është fëmija ilegal i kryetarit të bashkisë së qytetit, me të cilin ajo ka pasur marrëdhënie kur punonte si pastuese në shtëpinë e tij. Ndaj, çdo mëngjes ajo shkruan nga një letër për të dhe ia jep të birit që t'ia dërgojë në postë. Aty ajo i qahet për gjendjen e vështirë të të birit. Arthur Fleck, kështu quhet protagonist i film-it është i dërrmuar nga të gjitha anët. Konsultat me psikologun që e ndjek pasi ka dalë nga spitali shkojnë keq. Në një prej tyre ajo i thotë se shteti ka bërë shkurtime në buxhetin e trajtimit të këtyre lloj të sëmurëve; ai nuk do të ketë mundësi që të blejë ilaçet. Janë shtatë lloj medikamentesh që i duhet të përdorë në ditë. Me



Joaquin Foenix në rolin e Joker

këtë gjendje të rënduar shkon në kompaninë e kllounëve ku punonte. Të gjithë e dinë se disa të rinj e kanë dhunuar. Por bos i kërkon të gjejë tabelën që ia kanë thyer në kokë. Një koleg i tij i afrohet dhe i jep një pistoletë. Merre, i thotë të mbrohesh dhe lekët m'i jep kur t'i kesh.

Në një shfaqje në një spital fëmijësh, duke performuar, i bie pistoletë. Skandal. Kthehet dhe shefi i kompanisë së kllounëve, i alarmuar për këtë incident, e pushon nga puna. I traumatizuar nis për në shtëpi pa hequr maskën. Në trenat e natës, në një vagon gati bosh, i përhumbur në ndënjësën e tij sheh se tre të rinj fodullë dhe arrogantë po ngacmonin një vajzë të re me brutalitet. Ajo lëviz nga vendi, ata e ndjekin, ai u del përpara, ata e shtynë e nisin ta qëllojnë me shqelma e grushta dhe, në një çast, ai nxjerr pistoletën qëllon dhe vret të parin, pastaj ndjek dhe vret edhe të dytën. Nuk ngopet me gjak dhe e ndjek dhe vret edhe të tretin. Kthehet në shtëpi dhe sheh lajmet: vriten tre djem të rinj të botës së financës. Personi që ka qëlluar mbante një maskë kllouni. Ndërkaq, një nga personazhet e famshme të televizionit disa herë kishte parodizuar një shfaqje të tij ku ai tregonte se donte të bëhej aktor komik. Naiviteti i tij përqeshet nga ylli televiziv i showt Murray Franklin interpretuar nga Robert De Niro. Janë vënë në lëvizje të gjithë. Dy agjentë vijnë në shtëpinë e tij ta pyesin për vrasjen që ka tronditur qytetin. Gazetari i famshëm e lajmëron se ka dëshirë ta ftojë në showt e tij, natyrisht, për t'u zbatimur me dobësitë e tij. E ëma, duke dashur të largojë nga shtëpia dy detektivët që vijnë të kërkojnë të birin, rrëzohet, plagoset e bie në koma dhe shtrihet në spital. Arturi kishte mësuar duke hapur një nga letrat e së ëmës historinë e tij me kryetarin e bashkisë. I shkon te shtëpia dhe aty takohet me djalin dymbëdhjetëvjeçar me atë që sipas së ëmës duhet të ishte vëllai i tij nga i njëjti baba. Pastaj, në tualetin e teatrit të qytetit e takon dhe Thomas Wayne, kryetari i bashkisë i zbulon se e ëma vuan nga manitë dhe gjithë kjo histori është e sajuar. Ty të ka adoptuar i thotë ai dhe unë e ndihmova duke e çuar në azil. Aksioni merr një rrjedhë të papritur. Ai gjen dosjen e së ëmës në azilin Arkham dhe aty merr vesh të vërtetën e tmerrshme. Ai është adoptuar dhe kur ishte fëmijë e ëma e ka lënë të abuzohet nga bashkëjetuesi i saj i dhunshëm. Ikën në shtëpi dhe aty i vijnë për vizitë dy ish-kolegët e tij. Ai vret atë që i dhuroi pistoletën. Pastaj shkon në spital te e ëma dhe e mbyl me jastëk edhe atë. Ndërkaq, në banesën e tij jeton dhe një grua me një vajzë të vogël. Autorët kanë treguar me mjeshtëri iluzionin e heroit me këtë fqinjë të bukur. Ai gati e kishte besuar se kishte rënë në dashuri me të, se kishin dalë bashkë, se ajo e kishte shoqëruar edhe në spital. Të gjitha iluzione. Pas krimit të tmerrshëm ndaj së ëmës ai

shkon në shtëpinë e saj bërë qull edhe nga shiu. Ajo llahtariset, por ai del dhe nuk ndodh asgjë. Iluzioni aty shuhet. Ndërkaq, bëhet gati të marrë pjesë në showt e Murray Franklin. Përgatitet, shkon dhe aty, në dialog me të, ai tregon të vërtetat tragjike. Unë i kam vrrarë tre djemtë e pasur. Unë e kam mbytur edhe mamanë time. Sapo vrava dhe një koleg timin. Dhe nxjerr pistoletën dhe vret në transmetim të drejtpërdrejt edhe gazetarin e famshëm. Të gjitha këto veprime i kryen sikur të ishte duke luajtur në një shfaqje rolin e zbritës të kllounit. Del nga studioja. Policia i vihet mbrapa. E arreston dhe duke e çuar në rajon spektatorët shohin se qyteti është përfshirë nga manifestime të dhunshme dhe të gjithë mbajnë nga një maskë si kllouni. Të gjithë janë me kllounin që vrau djemtë e pasur. Dhunë në rrugë, plaçkitje, një kamion përplas makinën e policisë ku ndodhej ai dhe protestuesit e nxjerrin jashtë e vënë mbi kofanon e makinë e ai përmendet ngadalë. Qyteti është nën pushtetin e kllounëve që po djegin e po plaçkinis gjithçka. Salla e kinemasë sulmohet nga protestuesit me maska dhe njëri prej tyre e ndjek në një rrugë kryetarin e bashkisë dhe të shoqen dhe i vret që të dy. Në fund Arthur Fleck na shfaqet në një spital psikiatrik e në dialog me psikiatrin, nuk i tregon atij shakanë e fundit që ka në kokë por nis të këndoj këngën *That's life*, kurse në një anë tjetër, Bruce-i i vogël, djali i kryetarit të bashkisë është në një korridor spitali përballë pirndërve të mbuluar me gjak.

LEXIM METAFORIK I KRIZËS

Siç shihet, filmi duket sikur është ndërtuar i gjithi mbi apoteozën e dhunës. Në kulturën pop amerikane figura e Jokerit që nga ana etimologjike vjen nga loja me letra, pra xholi ai që futet kudo dhe që zgjidh çdo situatë, është ndërtuar që në vitet '50 si e kundërta e Batmanit, heroit që ndihmon të pambrojturit dhe që, ashtu si lakuriqi i natës ngjitet mbi ndërtesa dhe e ndjek të keqen kudo që ajo ndodhet. Ndërsa Jokeri përdor dhunën e pakontrolluar dhe simbolizon deri diku djallin. Maska prej kllouni që ai përdor disa herë të kujton edhe Xhek Nicolsonin në filmin *Batman*. Kritika franceze ka krahasuar imazhin e Jokerit si tipolli me atë të Kuazimodos dhe me Guinplenin e Viktor Hygosë. Ndërsa në shumicën e tyre, të gjithë kritikët janë në një mendje se ky film është shumë pranë realitetit dhe është një lexim metaforik i krizës dhe i dhunës që, në shumë raste, karakterizon shoqëritë e mëdha perëndimore. Vrasjet me armë zjarri në Amerikë, protestat e jelekverdhëve në Francë që të kujtojnë dhunën me maska si të kllounit në këtë film, janë një jehonë edhe e protsetave në Hong Kong, Kili, Bejrut e Bolivi.

Aq e vërtetë është kjo sa kur u shfaq filmi në disa kinema transmetimi i tij u shoqërua edhe me praninë e policisë aty në mënyrë që të mos përsëritej ngjarja e Aurorës që siç dihet ndodhi mes natës së 19-20 qershorit 2012 në sallën e kinema Aurorë në Kolorado të SHBA-ve ku u vranë 12 persona prej 24 vjeçarit James Eagan Holmes në kohën që po shfaqej filmi *The dark Knight Rise*. Ndërsa, në një vështrim tjetër, filmi duket sikur ka projektuar katër plagët që po shoqërojnë epokën e globalizmit dhe shoqëritë perëndimore të cilat janë mbërthyer nga kriza të thella. Nga njëra anë bota e financës që në film simbolizohet me tre djemtë arrogantë dhe fodullë që duan të përdhojnë një vajzë të pambrojtur në tren, media vulgare dhe pushteti i njerëzve që me cinizëm tregojnë të pavërteta dhe e shohin anën tjetër të botës, pjesën e pambrojtur si ushqime për humorin e tyre të zi. Pushteti i fryrë dhe agresiv që, nga njëra anë shton luksin dhe nga ana tjetër pret fondet për trajtimin e të pambrojturëve dhe të sëmurëve. Familja, kriza e thellë dhe dhuna e brenda saj Jokeri ose antiheroi i mishëruar në figurën e një të dizekuilibruari që duket sikur simbolizon pjesën e përjashtuar nga shoqëria, të fyer dhe të nëpërkëmbur që shpesh është pjellë dhe viktimë e dhunës hakmerret duke institucionalizuar si mjete të hakmarrjes dhunën dhe vdekjen. Mirëpo autorët nuk mendojnë kështu. Regjisorit Todd Philips, që është frymëzuar sidomos nga *Taxi Driver-I* e *Scorezes* thotë se antiheroi ose leximi i personalitetit të njeriut është gjithmonë diçka që i kapërcen kufijtë e realitetit. Në një intervistë tjetër, ai thotë: "Përpikuni të jini zbritës në këtë shoqëri të zgjuarish dhe të vetëdijshëm. Ka shumë artikuj që rrekën të shpjegojnë pse komeditë nuk funksionojnë më. Po ju tregoj pse, sepse të gjithë djemtë me të vërtetë zbritës e lënë këtë punë nga frika se do të ofendohen prej të tjerëve. Është shumë e vështirë të debatosh me 30 milion njerëz në Twitter. Është vërtetë e pamundur apo jo? Kështu, që thoni ju, unë po ndaloj dhe e dini pse? Të gjitha komeditë e mia kanë një pikë të përbashkët – dhe mendoj se është rasti i të gjitha komedive – ato janë të parëndësishme. Befas, i thashë vetes: si mund të bëj një film të parëndësishëm gjithë duke i bërë naftën komedisë? E di, thashë. Marrim universin e komikëve dhe u përdredhim qafën atyre. Pikërisht kështu pata idenë të bëj Jokerin" (Allociné, Megan Choquet, 3 tetor 2019). Ndërsa një tjetër, autor dhe teolog, Alex McFarland, thotë: "Do të doja të thoja se të rinjtë që janë të dashuruar me antiheroin dhe me vrasësin dhe njerëzit realisht të deziluzionuar e me karakter mashtrues, janë tregues i shkatërrimit të familjes dhe prishjes së kulturës. Mund të themi shumë gjëra për këtë, por ajo që i lidh ata me antiheroin është pikërisht vetëdija se ata ndjehen të tjetërsuar".

KOLË LUKA DHE VEPRA E TIJ "SHQIPËRIA MESJETARE NË TOPONOMASTIKË DHE ONOMASTIKË"

Shkëlqimi i një dijetari që punoi në hije

Si emër i mbetur në hije, i njohur turbull për përktimet në frëngjisht – gjithnjë pa autor – jo vetëm të të shumtës së artikujve shkencorë në revistën albanologjike *Studia albanica*, por edhe të rezymeve të punimeve shkencore të pothuaj gjithë organeve albanologjike që botoheshin në Shqipërinë socialiste, – Studime historike, Studime filologjike, Çështje të folklorit shqiptar, Kultura popullore, Iliria etj., – nuk janë shumë ata specialistë të albanologjisë që e dinë Kolë Lukën edhe për kontribues të rëndësishëm në studimet albanologjike.



Kolë Luka

NGA PROF. DR. AUREL PLASARI

Me rastin e këtij botimi, për ta nxjerrë këtë kontribues të dalluar të studimeve albanologjike nga hije e "epokës socialiste", është e udhës të tregohet diç më shumë për jetën dhe veprimtarinë e tij.

Kolë Luka ishte lindur më 28 tetor 1917 në Shkodër, në një familje të kamur. I ati Angjelin Luka ushtronte veprimtari jo vetëm tregtare, por edhe industriale, si zotërues i një fabrike karamelësh, bonbonesh, llokumesh dhe prodhimesh të ndryshme sheqeri. E ëma ishte gjithashtu bija e njërit prej tregtarëve të mëdhenj të Shkodrës, Gjon Ashikut. Kolë Luka që i pari i pesë fëmijëve të familjes. Shkollimin e filloi në Shkodër, aty deri në vitin 1933 kreu Kolegjin e Shën Françesk Ksavjerit, të mbajtur nga Etërit Jezuitë. Pra ishte shkolluar "ndër Jezuitë", siç përgojohej gjatë "epokës socialiste" një shkollim i tillë. Më 1933, pa mbushur të 16-at, u dërgua në Neuchatel të Zvicrës për të studiuar "*Langues Modernes & Branches Commerciales*" në Institut des Frères des Écoles Chrétiennes Neuchatel Suisse. Mbas studimeve të mesme, më 1937 filloi studimet universitare në Universitetin e të njëjtit qytet në degën "Menaxhim biznesi". Ideja e të atit kishte qenë ta përgatiste njërin prej bijve për të ndjekur biznesin e familjes. Mirëpo ndodh që jeta e njeriut, nga njëra anë, dhe formimi i tij, nga tjetra, të shndërrohen në paradoks. Kujt do t'i nevojiteshin studime të tilla për menaxhim biznesi në "epokën socialiste", në të cilën do t'i takonte Kolë Lukës të ushtronte gjithë veprimtarinë e vet? Paradoksi i ngjashëm me studimet e një tjetri të shkolluar "ndër Jezuitë", Injac Zamputi, me diplomën e tij të Shkencave politike nga Universiteti i Triestes (1941).

Në vitin 1939, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, kishte filluar një periudhë e rëndë për familjen, por edhe për biznesin e saj. I ati që internuar në Gramsh, më vonë në Porto Romano, ndërsa i vëllai – intelektual i njohur Gjovalin Luka – ndodhej në ilegalitet si pjesëmarrës aktiv i Grupit Komunist të Shkodrës dhe mandej i Luftës Nacional-Çlirimtare. Atëherë e ëma i bëri thirrje djalit të madh që të kthehej në atdhe për të përballuar vështirësitë e familjes. Kolë Luka u kthye në Shkodër më 1941 dhe iu vu menaxhimit të biznesit të të atit.

Me pushtetin e ri të vendosur nga përfundimi i Luftës, më 1945 Kolë Lukës iu besua drejtimi i Radio Shkodrës. Ishte fjala për një institucion të

krijuar aty për aty dhe, si i tillë, ai mban përgjithnjë vulën e përkushtimit profesional të drejtorit të parë. Mbas një viti pune u shtrëngua të kryente shërbimin e detyruar ushtarak, të cilin e përfundoi më 1949, d.m.th. në moshën 32-vjeçare. Prej vitit 1950, i vendosur në Tiranë, filloi punën në Institutin e Shkencave, sikurse emërtohej atëherë, si përkthyes i gjuhës frënge. Më 1952 u martua me një bijë të familjes Harapi, familje me zë në Shkodër, por edhe të Marubëve emërmëdhjenj.

Një parantezë do të duhet hapur këtu për një tjetër veprimtari të Kolë Lukës: veprimtari me peshë kombëtare dhe ndërkombëtare për kulturën shqiptare. Paralel me punën në institutet e albanologjisë, Kolë Luka u shqua edhe si përkthyes në qarkun më të ngushtë të dy ose tre përkthyesve veprash nga shqipja në frëngjisht. Sqima e tij kulturore, si edhe prerja intelektuale, e shmangën nga përkthimeve tekste të rëndomta; zgjodhi të përkthente vepra të qenësishme prej thesarit të krijimtarisë gojore të popullit shqiptar ose të letërsisë së traditës. Vetëkuptohet synimi: për t'i bërë ato pjesë të pasurisë kulturore të popujve të botës. Fryte të asaj veprimtarie të tij tanimë të regjistruar si unikale janë përmbledhje, si: *Chansonnier populaire albanais* (Universitë d'État d'Albanie, Tirana 1961), *Chansonnier des Preux Albanais* (Collection "UNESCO", Paris 1967), *Le Chants albanais au cours des âges* (Université d'État d'Albanie, Tirana 1969), *Choix de poèmes albanais de nos jours* (Naim Frashëri, Tiranë 1969), *Tresor du chansonnier populaire albanais* (Académie des Sciences de la RPS d'Albanie, Tirana 1975), *Chansonnier épique albanais* (Académie des Sciences de la RPS d'Albanie, Tirana 1983) etj. Nuk mund të mos spikatim krahas tyre përkthimi në frëngjisht i veprës së Çajupit, *Baba Tomorri* (Père Tomor, Traduit de l'albanais par Kolë Luka, Editions d'État "Naim Frashëri", Tirana 1962), dhe posaçërisht i asaj poetike të Migjenit (*Poèmes*, Traduit de l'albanais par Kolë Luka, Préface par Andrea Varfi, Éd. Pierre Seghers, Paris 1965). Poezia e Migjenit në frëngjisht u botua në Paris nga i mirënjohuri botues Pierre Seghers në kolanën e tij "*Autour du monde*", n° 85. E drejtuar në atë ndërkohë nga poeti dhe kritiku Alain Bosquet, ishte një kolanë që kishte për mision t'i ofronte publikut ndërkombëtar poezinë më të mirë botërore në një editurë luksoze për t'u çmuar edhe sot e gjithë ditën.

Të gjitha këto vepra, përpos detyrave në institutet e albanologjisë ku shërbeu, kryheshin në atë që e quajmë zakonisht "kohë e lirë". "Kohë e lirë" është një fjalë goje, sepse përbëhet prej mijëra e

mijëra orësh të vjedhura nga gjumi i mbasditeve, nga pushimet, nga dëfrimet, qoftë edhe nga nevojat për limonti. Siç kryhen, pothuaj gjithnjë, veprat e pasionit. Jo më kot familjarët e kujtojnë në marrëdhëniet familjare si njeri "ëorkaholic". Ndërkaq edhe puna në institutet ku shërbeu duhet përfytyruar gjithnjë e mbingarkuar. Do t'i binte të regjistrohej ndër të rrallat raste përjashtimore të specialistëve që as të pensionoheshin nuk i lejohnin. Kam pasur rastin të dëgjoj, gati në trajtë anekdotike, sesi në moshën 71-vjeçare, mbas një pune të stërlodhshme, një dite të vitit 1988 qe detyruar t'i jepte drejtorit të atëhershëm një mesazh të këtillë: "Sot është e shtunë dhe është dita e fundit e punës sime. Të hënën nuk vij më në punë".

Autorit të këtij shënimi i ka qëlluar ta njohë modestisht zotërinë autoritar Kolë Luka, jo vetëm si banorë të një lagjeje, por edhe falë një shkrimi vlerësues për njërin nga kryeveprat e tij në fushën e përkthimeve (*Epika jonë gojore në frëngjisht: "Chansonnier épique albanais"*, në: "Nëntori, nr. 1 / 1984). Sot nuk e gjykoj dot se ç'vlerë mund të ketë ai shkrim imi, por nga perspektiva llogaris që për Kolë Lukën në "epokën socialiste" pothuaj nuk shkruhej. Jo vetëm kaq, por në "epokën socialiste" Kolë Lukës iu desh të çante edhe mes zilië e ligësie. Nëse ndokush dëshiron dëshmi, le të zbrësë nga rafti i bibliotekave botimim francez të *Eposit të kreshnikëve* të përkthyer në frëngjisht prej tij dhe të botuar nga UNESCO: "*Collection UNESCO d'Oeuvres Représentatives. Série Européenne*". Në të emri i Kolë Lukës nuk ekziston, ndërsa spikat me shkronja të mëdha (*exergue*) emri i drejtorit të atëhershëm të Institutit të Folklorit si autor i një herjeje: *Chansonnier des preux albanais*, Introduction de ZHINI SAKO, Maison neuve & Larose Paris 1961. Më ka qëlluar të jem në dijeni të orvatjeve të zyrtarëve të Tiranës që edhe në botimin e Migjenit në Paris emri i Kolë Lukës të mos shënohej; atëherë ndeshën në refuzimin e botuesit Seghers dhe të drejtuesit të kolanës Bosquet, të cilët nuk pranuan ta kryenin një shëmti të tillë, ndryshe nga burokratët e bindur të UNESCO-s.

Kolë Luka vdiq më 4 gusht 1994 në moshën 77-vjeçare. Nuk iu gëzua dot daljes në dritë të veprës së tij *Dokumente të Rilindjes për Shkodrën: Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba (1877-1878)* (Tiranë 2000), e cila iu botua postume nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2000. E lënë në dorëshkrim, ishte vepër së cilës studiuesi i qe kushtuar me vite të tëra, gjithnjë në "kohën e lirë", si dhe e dorëzuar për botim qysh 12 vite të shkuara. Lxuesit e interesuar për vlerat e saj mund të lexojnë çmuarjet që i kanë bërë asaj në veprimtarinë promovuese – si model i një pune kërkimore-shkencore me kritere të rrepta metodike etj. – prof. dr. Gazmend Shpuza dhe prof. dr. Seit Mansaku.

Kolë Luka nuk mban gradë doktorale dhe as titull profesor. Prej vitit 1972 qe vlerësuar thjesht si "bashkëpunëtor shkencor" në Institutin e Gjuhës dhe të Letërsisë. Një vit më vonë iu akordua Urdhri "Naim Frashëri" i klasit III, ndërsa më 1995, mbas vdekjes, ju dha Urdhri "Naim Frashëri" i klasit I. Ai mbetet i modelit të kontribuesve të dalluar në studimet albanologjike, të cilët nuk imponohen as prej gradës, as prej titullit, por prej veprës. Edhe për këtë arsye ky botim nga ana e Akademisë së Studimeve Albanologjike synon të shërbejë si një akt më shumë vlerësimi e nderimi për të.



REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti "Musine Kokalari" - Prishtinë (Kosovë)

Drejtor: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ilir Yzeiri

Redaksia: Leart Kola, Andi Kananaj.

Përkthimi: Loreta Mokini, Entela Cani

Layout design: Dritan Lleshi

Tirazhi: 1500

Email: botadiplomate@gmail.com

Botimi i "Le Monde Diplomatique" në gjuhën shqipe mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë-SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde, Association Gunter Holzmann, Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directeur: Serge HALIMI, président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales: Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale: Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints: Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS, Eveline PIELLER, Hélène RICHARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique: Maria HERARDI, Boris SEMENIAKO (avec la collaboration de Delphine LACROIX pour l'iconographie)
Rédacteur documentaire: Olivier PRONET
Mise en pages et photogravure: Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEËRD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial, chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaïa SAHALI
Secrétariat: Yuliy DAROUKA (9621), Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)

Courriel: prénom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs: François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET
Relations marchands de journaux (numéro vert): 0805-050-147

Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé) www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles, sauf accord avec l'administration
© ADAGP, Paris, 2019, pour les œuvres de ses adhérents

Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée: France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3
Shqipërimi i «Le monde diplomatique» / Kuptimi i filozofisë dhe sfida e demokratizimit, nga **SERGE COSPÉREC DHE FRÉDÉRIC LE PLAINE** / Emancipimi homoseksual, çështje politike, nga **JEAN STERN**

FAQE 4-5
"Mëshira", mjerimi i fshehur i përgjedyshjes sociale në shkollë, nga **CLOTHILDE DOZIER DHE SAMUEL DUMOULIN** / Në kutinë e veglave të Andre Gorzit, nga **ALIOCHA WALD LASOWSKI**

FAQE 6-8
Ana e fshehur e mrekullisë portugeze, nga **MICKAËL CORREIA** / Mizat dhe tigrat kinezë

FAQE 9-10
Në kuzhinën e investigimit, nga **PIERRE PÉAN** / Deputeti dhe jahti i tij / Drejtuesit blihen që ç'ke me të! / la vlen të jesh i pasur! / Nëse s'ka para, atëherë s'ka debat!

FAQE 11
Ruanda, gjenealogjia e genocidit, nga **PHILIPPE LEYMARIE** / Kandidatët e eleminuar në Senegal

FAQE 12
Ta qortojmë apo ta ndryshojmë botën? Nga **BENOIT BRÉVILLE DHE RENAUD LAMBERT** / Mafiet e rërës

FAQE 14-15
Brazil, misteri i një grushti shteti juridik, nga **PERRY ANDERSON**

FAQE 16-17
Opozitarët rusë janë gjithmonë të korruptuar, nga **TONY WOOD** / Dikush që është me të vërtetë i keq

FAQE 18-19
Vendi që i ka shpallur luftë marrëveshjes, nga **YLLI PATA**

FAQE 20
Marketingu gjinor për Gerda Taronë, nga **ANNE MATHIEU**

FAQE 21
Pasojat e krizës në jetën bashkëshortore, nga **HUBERT ARTUS** / Përballë heshtjes së fantazmave, nga **XAVIER LAPEYROUX** / Fluturimet e pëllumbave, nga **FRANÇOIS ALBÉRA**

FAQE 22
Frederic Wiseman, epopeja e jetës së zakonshme, nga **PHILIPPE PERSON**

FAQE 23
Anna Ahmatova, ardhja e dytë në Shqipëri, nga **ILIR YZEIRI**

FAQE 24
Bëjeni buzëqeshjen profesionit tuaj, nga **Gabrielle Schütz**